

Mariglen Demiri
Zdravko Saveski

NACIONALIZMI JASHTË/NË KONTEKST (IT)

Bashkëpunimi i Maqedonasve dhe Shqiptarëve prej kryengritjes
të lindenit deri në luftën Nacionalçlirimtare



Mariglen Demiri
Zdravko Saveski

NACIONALIZMI JASHTË/NË KONTEKST(IT)

Bashkëpunimi i Maqedonasve dhe Shqiptarëve
prej kryengritjes të Ilindenit
deri në luftën Nacionalçlirimtare



Shkup, 2014

Botues:

Lëvizja majtiste „Solidarnost“

<http://solidarnostblog.wordpress.com>

ld.solidarnost@gmail.com

Në bashkëpunim me:



Përpunim teknik dhe kopertina:

Sllave Angellov

Tirazh:

1.000 kopje

Shtyp:

Vinsent Grafika



Ky libër është i shpallur sipas kushteve të lejes të Krijetiv komons: Shëno

Burim-Jokomercijale-Pa vepra të adaptuara. 2.5 Maqedoni

CIP – Katalogizimi në publikim

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare “Sh. Klimenti i Ohrid”, Shkup

316.472.3:323.111(=163.3:18]:497.7)“1903/1945“

SAVESKI, Zdravko

Nacionalizmi jashtë/në kontekst(it) : bashkëpunimi i Maqedonasve dhe

Shqiptarëve prej kryengritjes të Ilindenit deri në luftën

Nacionalçlirimtare

/ Zdravko Saveski, Mariglen Demiri. – Shkup : Lëvizja majtiste Solidarnost

; =Скопје : Левичарското движење „Солидарност“, 2014. - 240 faq. ; 21 cm

Tekst në gjuhën maq. dhe shqip. – Fusnotat në tekst. - Bibliografija:

faq. 110-114 ; Библиографија стр. 112-116. - Regjistër. – Përmban dhe:

Национализмот во(н) контекст : соработка на Албанците и Македонците

од Илинденското востание до Народноослободителната војна / Мариглен Де-

мири, Здравко Савески

ISBN 978-608-65628-3-0

1. Demiri, Mariglen [autor]

a) Maqedonas – Shqipëtar - Bashkëpunim – Aspekte sociologjike -

Maqedonija - 1903-1945

COBISS.MK-ID 97053450

Përmbajtja

| | |
|--|----|
| Parathënie | 7 |
| 1. Kryengritja e Ilindenit | 15 |
| 1.1 Kryengritja në Krushevë | 15 |
| 1.2 Kryengritja në Kostur | 22 |
| 2. Revolucioni Xhonturk | 28 |
| 2.1 Ngjarje | 30 |
| 2.1.1 Epizode antinacionaliste në fillim të revolucionit | 30 |
| 2.1.2 Kongresi i Manastirit | 34 |
| 2.1.3 Puçi kundër xhonturqëve më prill të vitit 1909 | 36 |
| 2.2 Fjalimet e Nijazi-beut dhe Sandanskrit drejtuar popullit | 38 |
| 3. Kryengritja e Ohrit dhe Dibrës | 50 |
| 3.1. Motivet dhe përgatitjet e kryengritjes | 51 |
| 3.2. Kryengritja | 53 |
| 3.3. Elementet antinacionaliste të kryengritjes | 55 |
| 4. Bashkëpunimi midis dy luftave botërore | 60 |
| 4.1 Marrëveshja e Tiranës e vitit 1921 | 60 |
| 4.2 Bashkëpunimi në kuadër të Komitetit ballkanik të organizatave nacionalçlirimtare | 64 |
| 5. Lufta Nacionalçlirimtare | 70 |
| 5.1 Dy vrasje masive: Jabollçishta e Poshtme dhe Beliçica | 70 |
| 5.1.1 Jabollçishta e Poshtme | 71 |
| 5.1.2 Beliçica | 74 |
| 5.2 Pjesmarja e Shqiptarëve dhe njërive partizane shqiptare në LNÇ të Maqedonisë | 77 |
| 5.2.1 Pjesmarja e Shqiptarëve në njësitë të LNÇ të Maqedonisë dhe formimi dhe betejat e Brigadës të Katërt Shqiptare | 78 |
| 5.2.2 Partizanët Shqiptarë të shpallur si heronj të popullit të Jugosllavisë | 85 |
| 5.3 Çlirimi i Kërçovës dhe Dibrës | 88 |
| 5.3.1 Çlirimi i Dibrës | 88 |

| | |
|--|-----|
| 5.3.2 Çlirimi i Kërçovës | 94 |
| 5.4 Bashkëpunimet e lëvizjes nacionalçlirimtare të Maqedonisë dhe Shqipërisë | 99 |
| 5.5 Nga Tirana, në solidaritet | 101 |
| Plotësim 1: Tubimi i parë i lirë në Tetovë | 104 |
| Plotësim 2: Lista e pjesmarësve Shqiptarë të vrarë në Brigadën e VII (IV) Shqiptare | 106 |
| Bibliografija | 110 |
| Regjistri i emrave personal | 115 |

Për të gjithë ata që krijuan
anën e ndritur të historisë

P Parathënie

Në periudhë të ndjenjave të zmadhuara nacionaliste në Maqedoni, kur politika dhe institucionet bëhen shërbëtor të nacionalizmit, paraqitet një nevojë për ndryshim të paradigmës. Nacionalizmi si ideologji me pyetjet dhe zgjidhjet e problemeve, imponohet si ideologji dominante në një hap të theksuar me neoliberalizmin. Me imperativin se pyetjet kombëtare janë më të rëndësishmet, paradigma nacionalistike i kontaminon të gjitha lëmitë të tjera të sferës politike, me që krijon monopol mbi jetën politike, me atë, edhe mbi interpretimet e problemeve me natyrë ekonomike, kulturore dhe politike. Ashtu si ç' do nacionalizëm, edhe ky në Maqedoni, përsëri i hap pyetjet të mbyllura historike, duke u dhënë përgjigje me një menyre të re të vlerave nacionalistike.

Në këtë periudhë, nacionalizmi i maqedonasve shkon së bashku me nacionalizmin e shqiptarëve. Edhe pse sipas pamjes ata dallohen midis veti, sipas vlerave dhe vizionit të cilën e preferojnë janë në një vijë të njejtë. Ndryshohen vetëm apsktetet e përmbajtjes, derisa esenca është e njejtë të të dy nacionalizmat.

Duke fuqizuar ndjenjat e përkatësisë, disa gazetarë dhe intelektual, mbështetës të politikave të qeverisë në Maqedoni, duke patur qasje dhe strukturë nacionalistike, referojnë urrejtjen të cilën këta dy popuj e kanë ushqyer gjatë historisë. Veçanërisht duke e përmendur luftën e dytë botërore dhe mardhëniet e shqiptarëve dhe maqedonasve në atë periudhë. Me autoritet të themeluar në të gjitha shkallët e shoqërisë, këta intelektualë filluan të manipulojnë. Një gjë që qytetari i rëndomtë shumë shpejt e ka gëlltitur. Me nacionalizmin është krijuar edhe mundësia për afatgjatësi politike të intelektualëve të këti lloji, por dhe të partive politike të cilat e dominojnë hapsirën politike. Por, me këtë u hap dhe mundësija që ky libër të shkruhet, si një përgjigje e veçantë e gjithë manipulimeve nacionalistike me historinë dhe ngjarjet historike.

Sipas mendimit të Ernst Gellnerit, nacionalizmi është “princip i cili pohon se politika dhe njësia kombëtare (nacionale) duhet të përputhen”. Nacionalizmi aktivohet çdo herë kur ky princip shkilet. Ky princip shkilet, sipas Gellnerit, atëherë kur të gjithë antarët e një kombi nuk jetojnë në suaza të një shteti dhe kjo sjell deri në situatë të mos dihet cili është shteti amë i këtij kombi. Zemërimi aktivizohet nën ndikim të nacionalizmit edhe atëher kur sunduesit dhe qeveritarët e një shteti nuk i takojnë të njëjtës bashkësi etnike e cila bën thirrje të ekskluzivitetit mbi kombin dhe shtetin. Zakonisht ato janë popujt shumicë në shtet, por shpesh herë pakicat. I këtillë është edhe shembulli me Maqedoninë dhe atë se sa shqiptarët dhe maqedonasit ndihen si robër të politikës dhe qeverisjes së perkatësisë “tjetër”. Me atë, nacionalizmi paraqet vetëm një “teori të legjitimitetit politik e cila kërkon kufinj të etnik të mos i presin kufinj të politik, as kufi-një etnik në suaza të një shteti të mos i ndajnë qeveritarët nga të tjerët.”¹

Një prej elementeve themelor të nacionalizmit dhe të çdo ideologjije është miti. Kthimi në mit do të thotë dhe kthim kah iracionalja. Pluriperspektiviteti i mitit në mënyrë të “aftë” shfrytëzohet nga ana e kampeve nacionalistike, duke e mbrehur thellë, si strukturë, e politikës së sajë nacionalo-narative. Çdo gjë fillon me mitin, i cili ka dispozitë të hapur për interpretim, kurse si strukturë e ka në të gjitha përrallat e mëdha historike, por dhe religjioze, politike, bile edhe në ata të shkencës. Shpesh herë materijali i cili e bartë gjithë strukturën e mitit është iracional dhe e preferon karakterin heroik. Përveç heroit, si pjesë përbërëse e mitit paraqitet edhe miti i simboleve, të cilat janë një vijim totemistik, edhe pothuajse të gjithë popujt në flamujt e tyre ose në stemën (të shtetit ose etnike) kanë nga një kafshë me të cilën janë esencialisht të lidhur. Të maqedonasit është luani, kurse të shqiptarët është shqiponja me dy koka. Miti paraqet instrument që bën thirrje për bashkim, jehonë frymëzuese e ngjarjeve historike të cilat i thirrin protagonistët e sotëm në aktivitet të vetëdijshëm dhe proaktiv politik. Historia është thesar e ngjarjeve dhe karakterëve të cilat mitizohen (personat si Leka i Madh ose

¹ Ерст Гелнер, „Нациите и национализмот“, „Култура“, Скопје, 2001, 5-6.

Skënderbeu si etërit e kombit), dhe njëkohësisht personat-protagonistë janë dhe heronjë të kohës së vet, por dhe heronjë të përjetshëm, themelues të kombit, ose mbrojtës të atij kombi, në fund edhe dëshmorë. Thirrja për bashkëkombasit nga ana e nacionalistëve, çdoher shkon në drejtim të asaj se gjaku i derdhur dhe jeta e kaluar në luftë, e këtyre karakterëve-heronjë nuk duhet të jenë kot. Këtu bëhet ajo tërësi përjashtuese.

Problemi me nacionalizmin në Maqedoni është shumë prezent dhe ka intenzitet të theksuar. Duke filluar me principin e Gellnerit përreth nacionalizmit dhe realitetit politik me të cilën ballafaqohet secili nacionalizëm, mundemi të njejtin ta përdorim edhe në qasjet nacionalistike të dy grupeve më të mëdha etnike në Maqedoni. Nacionalistët maqedonas mendojnë se shteti u takon maqedonasve, gjë që e ka vërtetuar gjenetika dhe historija, se kufijtë e sotme të Maqedonisë përfshijnë vetëm një të tretën e teritorit etnik të Maqedonisë, dhe se të gjithë popujt e tjerë të cilet jetojnë në këto kufij janë ardhacak ose nuk kanë të drejtë të jenë element shtetformues. Narativët vazhdojnë në drejtim të asaj se identiteti maqedonas ka vazhdueshmeri shumë vjeçare. Sa i perket shqiptarëve, nacionalistët maqedonas konsiderojnë se shqiptarët janë të ardhur në teritorin e sotëm të Maqedonisë dhe për shkak të kësaj ata nuk kanë të drejtë të kërkojnë (më shumë) të drejta. Këto qendrimë marrin vlefshmëri politike dhe institucionale pas ardhjes në qeverisje të një prej partive politike të djathtë në Maqedoni (VMRO-DPMNE), e cila me një varg ngjarjesh dhe projekte i forcon këto pozita dhe stereotipe në publik dhe me atë krijon teren të pjellshëm nationalist e cila megjithatë në fund u sjell benefitin në politikën ditore. Gjegjësisht, ata fitojnë në zgjedhje. Më e keqja që mund ti ndodhë maqedonasit bashkëkohor, sipas pikpamjes së nacionalistëve maqedonas, është me Maqedoninë të udhëheqë/qeverisë jo maqedonas, por shqiptar ose anëtar i një bashkësie tjetër etnike.

të njejta ose të ngjashme kanë edhe nacionalistët shqiptar. Ato konsiderojnë se Shqiptarët janë populli më i vjetër në Ballkan, dhe se ata çdo herë kanë jetuar në teritor të Maqedonisë së sotme, dhe se çdo herë kanë qenë të represuar dhe të diskriminuar nga “fiset armiqësore sllave dhe greke”. Atyre u takon ky teritor dhe se një ditë ato duhet të bashkohen me shtetin amë Shqipërinë, duke e krijuar atë që ato e quajnë

Shqipëri Etnike, derisa të tjerët e quajnë Shqipërija e Madhe. Për këta, frustracion paraqet momenti kur përfaqësuesit e tyre në Parlament nuk i përfaqësojnë dhe nuk i mbrojnë qendrimet me të cilat ata u kërkojnë vota në periudhën parazgjedhore, dhe ato qendrimet çdo herë janë tregime të mëdha nacionalistike. Përfaqësuesit politik në atë rast janë të akuzuar nga ana e votuesve të tyre, përkatës të bashkësisë etnike shqiptare, se në bazë ata shërbejnë si dekor dhe instrument i bashkësisë etnike maqedonase dhe politikës së tyre. Ata në esencë frikësohen se përfaqësuesit e tyre politik në pushtetin legjislativ dhe pushtetin ekzekutiv thjeshtë janë marioneta të përfaqësuesve politik të maqedonasve dhe me atë ata, në mënyrë indirekte vetë (Shqiptarët), janë të dominuar dhe të diskriminuar. Ato konsiderojnë se maqedonasit janë të ardhur nga karpitet dhe me atë sipas natyrës së gjërave ky teritor nuk u takon dhe mbi ata shikohet sikur të jenë dhunues. Në mënyrë të ngjashme si Maqedonasit ata referojnë në periudhat dhe personat historike, të njejtat i monopolizojnë, dhe para se të gjithë ata krenohen me identitetin e tyre i cili zgjat nga koha e paraardhësve të tyre, Ilirët.

Siç mundet të shikohet, nacionalistët e të dy kombeve historinë e instrumentalizojnë dhe e shfrytëzojnë në llogaritjet e tyre nacionalistike. Në përgjithësi, nacionalizmi shpesh herë e abuzon dhe instrumentalizon historinë. Nacionalizmi izolon ngjarje dhe karaktere të caktuara historik, dhe i pastron prej elementeve dhe konteksteve të tyre negative dhe në fund atë “prodhim” të tijë historik e lartëson dhe e hiperbolizon në masa absolute. Nacionalizmi e korrupton bërthamën historike, e kontaminon momentin historik në llogari të ngjarjes së vërtetë e cila paraqet një totalitet të mardhënieve. Ashtu e drejton shpesh herë në qëllime ideologjike ose të politikës ditore, por edhe si një matriks i veprimit politik të një opcioni i cili është i orientuar në të djathtë dhe i cili e esencijalizon shtetin, përkatësinë etnike dhe kombëtare të një populli, si vazhdim gjeografik, historik, kulturor, i gjuhës dhe gjenetik. Me atë historia paraqitet si katalizator i nacionalizmit në epokën tonë.

Përveç idhujtarisë e të zgjedhurve, një nga metodat kryesore të shtrembërimit të historisë nga ana e nacionalizmit është konceptualizimi i identitetit kombëtar si kategori e përjetshme. Identiteti kombëtar nuk

ka egzistuar gjithmonë. As të shqiptarët, as të maqedonasit, as të popujt tjerë ballkanik. Interpretimet nacionalistiko-politik dhe historiograf vazhdimisht kanë qëllim që të dëshmojnë se identitetet kombëtare (në rastin tonë identiteti shqiptar dhe maqedonas) kanë rëndësi dhe vlerë mbi historik. Por, përball bindjes së tyre se qëndrueshmëria e identitetit kombëtar vazhdimisht përcillet nëpër ngjarjet historike (dhe këtë për shkak të asaj që e marrin për të drejtë t'i monopolizojnë trashëgimitë kulturore dhe historinë), kombi si koncept i një krijesë e modernizmit, e cila procesin e ndërtimit e fillon me fillimin e Revolucionit Frances. Ne thjeshtë nuk mund të flasim për identitet kombëtar, para se të përfundojë dhe të unifikohet kjo ide. Në Ballkan, ideja e kombit vjen me vonesë të vogël, dhe mbas ardhjes, Shqiptarët u bënë Shqiptarë, dhe Maqedonasit u bënë Maqedonas, jo për shkak të asaj se janë lindur si Shqiptar ose Maqedonas, por për shkak të kushteve të cilat ata i kanë hasur ose fituar (relacioni familjarë, sistemi arsimor, propagandat e medijave dhe instanca të tjera represive kulturore) vazhdimisht u bëjnë thirrje të jenë Shqiptar ose Maqedonas.

Nënkuptohet se, këtë mendim nuk e ndajnë historianët nationalist dhe nationalistët në përgjithësi. Një periudhë e caktuar pjesa (më e madhe) e popullsisë shqiptare si kuptimsia e identitetit e ka shfrytëzuar qasjen otomane të religjionit (fesë) – Mbretërisë, ose mysliman në konfesion – Turq sipas kombit. Popullsia sllave në Maqedoni, një periudhë të caktuar është konsideruar si bullgare, greke, sërbe, derisa ato me konfesion mysliman janë konsideruar si Turq. Sa më shumë dëshmi historike të ketë se ajo ka qenë ashtu, “historianët” nationalist do të refuzojnë ta pranojnë atë. Çdo herë kur ka nevojë për lavdatë të identitetit shqiptar ose maqedonas si instancë që egziston në vete, e cila do të egzistojë edhe atëher kur nuk do të egzistojë asnjë shqiptar ose maqedonas, historianët do të jenë prezent atë ta shfaqin, shkruajnë dhe shpallin.

Është problematike ajo që historiografitë nacionalistike pothuajse gjithë historinë e paraqesin si ndeshje midis popujve, dhe veçanërisht duan historinë e popullit të vet ta paraqesin si ndeshje ose komplot i të gjithë popujve kundër popullit të tyre. Në përputhje me këtë narativ, ata nuk i shikojnë, ose i minimizojnë mospajtimet dhe ndeshjet e popullit

të vet, veçanërisht kur ka të bëjë me ndeshjen midis dy personave të cilat ajo i paraqet në dritë pozitive ose kur ka të bëjë me ndeshjen klasore. Është larg nga e vërteta se gjithçka në historinë është rrotulluar përreth etniciteteve. Përveç kësaj, në historinë nuk ka patur vetëm ndeshje inter-etnike, por dhe bashkëpunime inter-etnike dhe ndeshje intra-etnike. Derisa nacionalizmi e pohon të kundërtën. Se gjërat më të rëndësishme në historinë kanë të bëjnë me etnicitetet. Se ndeshjet inter-etnike janë esenca e historisë, dhe ndeshjet intra-etnike, diçka si anomali. Çdo herë, nënkuptohet, se drejtësia është në anën e popullit të cilit i takojnë.

Me konceptualizime të këtilla, nacionalizmi e kontaminon historiografinë dhe që është më shumë rëndësi nga pikpamja e efekteve politike, librat shkollorë të historisë. Fëmijëve, të cilët janë në proces të formimit të botëkuptimit, u imponohet vetëdija se populli i tyre çdoher ka qenë pa kurrfarë të drejtë dhe, në nivel më të përgjithshëm, se identifikimi etnik është identifikimi primar për njeriun, në mos edhe i vetmi. Të socializuar në atë mënyrë ta vështrojnë realitetin, kur fëmijët do të rriten, senzibilizohen që ti detektojnë “padrejtësitë kombëtare”, mbi realitetin të shikojnë nëpër prizmen e kombëtares, dhe shndërrohen në pre i lehtë të ithtarëve të ndryshëm për të drejta kombëtare. Në këtë kontekst do të kishim dashur që të theksojmë se e majta bën gabim kur, duke nisur nga qëndrimi krejtësisht i drejtë se e kaluara nuk është e rëndësishme, por gjendja e tashme dhe historia, silltet me nënvlerësim kah studimi i historisë. Për shkak se në atë mënyrë lejon historinë ta shkruajnë nationalistët. Në atë mënyrë harron të vërtetën e madhe që e ka thënë Xhorxh Orvelli se “Ai që e kontrollon të kaluarën e kontrollon të ardhmen, dhe ai që e kontrollon gjendjen e tashme e kontrollon të kaluarën”. Ose mu nga kjo pikpamje e interesimit për të tanishmen dhe të ardhmen nuk është e njëjtë se me çfarë qëndrime për të kaluarën do të hyjnë njerzit në sferën politike.

Ne konsiderojmë se ky është shkaku pse historiografia nuk duhet të lihet në duart e nationalistëve. Gjithashtu, konsiderojmë se identifikimi etnik nuk duhet të jetë primar, dhe veçanërisht jo identifikimi i vetëm për njeriun. Duke filluar nga këto pozita dhe të neveritur nga nxitja e ndjenjave nacionaliste edhe të maqedonasit edhe të shqiptarët, ne vendosëm që ta shkruajmë këtë libër. Në të janë të paraqitur të gjitha

momentet ndritëse të mardhënieve maqedonaso-shqiptare dhe bashkëpunimet në gjysmën e parë të shekullit 20. Kjo është periudhë në të cilën të dy popujt luftojnë për pavarësi. Kjo është periudhë në të cilën të dy popujt janë të luajtur dhe të diskriminuar, periudhë në të cilën të dy popujt ndodh që të luftojnë midis vete për interesa të huaja. Por, kjo është kohë kur të dy popujt së bashku luftojnë kundër të gjitha formave të dominacionit dhe okupacionit, duke e kërkuar lirinë shtrenjtë të paguar.

Në këtë libër nuk kemi qëllim që ti idealizojnë as maqedonasit, as shqiptarët, as bashkëpunimin dhe bashkëjetesën e tyre. Ka patur edhe maqedonas edhe shqiptarë të cilat kanë qenë gati, vetëm për shkak të asaj se ndonjëri i takon kombit tjetër, t'u shkaktojnë dëm. Ato nuk meritojnë të jenë të respektuar. Por, ka patur edhe maqedonas edhe shqiptarë të cilët nuk kanë menduar në atë mënyrë. Të cilat prioritet i kanë dhënë asaj se çfarë është një njeri, se sa kujt kombi i takon. Ato janë ata të cilat duhet të respektohen.

Në kontekst të mosidealizimit (mosshtrembërimit) të ngjarjeve dhe karakterëve historik, do të kishim dashur të theksojmë edhe se midis shqiptarëve dhe maqedonasve nuk ka patur vetëm bashkëpunim. Siç është shembulli edhe me popujt tjerë. Bashkëpunimi midis tyre çdo herë nuk ka qenë i frymëzuar me arsye antinacionalistike. Nacionalistët shqiptar dhe maqedonas kanë ditur të hyjnë në bashkëpunim me tjetrin, thjeshtë me arsye pragmatike duke e patur parasysh vetëm kauzën e tyre kombëtare. Por, siç është kjo e vërtetë, e vërtetë është edhe ajo se kundër shtrembërtimit nacionalistik të historisë, mardhëniet midis shqiptarëve dhe maqedonasve nuk kufizohen vetëm në armiqësi dhe në bashkëpunime të cilat mund të karakterizohen si martesë interesi. Ka patur edhe bashkëpunim në bazë njerëzore midis popullatës së rëndomtë, ka patur edhe bashkëpunim midis njerëzve, shqiptarë dhe maqedonas, të cilat kanë kuptuar se identifikimi kombëtar nuk është i rëndësishëm për njerëzit, por, se ata janë njerëz dhe nacionalizmi u bën dëm të gjithëve. Kurse ajo është atë që nacionalistët, edhe maqedonas edhe shqiptarë, duan që të mos e shikojmë.

Prezantimi i këtij libri, nënkuptohet, nuk mund të trajtohet si shterje të tërë materijalit. Nevoitet akoma punë në këtë problematikë dhe, kuptohet, se ne duam atë ta inkurajojmë.

Në fund, do të kishim dashur t'u falimnderojmë Albulena Karagës, Fergim Demirit, Miranda Fejzullahut, Enis Isenit dhe Benjamin Shehut për përkthimin e disa Kapitujve të këtij libri në gjuhën shqipe. Gjithashtu i falimnderojmë edhe Avni Tahirit për lekturimin e librit të përkthyer në gjuhën shqipe të verzionit elektronik. I falimnderojmë Igor Smilevit që përzemërsisht u angazhua që të na ndihmojë rreth gjetjes së disa të dhënave rreth Velesit dhe Jabollçishtit të Poshtëm. I falimnderojmë edhe Fondacionin „Roza Luksemburg“ e cila financiarisht e mundësoi shkrimin dhe botimin e këtij libri.

1 Kryengritja e Ilindenit

Kryengritja e Ilindenit është një nga kapitujt më të ndritshëm të popullit maqedonas. Ajo, nuk është si rezultat vetëm i dëshirës liri prurëse, por dhe (për at kohë dhe për sot) jo vetëm për frymën e internacionalizmin tipik që ka ekzistuar gjatë kryengritjes.

Thjesht, parafytyrimet për kryengritjen e lindenit në historiografinë maqedonase vëmendje të rëndësishme u përkushtojnë ngjarjeve në Krushevë. Kjo është për shkak të dy shkaqeve. I pari, për shkak të ngjarjeve të rëndësishme nga aspekti politik që është zhvilluar në Krushevë, dhe i dyti, për shkak të aspektit ushtarak, Krusheva ishte një region shumë me rëndësi strategjike si region (së bashku me Kosturin) ku kryengritësit kishin arritur suksese më të mëdha.

1.1 KRYENGRITJA NË KRUSHEVË

Është e njohur mire se organet që i kishin vendosur kryengritësit si pushtet i republikës së Krushevës, kanë qenë pasqyrë e dallimeve etniko-fetare të popullsisë në Krushevë, dhe qëllimi i realtë i udhëheqsisë së Malit siç e quanin ato në krye me Nikolla Karevin ka qenë qëllimi që të gjithë etnitetet të merrnin pjesë në qeverisjen, dhe askush të mos ndihet i diskriminuar përshkak të përkatsisë së tyre fetare ose etnike. Në atë rast nacionalitet janë llogaritur komunat fetare: Patriakanja (e përbërë së paku nga Vllehët dhe një numër të konsiderueshëm të Maqedonasve, si dhe Shqiptatrët Ortodoks), Egzarkija (e perbere nga Maqedonas), dhe e Vllehve (e përbërë nga t.q. të Romanizuarit, ose nacionalistët, siç thjeshte i kanë quajtur përfaqsesit e tyre).² Sipas sistemit parimor ç’do komunë fetare ka caktuar nga 20 përfaqses të tyre të cilët e kanë përbërë këshillin apo

² Тодор Чепреганов (ур.), „Историја на македонскиот народ“, ИНИ, Скопје, 2008, 199.

parlamentin 60 anëtarësh. Kjo strukturë ka zgjedhur një organ drejtues të përkohshëm, të cilit i ishin dhënë urdhëra realizuese qeverisëse. Në përbërjen, në mes të tjerëve hyrën edhe Shqiptarët si Gjorgji Çaçe³, i cili ka qenë Sekretar i këshillit dhe pergjegjës për rekvizionin, ndersa në përbërjen e komisionit për çështjen e ushqimit të këshit ka hyrë edhe Nikolla Bojarov i cili gjithashtu ka qenë Shqiptar.⁴

Një shembull shumë të mirë potencon Gjorgji Tomalevski për bashkëjetesën që ka egzistuar asaj kohe ne Krushevën e lirë, si dhe kujdesit që i është përkushtuar bashkëjetesës. Më 9 gusht, në realitet në të djelën e parë pas çlirimit, në Krushevën e lirë, përfaqsesit e këshillit të përkohshëm si dhe komiteti drejtues i Malit, kanë marrë pjesë në liturgjitë në të tria kishat e qytetit. Mbase, nga vanëtarët e komitetit të Malit, Nikolla Karev ka shkuar tek kisha patriarkale (Greke), Todor Hristov – zyrtarisht në kishën Vllehe, ndërsa Toma Niklev ka shkuar në kishën egzakike (Bullgare).⁵

Treguesi më i mirë për etosin antinacionalist i qeverisjes së Krushevës është dokumenti që u lëshua si proklamim që u ishte dedikuar atyre që i takonin komunitetit mysliman që jetonin në fshatrat për rreth (i njohur si manifesti i Krushevës). Gjegjësishtë , përmbajtja e tij është “mirë e njohur”, dhe këtu do e përshkruajm në tërsi, dhe do u këshillojmë lexuesve që të mos e anashkalojnë, duke e ditur dhe të bindur mirë se çfarë shkruan në të.

³ Стефан Илиев Матерков цит. сп. Кочо Топузоски, „Никола Карев: живот и потоа“, „Матица“, Скопје, 2005, 115. Георги Томалевски, „Крушовската република“, „Български писател“, София, 1968, 257. Анастас Митрев, „Мемоари, огледи, статии“, „Нова Македонија“, Скопје, 1974, 185.

⁴ Ангел Динев, „Илинденската епопеја“, „Мисла“, Скопје, 1987, I том, 317-318.

⁵ Томалевски, op. cit., 266.

Manifesti i Krushevës

Vëllezër e fqinjë të dashur!

Ne, fqinjët tuaj të përhershëm, miq dhe dashamir nga Krusheva e bukur dhe nga fashtrat e stolisura pa dallim feje, kombi, gjinie dhe bindjeje, duke mos mundur ta durojmë më tiraninë e të eturve për gjak, dhe të uriturve për mish njeriu, murtatët që shikojnë që edhe juve edhe neve të na fusin ndën thikë, edhe juve edhe neve të na sjellin deri në mjerim, vendit tonë të dashur Maqedonisë ti ngjajë një shkretërirë shkretëtirash, sot ne ngritëm kokë dhe vendosëm që me armë të mbrohemi nga ata armiq tuajit dhe tonit dhe ta fitojmë lirinë. Ju e dini fort mirë se ne nuk jemi të këqinjë dhe se nga presioni vurëm kokat në thes që të jetojmë njerzishëm, ose të vdesim si trimal!

Megjithse dem baba dem jetojmë si vëllezër në këtë tokë, ne u kemi si tanët dhe u duam deri në fund të mbëtëni tanët. Ne nuk ngritëm armët kundër jush - ajo do të ishte turp për ne, ne nuk ngritëm armët kundër popullatës së qetë frytdhënëse tuke, që mbijetojnë si ne me djersën e gjakosur – ai është vëllau ynë dhe me ta kemi jetuar dhe përsëri do të jetojmë, ne nuk dolëm të therim dhe grabisim, të djegim dhe vjedhim – mjaftojnë zullumet nga derebenet e shumtë nëpër Maqedonin tonë të varfër, ne nuk dolëm të jetimosim dhe të dhunojmë nënat dhe motrat tuaja, gratë dhe bijat, duhet ta dini se pasuria juaj, jeta juaj, besimi juaj dhe nderi juaj na janë shumë të shtrenjta, siç janë të shtrenjta dhe tonat. Sa për ta ruajtur pasurinë dhe jetën, besimin dhe nderin, për këte ne kemi kapur pushkët.

Ne nuk jemi tradhëtar të vendit tonë që na ka lindur, ne nuk jemi vjedhacakë dhe jankesexhinjë, por revolucionarë që vdesin nën betim për të drejtën dhe lirinë, ne rrebelohemi kundër tiranisë dhe robërisë, ne luftojmë dhe do të luftojmë kundër tradhëtarve, kundër hajdutëve, kundër zullumqarëve dhe jankesexhinjëve, kundër dhunuesve të nderit tonë dhe besimit tonë, dhe kundër atyre që e thithin djersën tonë dhe eksplatojnë mundin tonë. Nga ne dhe nga fshatrat tona mos u frigoni – askush dëm nuk do tju bëjmë.

Ne, jo vetëm që ju kemi si vëllezër, por dhe u përmallojmë si vëllezërit tonë, sepse e dimë që edhe ju jeni robër sikur ne, robër të mbretit dhe të bejlerve të mbretit, efendinjëve dhe pashallarve, robër të të pasurve dhe të fuqishmive, robër të dhunuesve dhe zullumqarve, që e kallën mbretërinë nga të katër anët dhe na detyruan ne të ngrejm kokën për drejtësi, për liri të jetës së njëriut. Për drejtësi, për liri dhe jetën e njeriut, ju ftojme edhe ju të vini që të luftojmë së bashku!

Ejani vëllezër mysliman pranë nesh që të nisemi kundër armiqve tanë dhe tuaj! Ejani nën flamurin e Maqedonise Autonome ! Maqedonia është nëna jonë e përbashkët dhe thërret për ndihmë. Ejani ti këpusim zinxhirët e robërisë, të shpëtojmë nga mundimet dhe vuajtjet, dhe ti thajmë lumenjt e gjakut dhe të lotëve! Ejani pranë nesh vëllezër ti bashkojmë shpirtërat dhe zemrat dhe të shpëtojmë, që fëmijët tanë dhe niprit të jetojnë në paqë, të punojnë lirshëm dhe të jetojnë!...

Fqinjë tanë të dashur! Si Turq, Shqiptar dhe mysliman, u kuptojmë, ju të gjithë mendoni se mbrëterija është e juaja dhe se ju nuk jeni robër, mbase ne flamurin e mbretit nuk ka kryq, por ka yll dhe hënë. Se sështe ashtu dhe se gaboni, jus shumë shpejt do ta kuptoni dhe do kujtoheni. Por, nese ju vjen turp të vini pranë nesh dhe të deklaroheni kundër tiranisë së mbretit, ne, sipas atdheut dhe vuajtjeve vëllezërore, nuk do t'u ngasim dhe nuk do t'u urrejmë. Ne, vetë do të luftojmë për vete dhe për ju, nëse ka nevojë të gjithë do të vdesim nën flamurin për lirinë tonë dhe tuajën, dhe për drejtësinë tonë dhe tuajën. Liri a vdekje është shkruar në ballin tonë dhe në flamurin tonë të përgjakur. Ne e kemi ngritur atë flamur dhe nuk ka kthim nga kjo. Nese ju na keni si vëllezërit tuaj dhe na e doni të mirën, nëse llogarisni të jetoni me ne siç keni jetuar deri tani, dhe nëse jeni bijë të besës së nënës Maqedoni, mund të na ndihmoni veç me një gjë – kurse ajo është një ndihmë e madhe, të mos bëni aleancë me armikun, mos vini me armë kundër nesh, dhe të mos bëni zullume nëpër fshatrat të krishterë!

Zoti e bekoftë luftën e shenjtë për drejtësi dhe liri!

Qofshin të gjallë luftëtarët për liri dhe të gjithë bijtë e mirë dhe të ndershëm të Maqedonisë!

Ura! Për Maqedoninë autonome!

Siç mund të shihet, manifesti i Krushevës është përplot me deklarata antinacionaliste. Edhe pse behet fjalë për një tekst të shkurtër, në të muslimanët deri në tetë herë janë quajtur vëllezër. Atyre me ngrohtësi dhe me mirseardhje u drejtohen me vëllezër bashëkëndas dhe fqinj të dashur me të cilët dem baba bem jetohej si vëllezër. U deklarohet se ndaj atyre shihet si në “të tyre”, dhe se me ta dëshirohet “deri në fund të mbeten të tillë”, me vuajtjet e tyre të ndeshen për shkak se janë vëllezër. Dhe për shkak se Maqedonia është nënë e përbashkët, kurse ata gjithashtu robër, u drejtohet thirrje që t'u bashkangjiten sipas atdheut dhe vuajtjeve vëllezërore në luftë kundër armiqve “tuaj dhe tanë”. Edhe

nese nuk pergjigjen në thirrjen, u tregohet se nuk do ti urrejnë, dhe u sugjerohet, nese dhe ju na keni si tuajit vëllezër dhe nëse jeni besnik dhe koshient bij të nënës Maqedoni, të paktën, mos bashkohen me armikun.

Disave mund t'u bëhet se kjo ska asnjë vlerë veçse fjalëve boshe të treguara me një qëllim që të neutralizohet popullata myslimane. Ose, kryengritësve nuk u ishte në favor të armiqtësojnë popullatën lokale myslimane dhe se kjo retorikë ishte zgjedhur vetëm me një qëllim ajo të jetë e “neutralizuar”.

Asgje nuk është larg së vërtetës. Diskursi socialist i manifestit ishte shumë argument i qartë se antinacionalizmi ishte i realtë. Në një vend në Manifestin është saktësuar se cili saktësisht është ndier si vëlla, kurse ai është populli i qetë dhe punëtor mysliman, që mbijeton si ne, me djersën e përgjakur. Domethenë jo Bejlerët, pashatë dhe efendinjë, të pasurit dhe të fuqishmit, por populli i varfër musliman në rrethinën e Krushevës, të cilin popull ‘murtatët’ (hajdutët) dëshirojnë ta sjellin deri në “lypsarë” popullatën e varfër të Krishtere. Popullatës të varfur myslimane i potencohet se lufta është edhe kundër atyre që e thithin djersën tonë dhe e eksplatojnë mundin tonë dhe se duhet të kuptojë se mbretëria nuk është e ati, pa marrë parasysh se në flamurin e mbretërisë ka yllë dhe hënë, por se dhe ai është rob i mbretit dhe të shërbëtorve të mbretit, Bejlerve, Agallarve, Pashallarve, rob i të pasurve dhe të fuqishmëve. Dhe mu për këtë duhet të qëndrojmë krah për krah afër “vëllezërve për nga vuajtja” dhe kundër tuajit dhe tonit armik.

Me fjalë të tjera, me qasje tipike socialiste, popullata e thjeshtë myslimane trajtohet si vllazërorë, sepse në bazë të diskursit socialist për dallim nga ai nacionalist, ne jemi të gjithë të varfër dhe të paprivilegjuar pa dallim të nacionalitetit dhe fesë. Tipike Socialiste është dhe theksimi drejtuar popullatës myslimane sepse shteti ku jetonjnë nuk është i tyre, vetëm se eksplatuësit janë të besimit të njëjtë. Dhe pse është kështu, edhe ai duhet të luftojë, sepse nuk është i lirë. Së bashku me vëllezërit, jo vetëm që i kanë sipas bashkjetesës dem baba dem, por se janë vëllezër edhe sipas vuajtjeve që i kanë. Ndërsa liria që drejtohet përmes manifestit nuk është liri nacionale, por liri nga eksploatimi. Nga mundimet dhe vuajtjet, nga të cilat vuajnë që të gjithë që nuk janë murtatë dhe efendinjë, pa dallim

të përkatsisë etnike dhe të fesë. Kjo është kështu, pa marrë parasyshë se nacionalistët maqedonas janë të bindur se kryengritja në Krushevë është zhvilluar vetëm për çlirimin e Maqedonisë.

Kur jemi tek manifesti i Krushevës duhet përmendur edhe ajo se përmbytja e sajë antinacionaliste u prit mirë nga fshataret e fshatit etnik shqiptar i quajtur Alldançe. Kmeti i këti fshati, Efendi Sinani në përgjigjëjen e vet drejtuar Krushevasve, duke u premtuar se do pushojnë, shkroi si vijon, Aleat të respektuar.

Nga letrat juaj morëm vesh se ju nuk jeni njerëz të këqinjë, sepse i keni braktisur shtëpitë tuaja jo për të na sulmuar popullatën e qetë, por jeni kundër njerëzve të këqinjë të pushtetit që i mbron. Por ata që ju i kërkoni nuk janë në mesin tonë, por ikën nëpër qytetet. Sa i përket angazhimit tonë, ne ju premtojmë se do pushojmë. Nëse doni të vrisni njerëz të pafajshëm, ejani. Zoti i ndihmofte palës që e kërkon drejtësinë...

Letrat tjera i dërguam në fshatrat fqinje të cilët gjithashtu janë dakord me ne.⁶

Edhe letra e fshatarëve të Alldancit është në frymën e njejtë:

“Vëllezër bashkeatdhetarë!

E morrem proklamimin tuaj vëllazëror i cili dukshëm na tronditi. Ia lexuam tërë lagjes para xhamisë dhe për arsye se ju njohim qysh prej në fëmijëri, supozojmë që jeni mjaft të ndershëm dhe të sinqertë që t’i qëndroni fjalës si kavalerë dhe si luftëtarë për drejtësi. Ju premtojmë përzemërsisht se pasurinë, jetën dhe nderin e bashkëkombasve tuaj, fqinjë tanë shekullorë, me të cilët gjatë regjimit të deritanishëm dhe gjatë regjimit të ardhshëm të atdheut tonë të dashur, do të udhëheqim pa mundur diçka të na ndajë dhe ata do të jenë të ruajtura dhe në mënyrë kavalierë të mbrojtura Brenda kufijve të mundshëm. Cili njeri ia don të keqen vetvetes? Rruga juaj me të vërtetë është e rrezikshme. Allahu i madh le ta lëshojë bekimin e Tij për triumfin e drejtësisë, që është hyjnore dhe le të ju ruaj, fqinjë të dashur, nga çdo rrezik.”⁷

⁶ Цит. сп. Јусуф Хамза, „Заемните односи меѓу прогресивните османски кругови и македонското револуционерно движење во втората половина на 19 и почетокот на 20 век“, „Студентски збор“, Скопје, 1988, 123.

⁷ Цит. сп. Ibid., 122.

Epizodi i ardhshëm është dëshmi se të gjitha këto nuk kanë qenë fjalë boshe. Kur Baftijar-pasha me ushtrinë e vet është nisur drejt Krushevës, numër i madh bashibuzukësh nga fshatrat Vërbovec dhe Presillë janë drejtuar kah manastiri “Shën Spas” (3-4 kilometra larg nga Krusheva) me qëllim ta grabisin atë. Megjithatë, bashibuzukat janë habitur kur para dyerve të manastirit e kanë vërejtur Aganë e fshatit Alldançe, Sinan Gaziun, se si e ruan manastirin. Sinani kishte vendosur ushtarë të armatosur edhe rreth mureve, pas konakëve dhe në vende tjera të manastirit. Ai me njerëzit e vet i ka ndaluar bashibuzukët të hyjnë dhe ta grabisin manastirin, duke u potencuar që me njerëzit e vet ka qenë i vendosur edhe të vdes nëse duhet, vetëm të mos i lejoje bashibuzukët ta grabitin manastirin.⁸

Në lidhje me bashibuzukërinë do ta theksojmë edhe të mëposhtmen. Në shuarjen e kryengritjes së Ilindenit rol mjaft të rëndësishëm kanë pasur bashibuzukët, si ushtri jo e rregullt e perandorisë. Ata në masë të madhe kanë qenë të përbërë nga turqit dhe shqiptarët, dhe atë për arsye të përkatësisë fetare të ithtarëve të vet. Për rrjedhojë, shumë shqiptar kanë qenë pjesë e çetave bashibuzuke të dërguar të plaçkisin nëpër Krusheve dhe rrethinë, por edhe në të gjitha regjionet ku ka ndodhur kryengritja. Në Krushevë, kjo ka ndodhur dhjetë ditë më vonë për arsye se tashmë kryengritja ka qenë e shuar në qytetet tjera (si në Manastiri, Ohri, Demir Hisar etj.).

Diletantizmi historiografik i sotshëm, këto të dhëna, i përdor në drejtim të nënvlerësimit ose më saktë manipulimit politik të atyre ngjarjeve historike. Nëse shuarjen e kryengritjes së Ilindenit e analizojmë nga pikëvështrimi i spektrit të sotshëm kulturor dhe politik, do të rezultojë që shqiptarët jo vetëm që kanë qenë kundër kryengritjes së Ilindenit, por ata në të njejtën kohë edhe kanë marrë pjesë në shuarjen e sajë. Por, kjo nuk është e vërtetë. Ka pasur shqiptarë nga rethina e Krushevës të cilët kanë qenë pjesëmarrës direkt në kryengritje, dhe gjithashtu edhe në organet konstituive të republikës kryengritëse. Hristos Siljanov shkruan që “në

⁸ Цит. сп. Ibid., 142. Како извор е наведен Миха Андреев „Спомени од националноослободителните борби на Крушево“.

Krushevë, nën rrezet e lirisë së brishtë dhe barazisë janë shkrirë urrejtjet nacionale dhe ka mbretëruar paqe dhe vëllazëri midis tre komunave krishtere.” Në atë klimë të bashkëjetesës e cila ka qenë e krijuar, në rradhët e mbrojtësve së Krushevës nuk kishte vetëm Maqedonas, por edhe kombesi tjera, duke i përfshirë edhe shqiptarët. Siç ka vërejtur, me plotë të drejtë, Ilmi Veliu, në shumë fotografi të çetave të Krushevës mund të shihen komitë më plisa dhe tirq të bardhë, që është indikator i qartë për përkatësinë kombëtare shqiptare të tyre.¹⁰

Këto të dhëna, janë në favor të prishjes së tezës në qarqet nacionalistike që e kanë bërë valide në përgjithësi, dhe ajo është qëndrim se “Shqipëtarët mbahen vetëm mes vete, ndihmohen midis njëri tjetrit dhe asnjëherë nuk luftojnë njëri kundër tjetrit”. Ja, edhe në këtë rast, edhe gjatë kryengritjes së Ilindenit në Krushevë, kjo tezë shfaqet si e pavërtetë: në mbrojtjen e Krushevës kishte edhe Shqiptarë, por gjithashtu ka patur edhe Shqiptarë në ushtrinë e cila e ka shuar pushtetin kryengritës. Për pasojë mund të thuhet që ato luftëra nuk kanë qenë vëlla-vrasëse ose tradhtarë, por beteja të botëkuptimeve të ndryshme politike. Ajo tregon për ngjarjet historike dhe rrjetet, jo si momente të zbërthimeve etnike, por si zbërthime politiko-ideologjike.

1.2 KRYENGRITJA NË KOSTUR

Për fat të keq, jo në të gjitha vendet ku ka ndodhur kryengritja e Ilindenit, kryengritësit kanë patur pikëpamje të gjëra si bashkëluftëtarët e tyre nga Krusheva. Siç ka shkruar Angel Dinev, “ato, (kryengritësit), përveç krushevasit, në asnjë vend tjetër nuk u munduan ta tërheqin kombin turk në rradhët e kryengritësve. . . Në rrethet tjera kryengritëse, krahas asaj që nuk u munduan të bëjnë diçka në frymën e pajtimit dhe bashkimit, por u lëshuan në fshatrat turke për të gërmuar në të kaluarën dhe të kërkojnë llogari të vjetra, për ti “shpague”, pa e ditur që në atë mënyrë mbjellin

⁹ Христо Силянов, „Освободителниѣ борби на Македония“, „Наука и Изкуство“, Софија, 1983, I, 293-294.

¹⁰ Илми Велиу, „Учеството на Албанците и Власите во Илинденското востание“, Скопје, 2011, 138-139. Për shembull, shifeni fotografinë në të cilën është e fotografuar cheta e vojvodës Andrej Dimov – Dokurchev dhe ajo ku është e fotografuar cheta e vojvodës të Ivan Naumov – Alabakut.

shovinizëm dhe i ashpërsojnë marrëdhëniet mes popullatës maqedonase dhe turke.”¹¹

Ky vlerësim i Dinevit para së gjithash ka të bëjë me ngjarjet në Kostur, regjioni i dytë, ku kryengritësit kanë arritur sukses të rëndësishëm në kohën e kryengritjes të Ilindenit. Atje në krye të kryengritjes nuk kanë qenë socialistët, prandaj nuk kanë qenë prezente sjelljet e përshtatshme antinacionaliste. Nuk ka pasur përfaqësim të duhur të të gjitha grupeve etnike në organet kryengritëse, por, në vend të saj ka pasur – urrejtje (hakmarje).¹² Ja çfarë shkruan Dinevi: “Kur kryengritësit nga Kosturi dhe Lerini e morën Klisurën dhe Neveskën, në vend që të dërgojnë thirrje për bashkangjitje në luftë në të gjitha fshatrat turke të rrethinës, ato dërguan një arradhë kryengritëse e cila shkoi në fshatin e madh pomak, Zherven dhe e dogji atë, kurse tjetra shkoi në Koreshticë¹³ dhe e bëri të njejtën gjë. Kur në qytezat e liruara nga kryengritësit (Klisura dhe Neveska), popullata kënaqej nga gëzimi, në Zherven dhe Koreshticë dhe të tjerë, vajtohej.” Dhe më pas konstaton: “drejtuesit e kryengritsve nuk kanë qenë të arsyeshëm të kuptojnë që me sjelljet e këtilla ato i çrrënjosin bazat e suksesit të luftës dhe i çojnë fshatarët në përqaftimin e pushtetit të rrezikshëm të bejlerëve kundër të cilit ato u rebeluan me armë në dorë.”¹⁴

Kryengritësit e Kosturit qysh në 3 gusht, në ditën e parë të kryengritjes në Kostur, e nxorren në pah dëshirën e tyre për hakmarrje. Siljanovi shkruan që çeta e vojvodës Ivan Popov ka pritur 50 banorë nga fshati

¹¹ Динев, op. cit., I vëllim, 368.

¹² Hakmarja nuk ka qenë e kufizuar vetëm në Kostur. Në Prespë ushtria turke ka nderur fshatëra të krishtere, por dhe kryengritësit kanë nderur katër fshatëra mysliman: Asamatini, Shaovcin, Bostanxhiovcin dhe Pëpli. Gjatë ndezjes të Shaovcit në zjarin janë djegur tre-katër fshatarë, kurse fshatarë kanë qenë të ndrzur edhe në Asamat. Nga Pëpli, vojvoda Kote Hristov ka plaçkitur një numër të madh të kafshëve, mbi 1.000 dhen dhe 600 lopë. Shiko С. Арсов, П. Кљашев, Л. Џеров, Г. П. Христов, А. Андреев, Г. Папанчев, Л. Димитров, „Спомени“, „Култура“, Скопје, 1997, 119 dhe 323-356, <http://www.angelfire.com/super2/vmro-istorija/Knigi/spomaa05.html> dhe Александар Крстевски - Кошка, „Бороја Наумов Фотев (1900-1993)“, Скопје, 1998, 31.

¹³ Në Kostur nuk egziston fshat Koreshticë. Ndoshta Dinevi ka menduar për fshastin Kapeshticë, në Shqipërinë e sotme, në kufi me Greqinë dhe në 10 kilometra nga fshati i Kosturit Smërdesh. Egziston fshat Koreshticë, por në Tikvesh.

¹⁴ Ibid.

Zherven i Kosturit, kur janë kthyer nga tregu në Kostur. Këto 50 banorë të fshatit sllavo-mzslimam ose më saktë fshati pomak Zherven, sikur që shkruan Siljanovi, “u bënë viktimë e hakmarrjes së tmerrshme... të gjithë u vranë”.¹⁵ Vojvoda Vasil Çakalarov në ditarin e tij ka shkruar që edhe ai ditën e njejtë ka pritur zhervenat të cilët janë kthyer nga tregu në Kostur. Sipas shkrimit të tij, ai ka mbytur 20 zhervenat, kurse Popovi ka mbytur tre-katër. Shohim që ka informata të kundërta se sa zhervenat ka mbytur vojvoda Popov, tre-katër ose pesëdhjetë. Në fund të fundit, ajo nuk është edhe aq e rëndësishme. E rëndësishme është që dy çeta kryengritëse kanë pritur fshatarë të cilët qetë janë kthyer nga tregu dhe me gjakftohtësi i kanë mbytur, për shkak të padrejtësive të vjetra që i “ka shkaktuar” fshati i tyre ose ndoshta edhe vetëm për shkak të përkatësisë së tyre fetare.

Por ky nuk ka qenë fundi i vuajtjeve të zhervenave. Tashmë pas dy ditëve fshati i tyre ishte djegur nga ana e kryengritësve. Me 5 gusht, ditën e njejtë kur është pushtuar Klisura, një çetë e madhe, e udhëhequr nga Lazar Pop Trajkov, e ka rrethuar fshatin dhe u ka sugjeruar banorëve t’i dorëzojnë të gjithë armët. Zhervenat kanë kthyer me gjuajtje, dhe si pasojë kanë vranë dy komitë, dhe katër i kanë plagosur. Tërë fshati ka qenë i djegur, dhjetëra banorë të tij janë vranë. Kurse të tjerët janë dëbuar.¹⁷

Hakmarrjet e kryengritësve të Kosturit nuk janë ndërprerë me kaq. Pas disa ditësh, me 9 gusht, në fshatin komit Smrdesh, është mbajtur mbledhje në të cilën kanë marrë pjesë rreth 700 kryengritës. Në periudhën e kryengritjes ky fshat tre herë ka qenë i sulmuar, i nderur dhe masakruar, kurse herën e fundit vetëm para dy muaj e gjysmë, në 22 maj, gati tërë fshati është djegur, kurse 85 fshatarë janë vranë.¹⁸ Përdersia në Krushevë, ditën e njejtë, përfaqësues nga “Udhëheqësia e Përkohshme dhe Drejtoria Malore” kanë marrë pjesë në liturgjitë në të gjitha tre kishat e qytetit, duke punuar në bashkëjetesën dhe duke e forcuar atë, në

¹⁵ Силянов, оп. cit., 302.

¹⁶ Васил Чакаларов, „Дневник 1901-1903“, „Силонс“, Скопје, 2007, 340.

¹⁷ Силянов, cit. vepra, fq. 303-304.

¹⁸ Ibid, 270-271.

Smrdesh atë ditë gjithçka është rrotulluar rreth hakmarrjes. Në fjalimet e veta, vojvoda Vasill Çakallarov, Ivan Popov dhe Pando Klashev i kanë rikujtuar njerëzit e pranishëm për vuajtjet e kaluara të popullatës dhe kanë thirrur: “Erdhi edhe radha jonë të hakmerremi për vëllezërit e vdekur dhe për gratë dhe vajzat tona të çnderuara!”¹⁹

Është sjellur vendimi të sulmohet qyteti i afërt Bilishtë, në Shqipëri, për shkak të pjesmarrjes së banorëve të tij në djegjet dhe grabitjet në Smrdesh. Të sulmohet ky qytet dhe të digjet në tërësi.²⁰ Duke mos i nënvlerësuar vuajtjet e kaluara të banorëve të Smrdeshit dhe të banorëve sllav të Kosturit nga ushtria turke dhe nga bashibuzukët, këtu duhet ta parashtrojmë pyetjen kyçe: Me çfarë qëllimi është bërë kryengritja e Ilindenit? A ka qenë qëllimi i kryengritjes çlirimi i Maqedonisë apo hakmarrje për vuajtjet e mëparshme dhe për padrejtësitë? Dhe nëse kryengritësit e Kosturit e kanë patur të qartë qëllimin e kryengritjes së Ilindenit, përse ato janë përqëndruar në sulm ndaj qytetit në Shqipëri, në vend që të punojnë në çlirimin e Maqedonisë?

Në çfarë mënyre djegja eventuale e Bilishtës do të kontribonte për çlirimin e Maqedonisë? Bilishta është sulmuar ditën e ardhshme, 10 gusht, por kryengritsit e Kosturit janë përballur me rezistencë dhe janë tërhequr. Prapsepapë, nuk janë kthyer me duar të zbrazta: sipas Çakallarov, ato në këtë ekspeditë “kanë mbledhur” disa qindra dele dhe lopë, të cilat i kanë çuar në malin e Smrdeshit.²¹ Përsëri na imponohet krahasimi me Krushevën. Edhe atje ka ndodhur që një komit “të mbledh” kope të dhurve dhe dhive nga fshati mysliman Alldançe, me qëllim që ta ushqejë ushtrinë kryengritëse. Kur komiti i ka treguar Karevit çka ka bërë, Karevi është hidhëruar dhe i ka thënë komitit: “Edhe ju (kryengritësit) duhet të kuptoni që ne nuk jemi vjedhës por revolucioner, ne nuk jemi plaçkitës por çlirimtarë. Marsh, prapa në Aldanci dhe kërkoni falje nga Turqit për gabimin e bërë...”²²

Veprimet jologjike të kryengritësve të Kosturit (nga aspekti i qëllimit

¹⁹ Ibid., 304.

²⁰ Силянов, op. cit., 304. Чакаларов, op. cit., 346.

²¹ Чакаларов, op. cit., 347.

²² Топузоски, op. cit., 132. Нјëсој dhe Томалевски, op. cit., 265-266.

të kryengritjes) e kanë arritur kulminacionin në mesin e shtatorit të vitit 1903, kur gjysma e tyre, në krye me Çakalarovin, e kanë lëshuar Maqedoninë dhe kanë kaluar në krahinat shqiptare, në Kolonjë, në ekspeditë dënuese. Atje, disa ditë kanë djegur dhe kanë grabitur. Janë djegur së paku pesë-gjashtë fshatra myslimane. Pando Klashevi, në kujtimet e tij, i përmend emrat e fshatrave që sot gjenden në teritorin e Greqisë: Tuhli (vetëm pjesa myslimane), Livagja, Nelotej, Vrtenik, Fusha dhe Miroslavci.²³ Është e mundur edhe ndonjë fshat tjetër të jetë djegur, duke patur parasysh që vojvoda Sterjo Sterjovski, i cili ka qenë pjesë e kësaj ekspedite, në kujtimet e veta, ka shkruar që në një ditë komitët kanë djegur katër fshatra.²⁴

Për sulmin ndaj fshatit Miroslavci, Çakalarovi e ka bërë përshkrimin e mëposhtëm: “Në fshat arritëm në orën një e gjysëm dhe në të gjetëm vetëm një plakë me flokë të qethura, gjysmë e zhveshur, e mbështjellur me jorgan të leckosur; djemtë ia larguan mbulesën që të tallen me të, ajo si macë mbroheshite, i thamë të dilte jashtë, sepse do ia djegim shtëpinë, por ajo refuzonte dhe donte të mbetej brenda. Shihej që e kishin lënë me qëllim që ta djegim, por mendova që është më mirë ta lëmë të gjallë. Kryengritësit edhe këtu hëngrën mjaltë dhe grabitën gjithçka për të cilën kishim nevojë; fshati përbëhej nga tridhjetë shtëpi të cilat ishin si pallate, të mbushura me drithëra dhe pasuri. Ia futëm zjarrin dhe u nisëm kah mali Goricë...”²⁵

Siljanovi përsëri na informon edhe për çështjen që konsuli anglez në Selanik, në atë periudhë është lajmëruar nga kolegu i tij në Janinë, që kosturasit në ekspeditën e tyre në Kolonjë kanë robëruar rreth 60 gra dhe kanë lajmëruar që do t'i kthejnë atëherë kur Shqipëtarët do t'i kthejnë gratë dhe pasuritë e plaçkitura dhe të grabitura nga fshatrat e Kosturit.²⁶

Sigurisht që nuk do të pajtohemi me Siljanovin, i cili në ekspeditën

²³ С. Арсов и др., *op. cit.*, fq. 257-258. Edhe Siljanovi shkruan që kanë qenë të djegur fshatrat e njejtë, por pa Lenotejin. Силянов, *op. cit.*, 388-389.

²⁴ *cit. Силянов, cit. vepra, f. 389.*

²⁵ Чакаларов, *op. cit.*, 377-378.

²⁶ Силянов, *op. cit.*, 391.

në Kolonjë ka vërejtur “një prej veprave më shndrritëse në kohën e kryengritjes”²⁷ Përkundrazi, do të themi që edhe ekspedita në Kolonjë edhe sulmi në Bilishtë edhe djegja e Zhervenit dhe vrasja e zhervenasve paraqesin devijim nga karakteri çlirimtar i kryengritjes së Ilindenit dhe hedhin hije të errët mbi kryengritjen. Aq sa ngjarjet në Krushevë janë për lëvdatë aq edhe ngjarjet në Kostur janë për tu gjzkuar.

²⁷ Ibid., 390.



Revolucioni Xhonturk

Revolucioni Xhonturk ka filluar në territorin e Maqedonisë, më 3 korrik të vitit 1908 me kryengritjen e çetës së Ahmet Nijazi Beut nga Resnja, oficer i lartë turk me kombësi shqiptare. Më 22 korrik xhonturqit²⁸ e morën Manastirin, ndërsa ditën e ardhëshme e morën kontrollin mbi Selanikun. I ballafaquar me situatë të këtuillë në pjesën Europiane të Perandorisë, Sulltan Abdyl Hamidi i II-të natën e vonë të 23 korrikut ka qenë i detyruar që përsëri të vejë në fuqi Kushtetutën e vitit 1876 dhe të pajtohet me reforma në Perandorinë Osmane. Me këtë rast, pos tjerash, e ka shkarkuar edhe vezirin e madh të deriatëhershëm, Mehmed Ferid Pashën, i cili ka qenë me origjinë shqiptare.²⁹

Ky zhvillim ngjarjesh, zgjoi shpresa të mëdha tek popujt jo turk të cilët jetonin në teritorin e Turqisë Evropiane dhe tek pjesa progresive e popullit turk. Mbase përshkrimin më të mirë të reaksionit që ka shkaktuar Revolucionin Xhonturk e ka dhënë historianja Mersija Makdermot, njëra nga njohëset perendimore më të mira të lëvizjes nacional-çlirimtare maqedonase në dekadën e parë të shekullit XX. Ajo, në monografinë e saj për Jane Sandaskin, shkroi: “Asnjëherë në historinë e pushtetit përfaqësues shpallja e një Kushtetutë aq të ligshhtë nuk ka shkaktuar një përgjigje aq kataklizmike. Shumë pak nga subjektet e ndryshme, të përçara të Sulltanit, mund të kishin edhe idenë më të largët se çfarë në fakt nënkuptonte Kushtetuta, por gjendja e tyre psikologjike ishte e atillë që ata qiririn e kuptuan si diell dhe e mirëpritën Kushtetutën si plotësimin e mrekullueshëm të dëshirave dhe aspiratave të tyre, si panacean për të gjitha sëmundjet e tyre. Kështu, kur ata flisnin për mrekullinë që erdhi, edhe të krishterët edhe myslimanët, i’a dhanë emrin turk për atë gjënë, që në kuadër të Perandorisë Osmane, ishte aq e rrallë

²⁸ Xhonturqit kanë qenë reformistë progresivë të cilët e kanë filluar revolucionin në vitin 1908. Komiteti i tyre është themeluar në vitin 1889, ndërsa njëri nga themeluesit ka qenë edhe Ibrahim Temo, shqiptar nga Struga.

²⁹ Mehmed Ferid Pasha, https://en.wikipedia.org/wiki/Mehmed_Ferid_Pasha.

dhe aq legjendare si feniksi mitik ose si uji i gjallë në përralla. Ata thjeshtë e quanin 'liri'-huriet.”³⁰

Arsyeja për një reagim të këtyllë qëndronte në atë se “Revolucioni xhonturk e nderoi shpresën e popullit maqedonas, shqiptarë dhe popujve të tjerë në Perandori se do të zgjidhen kërkesat e tyre për barazi kombëtare dhe drejtësi sociale.”³¹ Idea bazë e xhonturqëve ka qenë që përmes reformave, Perandoria Osmane të transformohet në demokraci parlamentare moderne sipas modelit perendimor dhe të parandalojë reduktimin e mëttutjeshëm të territorit të saj. Për shkak të një sërë arsyesh (të vonuarit e Revolucionit Xhonturk, mosgatishmërisë së xhonturqëve që të bëjnë presion për reforma rrënjësore në perandori, imponimit të identifikimit qytetar të popujve të cilët janë identifikuar etnikisht, përgjigja xhonturke ndaj veprimeve armiqësore jashtë vendit, pamundësia objektive për tu bërë kompromise më të mëdha nga palët kundërshtarë, sidomos për një kohë të shkurtër), “Revolucioni” është reduktuar vetëm në aspiratë për kufizim të caktuar të absolutizmit sulltanesk, shumë nga premtimet e tij kanë mbetur të paplotësuara, euforia që ai ka shkakëtuar është treguar si e pabazë, ndërsa shkatërrimi i perandorisë, në vend se të parandalohej, është përshpejtuar.

Në këtë kapitull do të shqyrtojmë ngjarjet dhe dokumentat të cilat janë posaçërisht interesante nga këndvështrimi i hulumtimit tonë. Në pjesën e parë do t’ju kushtojmë vëmendje ngjarjeve fillestare të Revolucionit Xhonturk, miratimit të alfabetit shqip në Manastir më 22 nëntor të vitit 1908, si dhe në shuarjen e kundër-revolucionit të prillit të 1909-ës. Ndërsa në pjesën e dytë, do të analizojmë dy fjalime drejtuar popullit nga ana e Nijazi Beut dhe Jane Sandanskit, të cilat janë më pak të njohura.

³⁰ Mercia MacDermott “For Freedom and Perfection: the life of Yané Sandansky”, Journeyman Press, 1988, p. 339, http://www.promacedonia.org/en/mm/mm_19.htm Ngajshëm është shprehur dhe historiani turk Bajur Hikmet në vitin 1940: „Shumë pak lëvizje në botë kanë zgjuar aq shpresa të mëdha si revolucioni kushtetutes osman, por gjithashtu nuk egziston asnjë lëvizje tjetër në botë shpresat prej të cilës janë shuar aq shpejtë nga e njejtja.“ (cituar . Parathënie kah „Kujtimet e Nijazi-beut“, AMSHA, Shkup, 2011, 5).

³¹ Muzafer Bislimi „Shqiptarët në Revolucionin Xhonturk“, Instituti për Histori Kombëtare, Shkup, 2008,

2.1 NGJARJE

2.1.1 Epizodë antinacionaliste në fillim të revolucionit

Në fillimin e tij Revolucioni Xhonturk ka patur karakter të shprehur antinacionalist. Për këtë, posaçërisht dëshmojnë ngjarjet të cilat kanë ndodhur në Manastir dhe në Nevrokop, si dhe fjalimet e Nijazi Beut dhe Sandanskit drejtuar popullit, të cilat, siç paralajmruam do t'i përpunojmë në pjesën e dytë të këtij kapitulli.

Në Manastir, mbasi që kryengritësit e Nijazi Beut e kanë marrë kontrollin mbi qytetin në orët e mbrëmjes së 22 korrikut, ditën e nesërme i kanë çliruar të burgosurit e burgut manastiras. Në këtë rast, ata nuk kanë bërë aspak dallim se kujtë kombësie i kanë takuar të burgosurit, por thjeshtë i kanë çliruar të gjithë. Nga të burgosurit, siç shkruan Katerina Todorovska, gjysma kanë qenë maqedonas.³²

Përshkrim të mirë të ngjarjeve të mëtutjeshme nga kjo ditë jep Angel Dinevi: „Njëmijë e dyqind veta, të burgosur për krime me karakter të ndryshëm mblidheshin në kishën qendrore ku erdhi edhe muzika ushtarake. Ashtu u formua kortezh, i cili u drejtua kah rruga e Sokakut të Gjerë, pranë lumit Dragor dhe u ndal përpara shtëpisë së valiut që t'ia përcjellë të falat për lirinë e fituar. Në emër të të gjithë të burgosurëve, i ngritur në duart e të tjerëve, revolucionari Ivan Nelçinovi, i dënuar me burg të përjetshëm, mbajti fjalim përshëndetës dhe e siguroi valiun për bashkëpunimin e pazezervë të cilën do t'ia shfaqin pushtetit Sllavët Maqedonas, për hirë të lirive të dhëna. Në frymën e njejtë, i kënaqur u përgjigj valija. Aty ishte edhe revolucionari Ejup Sabri [nga Komiteti Xhonturk], i cili mbajti fjalim revolucionar, e sqaroi kuptimin e ndryshimit të ngjarë dhe i përshëndeti manifestuesit. Mbas përshëndetjeve të shkëmbyera, manifestuesit i ngritën në duar valiun dhe Ejup Sabrin dhe ashtu i dërguan deri në konak. Mbas kësaj kortezhi i manifestimit u kthye rrugës së njejtë, prej nga filloi, atje mbaroi“³³

³² Катерина Тодороска, „Политичките и културните врски меѓу Македонците и Албанците 1903-1913“, „Менора“, Скопје, 2008, 166.

Për atmosferën në Manastir gjatë atyre ditëve shkruan edhe Toma Nikolovi, prift ortodoks dhe veprimtar i VMORO-së, i cili poashtu ka qenë i liruar nga burgu. Ai do të konstatojë se: „Të dobët e kam penën për të përshkruar se si atëherë i tërë Manastiri ishte i dehur nga lumturia... Rrugëve, lokaleve dhe kafeneve gjithandej dëgjohej muzikë, këngë dhe hare. Manastirasit nuk lejuan që asnjëri nga të burgosurit nga provinca të shkojnë në hotel, por i shpërndanë nëpër shtëpi, dhe nuk pat shtëpi pa mysafirë.“³⁴

Pastaj në Manastir ka ardhur deri te hyrja solemne e çetave: shqiptare, maqedonase dhe greke. Të parat kanë hyrë çetat shqiptare, më 24 korrik. Çerçiz Topulli dhe Adem-beu, fillimisht janë pritur solemnisht në Resnjë, ndërsa pastaj, së bashku me Nijazi-beun, Apostull Mihajlovsin dhe një numër të madh shqiptarësh dhe maqedonasish, janë nisur për në Manastir. Në Manastir kanë hyrë nga Mëhalla e Arnautëve dhe janë mirëpritur solemnisht nga populli i mbledhur.³⁵ Nijazi-beu në kujtimet e tij do të shkruaj: „Sikur i tërë Manastiri, ai qytet i madh prej 50.000 banorësh, kishte dalë të na presë. Të gjitha kombësitë, i tërë populli ishte një trup dhe një shpirt.“³⁶

Më 27 korrik Komiteti Xhonturk në Manastir ka organizuar pritje solemne madhështore për çetat e VMORO-së, të cilat kanë ardhur nga Smileva përmes Caparit. Ata i ka pritur ushtria në krye me Nijazi-beun, oficerë të shumtë, zyrtarë dhe qytetarë me flamuj dhe muzikë.³⁷ Toma Nikollovi për këtë ngjarje shkruan: „Sapo u dha shenja se çetat [e VMORO-së] po afrohen ushtoi muzikë ushtarake. Në emër të qytetit arriti Qemal-beu në kalë me galop dhe buqetë me lule në duar e takoi

³³ Динев, *op. cit.*, II vëllim, 434.

³⁴ Toma Nikolov „Kujtime nga e kaluara ime“, Fronti oтечествен, Sofia, 1989, http://www.promacedonia.org/tn/tn_25.html Ngjajshëm ka njoftuar edhe konzulli sërb në Manastir: „Manastiri është i tëri në festë, çarshija është mbyllur, ndërsa të gjithë janë në rrugë dhe festojnë“ (*cit. sp. Bislimi, cit. vepra, fq.90.*)

³⁵ Бислими, *op. cit.*, 89-90. Масар Кодра, „Младотурската револуција и албанското ослободително движење“ në „Гласник на ИНИ“, 1/1968, 122.

³⁶ „Спомените на Ниязи-бег“, *op. cit.*, 237.

³⁷ Јусуф Хамза, „Заемните односи меѓу прогресивните османски кругови и македонското револуционерно движење во втората половина на 19 и почетокот на 20 век“, „Студентски збор“, Скопје, 1988, 169.

[Milan] Matovin me ca fjalë përkatëse. Pastaj u shfaqën çetat të renditura rresht në krye me një flamur të zi, me kafkë njeriu mbi dy kocka njerëzish në kryq, shkruar mbi të. Pas tij, nga dy çetas, të cilat kalëronin kuaj të bardhë, mbanin imazhin e Dame Gruevit, të vizatuar në pëlhurë të bardhë. Pastaj, shkonte Milan Matovi me kalë, i armatosur vetëm me një revolver dhe me një shirit të kuq rreth krahëve, ndërsa pas tij vinin vojvodat dy nga dy, me armatim të plotë ushtarak, të gjithë mbi kuaj të bardhë, të ndjekur pas nga çetasit kalorës dhe këmbësorë, të rreshtuar dy nga dy me pushkë në krahë. Sapo u shfaqën çetat, rrufeshëm, Jashasën huriet [rroft liria] dhe ‚Ur-ra-a-a‘ e çanë ajrin. Njësitë ushtarake, nën komandë të oficerëve të tyre, dhanë nderime ushtarake dhe një plotun i artillerisë polake e tundi qytetin. Kortezhi i Devejanit [paralagje manastirase] u drejtua kah qyteti dhe u ndal përpara administratës së vilaetit, ku valiu, i shoqëruar nga dinjitarët e lartë të tij, zbriti deri në derën e hymjes dhe e përshëndeti Matovin me ca fjalë të përshtatshme. Pastaj nëpër Sokakun e Gjerë bëme një qark dhe arritëm në oborrin e kishës ‚Shën Mëria‘.³⁸ Vetë Milan Matovi, kryetar i atëhershëm i qarkut të VMORO-së së Manastirit, në kujtimet e tij shkroi se ata kanë pritur pritje të mirë në Manastir, por se pritja e harbuar rrugëve të Manastirit i ka tejkaluar edhe parashikimet e tyre më optimiste. Ndërsa në fjalimin e tij, mes tjerash, ai ka potencuar edhe këtë: ‚Poqese përsëri do të vijë era tirani, ne dhe xhonturqit duhet të jemi të gatshëm që krahë për krahë t‘i rezistojmë kësajë tiranie e cila e ka jetuar më kohën e saj.³⁹

Vlen të theksohet edhe ajo se ditën e ardhëshme, në Sokakun e Gjerë, vlonte nga vojvodë dhe çetas, të cilët janë përzier me çetasit e Nijazi-beut, i cili vetë ka patur veshur veshje shqiptare.⁴⁰ Është interesant momenti që e vëren Mihal Grameno në memoaret e tij, moment që është i lidhur me festimin e lirisë dhe ikonografija përreth sajë. Gjegjesisht, ai përmend se në defilimin nëpër Manastir të çetave të ndryshme xhonturqe, ai asgjëkundi

³⁸ Николов, оп. cit.

³⁹ Милан Матов „Комитата раскажува...“, „Бигос“, Скопје, 2002, 195 dhe 196.

⁴⁰ Николов, оп. cit.

nuk e ka parë flamurin shqiptar. Ndoshta flamuri nuk ka qenë aq shumë me rëndësi sa që ka qenë e rëndësishme lirija.⁴¹

Disa ditë pas çetave të VMORO-së, rrugës prej Lerini në Manastir kanë arritur edhe çetat greke andarte,⁴² të cilat poshtu kanë defiluar në Sokakun e Gjërë (përkth. Në Maqedonisht: Shirok Sokak). Edhe ata janë mirëpritur nga Këshilli për Mikpritje në krye me Nijazi-beun.⁴³

Përndryshe, mbledhja e forcave ushtarake në Manastir, xhonturke dhe e të tjerave, s'është bërë vetëm me qëllim që të tregohet fryma e re e bashkëjetesës në Perandori. Situata në ato ditë të para pas revolucionit akoma nuk ka qenë e qartë, kështu që në rast nevojë është planifikuar që forcat ushtarake të dërgohen në Selanik dhe në Stamboll.⁴⁴

Kjo atmosferë në Manastir në ato ditë të para të Revolucionit Xhonturk, mbase mund të krahasohet vetëm me hyrjen e çetës së Jane Sandanskit në Nevrokop (qyteti i sotëm Goce Dellçev në Bullgari).

Kur ka shpërthyer revolucioni, Sandanski me çetën e tij është gjendur në fshatin Gajtaninovë, rreth 20 kilometra në jug të Nevrokopit. Duke e ditur që Sandanski është në Gajtaninovë, xhonturqit kanë dërguar delegacion në këtë fshat që të takohet me të. Kur delegacioni xhonturk, i shoqëruar me zurla e tupana, i është afruar fshatit, kambanat në fshat kanë jehuar, ndërsa Sandanski dhe çetasi e tij, të shoqëruar nga i tërë fshati, kanë dalë ti presin. Gjatë takimit, siç shkruan Marsija Makdermot, dy grupet janë përqafuar „si vëllezër të humbur gjatë kohë“, që më pas të drejtohen së bashku kah fshati, ku është festuar deri natën vonë.⁴⁵

Ditën e ardhshme, revolucionarët xhonturk dhe maqedonas, së bashku janë drejtuar kah Nevrokopi. Rrugës, e tërë popullata e fshatrave nëpër të cilat kanë kaluar ka dalë që t'i shohë, ndërsa shumica ju është bashkangjitur. Kur kanë arritur para Nevrokopit, kanë vërejtur se e tërë popullata e qytetit, përfshirë edhe ajka, ushtarët lokal dhe policia, si dhe

⁴¹ Mihal Grameno, „Novela dhe kujtime“, Enti i botimeve shkollore i Republikës Socialiste të Sërbisë, Prishtinë, Shkup, 1969, 212.

⁴² Njëlloj

⁴³ „Спомените на Нијази-бер“, cit. vepra, 239 fq.

⁴⁴ Анастас Митрев, „Мемоари, огледи, статии“, „Нова Македонија“, Скопје, 1974, 46.

⁴⁵ MacDermott, op. cit., 341-342.

qytetraët e thjeshtë të krishterë dhe myslimanë, ka dalë ti mirëpresë. Makdermot citon një soditës (dëshmitarë) i cili ka vënë re se „vetëm qentë kanë mbetur në Nevrokop“. Kur nevrokopasit kanë vërejtur kortezhin e Sandanskit dhe të xhonturqëve, ngashërimi ka arritur kulmin, ndërsa ajri ka jehuar me thirrje si: „Liri, barazi! Rroft atdheu! Rroft barazia!“ Më pastaj dy kortezhët janë bashkuar, Sandanski dhe ajka janë përqafuar dhe puthur, përderisa masa multinacionale ka thërritur: „Rroft liria!“ Pasi janë drejtuar kah Nevrokopi, Sandanski dhe çetasi e tij „kanë vjedhur shoun“: kanë filluar të këndojnë këngën socialiste „Këngë për punën“ nga socialisti bullgar Gjeorgji Kirkov.⁴⁶

Pas Nevrokopit, Sandanski dhe çeta e tij, janë drejtuar kah Selaniku, ku në stacionin hekurudhor janë pritur nga delegacion i posaçëm xhonturk në krye me Enver-beun, udhëheqësin e Revolucionit Xhonturk.⁴⁷

2.1.2 Kongresi i Manastirit

Nga 14 deri më 22 nëntor 1908 në Manastir është mbajtur kongres me rëndësi të madhe për popullin shqiptar. Ky kongres është mbajtur me qëllim që të arrihet marrëveshje rreth alfabetit shqip, çështje rreth së cilës ka patur zëra të ndryshëm nga veprimtarët shqiptarë të asajë kohe. Nevoja për unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe është aktuelizuar pas fitores së Revolucionit Xhonturk, kur ka filluar zhvillimi dhe përhapja e shkollave shqipe, e me këtë ka lindur nevoja për tekste dhe letërsi në gjuhën amëtare shqipe për fëmijët.⁴⁸

Këtu nuk do të ndalemi shumë tek hollësitë e lidhura me miratimin e alfabetit. Do të shqyrtojmë një të dhënë të imët, por jo edhe të parëndësishme. Njëherit, në kogres kanë marrë pjesë 52 delegatë, prej të cilëve 32 kanë patur të drejtë vote. Megjithatë, në kongres nuk kanë

⁴⁶ Ibid., 343-344. Teksti i këngës mund të ndëgjëhet në këtë lin: <http://detstvoto.net/index.php?newsid=478> përderisa performansi muzikor mund të ndëgjohe në këtë link: <http://www.youtube.com/watch?v=IP026CUzVoI>.

⁴⁷ Манол Пандевски, „Јане Сандански (1872-1915): биографски прилози“, „Наша книга“, Скопје, 1985, 44 dhe 141.

⁴⁸ Рамиз Абдули „Албанското ослободително движење 1908-1910“, ИНИ, Скопје, 2002, vëllimi I, 116.

marrë pjesë vetëm këto delegatë. Në të gjithsej kanë marrë pjesë deri më 400 njerëz, mes të cilëve, përsikaj shqiptarëve, ka patur edhe maqedonas, turq, grekë, vllahë, dhe të tjerë.⁴⁹ Kjo e dhënë e thjeshtë faktografike në thelb tregon dy gjëra: e para, se veprimtarët shqiptarë nuk kanë dashur të „mbyllen“ në korniza kombëtare dhe, e dyta, se ka patur njerëz me identifikim të ndryshëm etnik të cilët kanë konsideruar se me prezencën e tyre duhet ti japin mbështetje këtij kongresi. Miratimi (adoptimi) i alfabetit të një gjuhe nuk është vetëm e rëndësishme nga pikëpamja e interesave kombëtare të popullit që e flet atë gjuhë, por është edhe një dobi mbarëcivilizuese, sepse në atë mënyrë mundësohet përhapja e shkrimit dhe leximit si dhe e kulturës. Kuptohet që ka patur edhe të tillë që kanë menduar ndryshe dhe që gjërat i kanë parë kryekëput në mënyrë nacionaliste. Kanë egzistuar gjithmonë. Por, kjo nuk e mohon edhe egzistencën e njerëzve me pamje të hapura të cilët nuk nisen nga pozicione të ngushta nacionaliste.

Prezenca e jo-shqiptarëve në Kongresin e Alfabetit Shqip, nga njëra anë, është edhe kritikë e nacionalizmit të sotshëm shqiptarë dhe nacionalizmave të tjerë. Është kritikë e nacionalizmit shqiptar, meqë nacionalistët shqiptarë e interpretojnë Kongresin e Manastirit nga pikëpamja e rëndësisë së tij për shqipëtarët si etnos pa i'u qasur fare rëndësisë së tij nga aspekti mbarëcivilizues. Të njejtën gjë e bëjnë edhe nacionalistët tjerë, kur, të paktën, me aspirata të liga duke e toleruar faktin historik të mbajtjes së Kongresit së Manastirit, e vlerësojnë të njejtin vetëm nga këndvështrimi i rëndësisë së tij për kauzën shqiptare. Nëse gjërat nuk vlerësoheshin përmes prizmit të „kombëtares“ (që është gjë tipike për të gjithë nacionalistët pavarësisht identifikimit të tyre etnik) sidomos manastirasve duhet t'ju vinte mirë që një ngjarje me aspekt mbarëcivilizues ka ndodhur pikërisht në qytetin e tyre.

⁴⁹ Бислими, cit. vepra, 171 fq. Абдули, cit. vepra, 116 fq. Кодра, cit. vepra, 128 fq.

2.1.3 Puçi kundër xhonturqëve më prill të vitit 1909

Edhe pse xhonturqit, që në vitin e parë të kryengritjes së tyre, nuk i plotësuan pritshmëritë e popujve joturk në Perandori, pasi që më 13 prill të vitit 1909 reaksionarët islamik bënë puç kundër xhonturqve, edhe revolucionarët maqedonas edhe ata shqiptarë me armë në dorë qëndruan në mbrojtje të Revolucionit Xhonturk, duke e konfirmuar me këtë gjë, zotimin dhe besimin e tyre se problemet me të cilat ballafaqohej populli në Shqipëri dhe në Maqedoni mund të zgjidhen në kuadër të Perandorisë Osmane pa patur nevojë për mëvetësimin në shtete të posaçme.

Ajo që duhet patur parasysh është se mëvetësimi në një shtet të posaçëm jo domosdoshmërisht do të thotë që populli do të jetë i lirë, se do të ketë të drejta dhe se standardet sociale do të jenë në një nivel të lartë. Rrjedhimisht, nëse mëvetësimi më shtet të posaçëm nuk do të thotë edhe çlirim dhe nëse egziston mundësi që në kornizat e shtetit egzistues të fitohet liria, të drejta dhe drejtësi sociale, atëherë përse ata të cilët nuk janë për mëvetësim vetëm për hir të mëvetësimit, gjegjësisht, përse ata të cilët nuk janë nacionalistë të përpiqen t'i zgjidhin problemet e popujve të tyre në suaza të shteteve egzistuese? A është tirania më pak tirani poqese tirani ka të njejtin identifikim etnik me popullin? Edhe përse mos të jetë e mundur të shijohen liri, të drejta dhe standarde sociale të larta në një shtet multietnik? Ky lloj i mendimit që motivim përse një pjesë e revolucionarëve maqedonas dhe shqiptarë të qëndrojnë në mbrojtje të Revolucionit Xhonturk, edhe pse i njejtë dëshpëronte sa vinte e më shumë.

Tek shqiptarët, puçi kundër xhonturqve nuk ka fituar mbështetje të madhe. Atë e kanë mbështetur vetëm një numër i vogël i pronarëve të mëdhenj të çifligëve dhe klerikëve fanatik myslimanë. Nga Stambolli në Shkup ka udhëtuar myftiu i Prishtinës Mustafa-efendiu me detyrë që të përhapë kryengritjen në vilajetin e Kosovës, sidomos mes shqiptarëve. Ai, me mbështetjen e disa hoxhallarëve ka organizuar protestë përpara ndërtesës së komunës me kërkesë që të bie nga pushteti Këshilli Xhonturk. Edhe përsëri kësaj, kundër-revolucionarët nuk kanë fituar mbështetje më të madhe. Veç më në ditën e nesërme në Shkup është organizuar tubim i madh kundër sulmit anti-kushtetar, në të cilin kanë marrë pjesë

disa mijëra turq dhe shqiptarë. Në këtë tubim, Sali-beu, kundërshtar i xhonturqve, në fjalimin e tij ka vënë në pah të gjitha mangësitë e regjimit xhontuk, por ka theksuar se këto kanë qenë gabime të tyre, dhe jo të Kushtetutës. Me atë, ai e ka mbështetur Kushtetutën, por jo edhe pushtetin xhonturk. Nijazi-beu, nga ana tjetër, ka mbledhur 10.000 deri më 12.000 vullnetarë shqiptarë, të cilët kanë arritur me të prej Manastiri në Selanik, të gatshëm për tu nisur për në Stamboll. Gjithsej, numri i vullnetarëve shqiptarë të mbledhur në Selanik ka arritur deri më 30.000.⁵⁰ Në ekspeditën për në Stamboll, nga revolucionarët më të njohur shqiptarë, ka marrë pjesë Çerçiz Topulli.⁵¹

Tek maqedonasit, e djathta ka marrë pozicionin e neutralitetit mes xhonturqëve dhe reaksionit. Kundrejt saj, nën udhëheqjen e Jane Sandanskit, Hristo Çernopeevit dhe Todor Panicës në ushtrinë xhonturke për shtypjen e reaksionit janë kyçur rreth 1.200 vullnetarë. Ata kryesisht kanë qenë anëtarë të krahut të majtë të VMORO-së, si dhe anëtarë të Federatës Socialiste të Selanikut, e udhëhequr nga Avram Benaroja.⁵³

Ushtria e cila është nisur nga Maqedonia me qëllim që të ngulfasë puçin kundër-revolucionar në Stamboll, e në rradhët e të cilës ka patur vullnetarë shqiptarë, maqedonas, grekë, dhe ermenë, ka arritur për një kohë shumë të shkurtër, më sakt, për tri ditë, të arrijë qëllimin e saj. Më 24 prill është marrë oborri i sulltanit, ku ka luajtur rol të rëndësishëm Todor Panica.⁵⁴ Sulltan Abdyl Hamidi ka qenë i detyruar të heqë dorë prej fronit, dhe pas disa ditëve si sulltan i ri është vendosur vëllai i tij Mehmed Reshadi i V-të. Lajmin për heqjen nga froni Sulltan Abdyl Hamidit ja ka kumtuar një komision i posaçëm në krye të të cilit ka qenë shqiptari Esad Pashë Toptani.⁵⁵

⁵⁰ Абдули, op. cit., 194-197 dhe 204. Бислими, op. cit., 205-206.

⁵¹ Тодороска, op. cit., 125.

⁵² Антони Гиза „Балканските държави и македонският въпрос“, Македонски Научен Институт, Софија, 2001, http://www.promacedonia.org/ag/ag_2_8.html; Тодор Чепреганов (redaktor) „Историја на македонскиот народ“, Институт за национална историја, Скопје, 2008, 208.

⁵³ MacDermott, op. cit., 393.

⁵⁴ Јане Богатинов „Отиването в Цариград – 31 март 1909 год.“, http://www.sitebulgarizaedno.com/index.php?option=com_content&view=article&id=364:2011-12-30-19-53-25

⁵⁵ Бислими, op. cit., 213.

Ditën e ardhshme pas shuarjes së kundër-sulmit, ushtritë xhonturke dhe vullnetarët kanë defiluar rrugëve të Stambollit. Revolucionarët maqedonas edhe atje e kanë kënduar këngën socialiste „Këngë për punën“,⁵⁶ ndërsa sipas një të dhëne veçanërisht interesante, është se kur kanë kaluar nën ndërtesën e Ambasadës së Mbretërisë Ruse, Panica e ka ndërprerë këngën të cilët të tjerët e kanë kënduar në atë moment, duke filluar të këndojnë këngën revolucionare ruse „Guximshëm, shokë“. Të tjerët i janë bashkangjitur, me ç’rast personeli i ambasadës menjëherë i ka mbyllur dritaret dhe ka hyrë brenda në ambasadë,⁵⁷ i revoltuar nga shprehja kaq e hapur e mbështetjes për revolucionarët rus dhe për revolucionin e tyre në vitin 1905.

2.2 FJALIMET E NIJAZI-BEUT DHE SANDANSKIT DREJTUAR POPULLIT

Nijazi-beu dhe Sandanski kanë mjaft gjëra të përbashkëta mes tyre. Edhe njëri, edhe tjetri kanë dashur t’i japin shans Revolucionit Xhonturk, edhe njëri edhe tjetri nuk kanë konsideruar se me çdo kusht duhet formuar shtet i pavarur shqiptar apo maqedonas, të dy kanë qenë për bashkjetesë mes njerëzve me kombësi dhe fe të ndryshme. Në drejtim të krijimit të një fryme për bashkëjetesë tek populli, që të dy në fillim të revolucionit kanë drejtuar proklamata drejt popullit, të cilat do t’i shqyrtojmë në vijim.

Nijazi-beu, njeriu i cili e ka filluar Revolucionin Xhonturk, nga kryengritja me çetën e tij në rajonin e Resnjës më 3 korrik e deri në hyrjen në Manastir më 22 korrik, ka lëvizur në rajonin e Maqedonisë Perendimore, ku ka hasur në pritje të mirë, sidomos tek popullata shqiptare e atyre trojeve.⁵⁸ Por, edhe përvoja me popullatën maqedonase ka qenë e mirë. Vetë Nijazi-beu e shënon rastin me hyrjen e çetës së tij në Vevçan. Në fillim kryengritësit kanë hasur në porta të mbyllura në fshat, dhe në fshatarë të

⁵⁶ MacDermott, op. cit., 395.

⁵⁷ Богатинов, cit. vepra. Teksti i këngës, në gjuhën ruse dhe angleze, si dhe performansi muzikor i sajë mund të ndëgjohet në këtë link: <http://www.youtube.com/watch?v=t5rRC2y3Guk>.

⁵⁸ Бислими, op. cit., 76.

frikësuar, por pasi Nijazi-beu i ka mbledhur dhe u'a ka kumtuar qëllimet e kryengritjes së tij dhe të Revolucionit, fshatarët e kanë pranuar atë dhe çetën e tij dhe frika si dhe mosbesimi janë mënjanuar.⁵⁹

Posaçërisht e rëndësishme nga aspekti antinacionalist është proklamata e tij drejt popullatës së krishtere në Maqedoninë Perendimore, të cilën ai e ka kumtuar më 5 korrik, dy ditë pas kryengritjes, nga rajoni i Ohrit. Këtu fillimisht do të transmetojmë tekstin e proklamatës, e më pastaj do të bëjmë analizë të saj.

Proklamata e Nijazi-beut, drejtuar fshatarëve të krishterë në Dibër, Prespë, Strugë, Resnjë dhe Ohër⁶⁰

Dua t'i njoftoj vëllezërit e mi të krishterë dhe osmanë se ka ardhur koha t'ju jipet fund përfundimtar të gjitha padrejtësive më shumë shekullore ndaj vendit tonë. Duke dëgjuar fuqitë e mëdha europiane dhe gënjeshtret e tyre të bëra nën maskën e të ashtuquajturit civilizim dhe duke dëgjuar dëshirat e shteteve të vogla fqinje Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë, erdhëm në një situatë të këtyllë kaq të keqe.

Ka çerek shekulli që Bullgaria, Greqia, dhe kohëve të fundit edhe Serbia të cilat punojnë kinse për t'ju ndihmuar, juve popullatës në Maqedoni ju premtojnë se kinse do t'ju çlirojnë, por, meqë nuk arritën të bëjnë një gjë të tillë, duke dashur që t'ju shtypin, shtetet e përmendura u grindën mes vete. Ata e mbollën farën e përçarjes dhe shkatërrimit e cila e ngjyrosi tokën me gjak. Të dashur bashkëatdhetarë! Të dashur bashkëatdhetarë të krishterë e osman! A nuk e shihni se shtetet e vockla fqinje nuk punojnë për interesat tuaja, se nuk derdhin gjak për ju, por se punojnë vetëm për interesa të vetat dhe për robërimin tuaj?

Nga përvoja juaj e hidhur a nuk e dini se cilët janë ata njerëz të cilëve u'a hapni krahët për përfaqim? Vallë, akoma nuk e kuptuat se duke përfutuar nga gjendja e qeverisë osmane në Rumeli, shtetet fqinje duke futur komita dhe duke ushtruar propagandë duan të realizojnë vetëm interesat e tyre? Aspiratat e tyre janë që të copëtojnë këtë vend në të cilin ne jetojmë

⁵⁹„Спомените на Ниџази-бег“,ор. cit., 153-154. Бислими, ор. cit., 77.

⁶⁰Јусуф Хамза, „Младотурската револуција во Османската империја“, „Логос-А“, Скопје, 1995, 535-538.

me shekuj. Fundi i aspiratave të përmendura është robërimi.

Të dashur bashkëatdhetarë! Bullgarë!⁶¹ Jo vetëm tridhjetë, por edhe gjashtëdhjetë vjet të punojnë kështu Bullgaria, Serbia dhe Greqia nuk do ti arrijnë qëllimet dhe përfytyrimet e tyre. Kjo tokë është e jona dhe do të mbetet e jona. Do të pendoheni poqese jeni bashkëpunorë të tyre. Ne jemi të vendosur që për këtë tokë të vdesim deri në njeriun e fundit. Andaj, mos shkoni drejt një qëllimi të paarrtshëm, ajo nuk do t'ju lejohet. Për këtë neve nuk na detyroi të kuptuarit e qëllimeve të nxitjeve të shteteve të mëdha e të vogla, por arsye shtesë për këtë është keq-qeverisja dhe regjimi i shtypjes nga ana e qeverisë tonë. Pastaj, arsyet të cilat i'u lejuan shteteve të mëdha të përzihen në punët tona, të nxisin shtetet e vogla fqinje, gjenden në politikën e keqe të brendshme dhe të jashtme, qeverisjen e keqe, në parregullsitë, në paligjshmërinë dhe në keqpërdorimet e qeverisë sonë.

Të dashur bashkëatdhetarë të krishterë, edhe ne nuk jemi të kënaqur me qeverisjen e sotme të padrejtë. Shihni që nuk jeni vetëm ju të pakënaqur me qeverisjen e sotme. Ne deri më tani nuk e ngritëm zërin kundër Evropianëve të cilët duan t'na e marrin atdheun, të n'a përzihen në punët tona dhe në jetën e keqe të popullit. Duke parë që regjimi i vjetër dita ditës fuqizohet shumë e më shumë dhe se është në rrugë për t'i shkatruar bashkëatdhetarët tanë turqit, bullgarët, vllahët, grekët, shqipëtarët, ne luftojmë për formimin e një sistemi rregullimi i cili do t'i sjellë diellin e lirisë dhe do të përhapë dritën e lirisë në tërë vendin. Ja, ne turqit, të cilët pamë se në regjimin absolutist të sotëm do të shuhet ardhmëria e vendit, luftojmë që Perandorinë Osmane dhe pakicat kombëtare të cilat jetojnë në të, t'i mbledhim nën një çati të njëjtë. Me këtë qëllim ne e formuam edhe Shoqatën „Ittihat ve teraki“ [Bashkim dhe Progres].

Për këtë qëllim të shenjtë shoqata e formuar, marrë përgjithsisht, është e përbërë nga oficerë me gradë të lartë dhe të ulët, nga shërbyes shtetëror, nga njerëz të ndershëm të shkolluar nga bashkësi, qytete e fshatra. Këto njerëz janë të gatshëm të punojnë për këtë atdhe të shenjtë shpirtërisht dhe materialisht. Qëllimi i vërtetë i shoqatës është që të gjithë pakicave kombëtare në vend t'ju garantohet nderi, siguria personale dhe siguria e pronës, të mundësohet jetë vllazërore e cila mund të arrihet vetëm me sigurimin e barazisë, vllazërisë dhe lirisë.

Qëllimi i programit tonë është që, në vend të njerëzve të këqinjë, të likvidohen sistemet e këqija. Qëllimi ynë është që nga njerëzit e këqinjë më shumë t'i likvidojmë të këqijat dhe ta

⁶¹ Në atë kohë popullata sllave në Maqedoni zakonisht është konsideruar si bulgare, edhe pse proqesi i identifikimit të tijë etnik akoma nuk ka qen i përfunduar.

ndryshojmë regjimin absolutist i cili është burimi i të gjitha të këqijave. Kjo do të thotë dhënien e një kahjeje të besueshme shoqërore për lirinë e shtetit, gjegjësisht vendosjen e sistemit kushtetues në vend. Detyra jonë është që të afirmojmë dhe të propagojmë qëllimin e Shoqatës „Ittihat ve teraki“ nëpër qytete, fshatra, të sigurojmë unitet për tejkalimin e situatës e cila është shkaktuar nga të këqijat e bëra ndaj pakicave kombëtare si dhe sigurimin e bashkimit të popullit. Nuk ka asnjë lloj dallimi mes nesh. Ne të gjithë jemi osmanlinjë. Konfesionit është punë që i bashkon njerëzit me Allahun. Nuk ka të bëjë me atdheun. Ata që gjenden nëpër qytete dhe fshatra, duke e ditur se çetat tona janë ngritur nga populli, për fitimin e lirisë, barazisë dhe drejtësisë, duhet t'i shkapërderdhin çetat e tyre. Le ti bashkohen çetës tonë e cila lufton për lirinë e atdheut nga regjimi i tanishëm absolutist. Ju ftoj si bashkëatdhetarë, këto fjalë të mijat t'ua transmetoni përgjegjësve tuaj dhe t'ju thoni që ju ftoj për krijimin e një uniteti për të gjithë ne.

Ti lejmë mendimet e këqija të vjetra dhe separatiste dhe të bashkohemi për sigurimin e një ardhmërie më të ndritur për të gjithë popujt në kufijtë e shtetit tonë. Duke i shikuar me sy të njejtë të gjithë popujt të cilët jetojnë në shoqërinë osmane, të bëhemi vëllezër. Kur t'ju vijë në duar kjo proklamata e imja, lexojeni dhe dëgjojeni bashkarisht. Këshilloni çetat tuaja të sillen sipas udhëzimeve të mijta. Që sot të heqin dorë nga shërbimi i marrë ndaj Bullgarisë dhe ndaj shteteve të tjera të vockla. Të punojnë për osmanllëkun i cili ayre do t'ju sigurojë barazi dhe liri. Të gjitha pakicave kombëtare ju garantohet liria e mendimit fetar dhe kombëtar. Si bullgarët, grekët, sërëbët, vllahët...ashtu edhe gjithë të tjerët do të mund të ruajnë veçorinë e tyre kombëtare, do të përdorin gjuhën amëtare dhe liria e tyre do të jetë nën mbrojtjen e shtetit.

Me bashkimin e pakicave të shumta kombëtare, kombi i krijuar osman do të bëhet fuqi e madhe e cila do të mbrojë sistemin kushtetuto-parlamentar. Për ruajtjen e lirisë e cila së shpejti do të sigurohet, me krenari ju kujtoj se çetat tuaja duhet t'ju kyçen çetave tona. Pas dorëzimit të kësajë proklamate, ne edhe më tutje do t'u bëjmë qark qyteteve dhe fshatrave dhe aty ku do të vërejmë se programi ynë nuk realizohet, bllokuesve të realizimit të tij do t'ju kërkojmë përgjegjësi, ndërsa fshatrat e tyre do ti shkatrojmë. Pas marrjes së kësajë proklamate, nëse ndonjë çetë hy në ndonjë fshat, popullësia e fshatit e ka për detyrë që menjëherë për këtë të njoftojë fshatin më të afërt mysliman dhe ushtrinë. Nëse këtë gjë nuk e bëni, do të varen të parët e fshatit tuaj. Kjo është baza e planit dhe programit tonë. Përsëri ju kujtoj se duhet të hiqni dorë nga idetë për ndarje dhe separatizëm. Poqese dikush përipiqet që të kundërshtojë këtë, pavarësisht nëse është mysliman apo i krishterë, apo kujtdo përkatësie fetare i takon, do të jetë i dënuar rrept. Duke vepruar të gjithë bashkë, përsëri do të vëmë në

përdorim Kushtetutën e vendosur, e më pas të suspenduar. Për këtë qëllim duhet të punojë çdo bashkëatdhetar.

*Komandanti i bataljonit popullor të Resnjës
vicemajor
Nijazi*

Siç mund të shihet, në proklamatën e Nijazi-beut drejt popullatës së krishterë ka më shumë fjalë si „vëllezër“ dhe „të dashur bashkëatdhetarë“. Kësajë popullate i kumtohet se qëllimi i xhonturqëve, pos tjerash, është që pakicave kombëtare t’ju garantohet nderi, siguria personale, dhe siguria e pronës, gjë e cila është e mundur vetëm përmes sigurimit të lirisë, barazisë, vëllazërisë dhe drejtësisë në Perandori. Përveç kësajë, thuhet se të gjitha pakicave kombëtare do t’ju garantohet liria e mendimit fetar dhe kombëtar, se secili do të mund të ruaj veçorinë e tij kombëtare, se do të mund të përdorë gjuhën e vet’ amëtare dhe se liria e tij do të jetë në mbrojtje të shtetit. Gjithashtu, në proklamatë theksohet se përkatësia fetare nuk ka të bëjë me atdheun dhe se nuk mund të jetë bazë për bërjen e dallimeve sa ju përket të drejtave mes popullatës myslimane dhe të krishterë, ashtu siç ishte rasti në kohën e absolutizmit sulltanesk. Duke treguar se të gjithë popujt të cilët jetojnë në shoqërinë osmane do t’i shohë me sy të njejtë, Nijazi-beu i thërret të krishterët- „të jemi vëllezër“!

Padyshim, të gjithë këto pika të kësajë proklamate janë për tu përhëndetur nga pikëpamja antinacionaliste. Megjithatë, në lidhje me këtë proklamatë do të themi që, nga pikëpamja antinacionaliste, ajo ngelet pas Manifestit të Krushevës dhe pas Manifestit të Jane Sandanskit. Asaj i mungon ngrohtësia e këtyre manifesteve, e përveç kësajë ajo përmban edhe kërcënime për sanksione në rast se nuk veprohet ashtu siç konsiderohet se është e drejtë të veprohet. Pra, në proklamatën jo vetëm që kërkohet shkapërderdhja e menjëhershme e çetave të pakicave kombëtare, veprimi i të cilave është karakterizuar si „shërbim i marrë“ ndaj shteteve ballkanike fqinje, por është drejtuar edhe kërcënim drejt bllokuesve të realizimit të programit të xhonturqve, se do t’u kërkohet

përgjegjësi, ndërsa fshatrat e tyre do të shkatërrohen. Gjithashtu, është theksuar se do të varet paria e atyre fshatrave të cilët nuk do të njohtojnë fshatin më të afërt mysliman dhe ushtrinë se ndonjë çetë jo-xhonturke ka hyrë në fshatin e tyre.

Deklaratat e tilla nuk mund ti vlerësojmë si të drejta. Bashkim fetar dhe nacional nuk mund të realizohet nëpërmjet kërcënimeve ndaj gjithkujt që prej momentit të parë nuk do të jetë i bindur se dora e zgjatur është e sinqertë. Veprimet janë ato që duhet t'i bindin të gjithë ata që dyshojnë vërtetësinë e qëllimeve, e jo kërcënimet. Revolucioni xhonturk, përkundër entuziazmit fillestar që e shkaktoi, shumë shpejtë sjelli dëshprim. Mospërputhja e dëshirave të xhonturqve dhe përgaditshmëria për lëshime të xhonturqve shihet që nga proklamacioni i Nijazi beut.

Tani ti kthehemi edhe Manifestit të Jane Sandaskit. Mëherët e pamë se Sandanski, pasi që ka arritur në Selanik, ka qënë i pritur nga një delegacion special xhonturk. Të nesërmen, më 29 korrik, ai ka mbajtur fjalim në tubimin e madh në sheshin “Molos”, dhe më 31 korrik e ka dorëzuar Manifestin të të gjithë kombësive në Perandorinë Osmane. Ky manifest ka qënë i publikuar në shtyp, dhe ka qënë i shtypur edhe si lifletë në gjuhën bullgare dhe turke dhe ka qënë i shpërndarë nëpër Selanik dhe tërë Maqedoninë. Teksti i manifestit është në vijim:

Manifest drejtuar të gjithë kombësive në Imperinë⁶³

Të dashur bashkatdhetarë,

Rrezja e shumëpritur e lirisë u ngrit. Atdheu ynë i lodhur u rilind. Absolutizmi i turpshëm është në agoni. Kundër tij u ngrit i tërë populli me fytyrën e të gjithë nacioneve që e përbëjnë. Thirrja revolucionere e organizatës revolucionere Xhonturke ka hasur në një përgjigje të gëzuar në shpirtat e popullit të torturuar. Dhe populli-sklav u bë zotërues. Dhe gjykimi i tij i shenjtë është:

⁶² Пандевски, op. cit., 44 dhe 141.

⁶³ Манифест до сите народности во Османската империја 31 јули 1908 г., http://upload.wikimedia.org/wikipedia/commons/5/55/Jane_Sandanski_Manifest_1908.jpg.

Vdekje absolutizmit!

Vdekje shtypësve!

Të dashur bashkëatdhetarë,

Dita sotshme është e madhe. Në të do të zgjidhet pyetja e madhe: a do të lirohet apo jo populli ynë? Kush do të jetë fitues – ajo mvaret plotësisht prej juve, prej dëshirës suaj dhe vigjilencës për të vdekur për liri. Dhe ju qytetarë, që vetëmse keni shijuar nga frytet e ëmbla të lirisë, do të tundeni që ta përmbushni gjykimin tuaj dhe të mos e varrosni absolutizmin kriminel?

Bashkëatdhetarë Turq,

Ju e përbëni shumicën e madhe të popullsisë, por sëbashku me atë ju më së shumti i ndjeni krimet e kundërshtarëve të përbashkët. Në “mbretërinë turke”, ju nuk ishit më pak robër se sa bashkëatdhetarët tuaj të krishterë. Udhëheqësit tanë deri tani na gënjenin se të krishterët janë kunderështarët tanë. Tani ju e kuptoni se kush janë vëllezërit tuaj, e kush kundërshtarët. Ju të parët hyrët në betejën për liri dhe barazi. Bashkë me ju janë të gjithë. Shpallja juaj: “Popujt janë vëllezër dhe si vëllezër duhet të jetojnë” – i ngrohi zemrat e popullatës së krishterë dhe e lehtësoi pyetjen e mundimshme: me anë të cilës rrugë mund të arrihet deri të liria. Përat: të jetojë beteja e filluar prej jush kundër tiranisë që të jetojë i tërë populli!

Të nderuar bashkatdhetarë të krishterë,

Edhe ju ishit të mashtruar dhe mendoni se mundimet e juaja rridhnin nga tiranija e tërë popullit turk. Edhe ai mashtrim rra.

Populli turk asnjëherë nuk ka patur interes që të jeni skllëvër. Tani ju zgjatët duar vëllazërore dhe vetëm me atë bashkim ju do të luftoni për lirinë e dëshiruar dhe të paguar rëndë. Përforcojeni këtë bashkim! T'i varrosim së bashku me absolutizmin edhe betejat nacionale vetëshkatërruese të shkaktuara nga ai.

Bashkëatdhetarë,

Ju, që keni dhënë viktima aq të shtrenjta para altarit të lirisë, mundeni lirisht të merrni frymë. Tani ju nuk jeni të vetëm – ja pse edhe beteja e juaj bëhet më e lehtë dhe më me shpresë. Me mundin e përbashkët të të gjithë popujve do të luftojmë për lirinë tonë. Mos ju dorëzoni agjitacionit të cilin ndoshta do ta ndërmarrin qeverisësit ofical në Bullgari kundër betejës sonë të përbashkët me popullin turk dhe inteligjencës së tij e cila përpiqet për liri.

Bashkëatdhetarë të dashur,

Shorti është vetëmse i hedhur. Kthim prapa nuk ka, po dhe kush prej jush do të kishte dashur të rikthehet përsëri në atmosferën kundërmuese të padrejtësisë dhe imoralitetit të tiranisë?

Të japim të gjithë fjalë se do ta respektojmë vdekjen e lirisë së shenjtë para haremit të

neveritshëm të jetës skllavore.

Entuziazmi, vetëfljimi dhe përgaditshmëria e përhershme për betejë – ja çka duhet të na mahnit në këtë moment të madh.

Vdekje tiranisë – që të jetojë populli!

Të jetojë liria!

Të jetojë solidariteti në mes kombësive!

Të jetojë beteja e madhe popullore!

Të jetojë populli!

Selanik, 18 korrik 1908.

Sandanski

Disa terme që janë në këtë manifest meritojnë komentim të posaçëm. Ato janë termet “bashkëatdhetar”, “atdhe”, “popull” dhe “liri”. Edhe pse në shikim të parë paraqitet se këto terme janë të kuptueshme dhe se nuk ka nevojë për shpjegime të mëtutjeshme, do ta shohim se megjithatë nuk është ashtu.

Termi i parë, termi “bashkëatdhetarë”, ka qënë tipik gjatë kohës së revolucionit Xhonturk, por prej atëherë është pothuajse plotësisht i harruar. Shumica sot, ndër ndikimin e diskursit dominant nacionalist, do të mendojnë se bashkëatdhetarë është sinonim me bashkëkombas. Edhe më shumë, shumica sot, me vetëdije apo pa vetëdije, konsiderojnë se bashkëatdhetarë ju janë vetëm ata që u janë bashkëkombas. E se me ata me të cilët nuk e ndajnë identifikim e vet etnik nuk kanë asgjë të përbashkët, pra ata i ndejnë si të huaj ndaj vetes. Përkundër kësaj mënyre të të menduarit, termi “bashkëatdhetar” faktikisht tregon se bashkëqytetari, edhe atëherë kur nuk e ndan identifikimin tonë etnik, nuk është i huaj, por se me atë e ndajmë tokën, atdheun, a me atë edhe të ardhmen e përbashkët. Në vijim, se një atdhe, cilido qoftë, dobësohet nëse bashkëatdhetarët e saj janë të ndarë në kampe kundërshtarë me bazë identifikimin etnik.

Në këtë kontekst duhet të drejtohet edhe në atë që është “atdheu ynë i torturuar” që e përmend Sandanski. Lehtë mund të shihet se ajo

është Perandoria Osmane, e jo Maqedonia. Si ka mundur Sandanski të lejojë atdheun ndonjë tërësi tjetër gjeografike përveç Maqedonisë? Se askush nuk guxon ta trajton si atdhe tërësinë gjeografike të ndryshme nga territori në të cilin jetojnë njerëz me identifikim të njëjtë kombëtar sikur vetja është perceptcion të cilin e forcojnë të gjithë nacionalistët pa marrë parasysh cili është identifikimi i tyre etnik. Por se ashtu duhet të jetë nuk paraqet asçfarë aksione prej të cilës secili pa përjashtim duhet të udhëhiqet. Shteti në të cilin në atë kohë ka jetuar Sandanski ka qënë Perandoria Osmane e cila, shumë rëndësishëm (!), pas fitores së revolucionit Xhonturk ka patur gjasa të formohet sipas interesave kombëtare. Pse dikush që nuk është nacionalist të mos tentojë të formojë shtetin në të cilin jeton sipas interesave kombëtar dhe të guxon të interesohet dhe të insistojë vetëm në ndarje të territorit në të cilin jetojnë bashkëkombasit e tij nga shteti egzistues?

Ndër ndikimin e diskursit nacionalistik, edhe termi “popull” në Maqedoninë e sotshme dhe në tërë Ballkanin më së shpeshti kuptohet si kategori etnike. Pra kemi: populli maqedonas, populli shqiptar, populli turk, etj. Aq i madh është dominacioni i diskursit nacionalistik që shpesh plotësisht harrohet se termi “popull” ka edhe kuptim tjetër. Gjegjësisht, se ai mund të përcaktojë jo kategori etnike por shoqërore, e cila i përfshin në vete të gjithë ata që nuk janë të pasur dhe nuk kanë qeverisje/fuqi, pa dallim të identifikimit të tyre etnik. Ai kuptim i terminit “popull” i jepet, për shembull, kur duam të themi se “populli është i sjellur deri te shkopi i lypësit”. Nacionalistët e pranojnë dhe e deseminizojnë kuptimin e terminit “popull” sikur kategori etnike, e se e majta (duhet ta) pranojë dhe ta deseminizojë kuptimin e termit “popull” si kategori shoqërore.

Pasiqë e shpjeguam këtë, ta shohim se në cilin kuptim haset termi “popull” në Manifestin e Sandanskit. Ky term në mënyrë dominante përdoret në kontekstin e tij shoqëror. Për shembull, kur Sandanski në fund të Manifestit thotë “Vdekje tiranisë – të jetojë populli!”, “Të jetojë beteja e madhe e popullit!” dhe “Të jetojë populli!”, nuk e ka parasysh as popullin maqedonas e as popullin turk, por popullin në kuptimin e tij shoqëror. Por në Manifestin termi “popull” përdoret edhe në kontekstin e tij etnik. Për shembull kur Sandanski flet për “betejën e përbashkët

me popullin turk dhe inteligjencën e tij”. Megjithatë, edhe kur ajo është rasti, e ka parasysh edhe kuptimin shoqëror të “popullit”. Ajo është mjaftueshëm e rëndësishme për tu kuptuar çka ka dashur Sandanski të thotë kur, duke iu drejtuar bashkëatdhetarëve të vet të krishterë, u thot se “populli turk asnjëherë nuk ka patur interes që t’i jeni skllevër.” Nëse ndër popullin turk kuptohen të gjithë Turqit me përkatësi etnike, ky qëndrim shfaqet si propagandë e cekët që nuk korespondon me realitetin. Por, nëse ndër “populli turk”, këtu kuptohen Turqit e rëndomtë, ata të cilët nuk janë as të pasur, as nuk kanë qeverisje, atëherë nëpërmjet këtij qëndrimi Sandanski përçon një mesazh të rëndësishëm antinacionalistik, se asnjë popull (si kategori shoqërore) nuk ka interes, e as nuk ka mundësi që të eksploatojë një popull tjetër. Prej vetë shkakut se çdo popull është ai që është i eksploatuar, e i eksploatuari me definicion nuk është ai që eksploaton ose robëron.

Edhe liria në Manifestin nuk është e kufizuar në suaza nacionalistike. Më lartë cekëm se liria dhe çlirimi nuk janë patjetërsueshëm të lidhura me pavarësi në shtet të veçantë. Gjegjesisht, se është e mundshme liria pa pavarësi, dhe është e mundshme pavarësi pa liri. Kuptohet, nëse e kuptojmë lirinë si “liri kombëtare” e gjithëkjo nuk vlen, por përse e përshtatim lirinë në liri kombëtare, dhe a kërkon zhvillimi kombëtar ndarje në shtet të mëvetësishëm? Ai që nuk është nacionalist as nuk konsideron se është e pranueshme që liria të reduktohet në liri kombëtare, e as nuk e konsideron se është e pamundshme të ketë zhvillim të lirë nacional në shtet multikulturor. Për shkak se Sandanski nuk ka qenë nacionalist, ai me kuptimin e tij të lirisë është drejtuar prej pozicioneve jo-nacionalistike. Edhe ka shpallur në Manifestin se pas revolucionit Xhonturk “Rrezja e shumëpritur e lirisë [vetëmse] u ngrit”. Pa marrë parasysh që bashkëatdhetarët e tij nuk u ndanë në shtet të mëvetësishëm. E kur shkroi se “me mundimet e përbashkëta të të gjitha popujve ne do të luftojmë për lirinë tonë”, ai nuk desh të thotë se të gjithë popujt do të mundohen që bashkëkombasit e tij të veçohen në shtet të përbashkët, por se të gjithë popujt e Perandorisë Osmane (popuj në kontekstin etnik) do të japin forcat e tyre për shtetin e përbashkët ta karakterizon liria, e jo tirania dhe absolutizmi.

Besueshëm mesazhi më i fuqishëm në Manifestin është thirrja antinacionalistike: “t’i varrosim së bashku absolutizmin dhe betejat vetëshkatërruese nacionale.” Përkundër botëkuptimit nacionalistik sipas të cilit të gjithë popujt natyralisht (!) janë kundër njëri tjetrit, Sandaski këtu burimin e betejave vetëshkatërruese nacionale i gjen te absolutizmi. Përderisa popujt e urrejnë njëri-tjetrin, elitat i plaçkisin ata. Dhe për ti plaçkitur ata i drejtojnë popujt që të jenë njëri kundër tjetrit. Duke filluar nga një qëndrim i këfillë internacional, Sandanski e gjen problemin me betejat ndërnacionale te sistemi, e jo në “natyrën” e kombësive. Me atë, njëjtë sikur edhe kryengritësit e Krushevës gjatë ko-hës së kryengritjes së Ilindenit, Sandanski ju drejtohet bashkëatdhetarëve Turq që ata para revolucionit nuk ishin “më pak robër” në mbretërinë “e tyre” sesa bashkëatdhetarët e tyre të krishterë, që kanë qenë të gënjyer prej drejtuesve, udhëheqësve, që të krishterët kanë qenë kunderështarë dhe se tani duhet të kenë pasqyrë më të mirë se kush i janë vëllezër, e kush kundërtarë. Thjeshtë, nuk është kundërshtar ai që e ndan të ardhmen tënde, problemet dhe mundimet e tua të përditshme, kundërshtar është ai që vetes i siguron jetë luksoze, duke të të plaçkitur ty, dhe të tjerëve të ngjajshëm si ti. Të njëjtën i ja dëshiron edhe bashkëatdhetarëve të krishterë, edhe bashkëkombasve të vet. Të gjithë bashkëatdhetarëve të krishterë i këshillon që të mos biejnë para propagandës nacionalistike e cila don ti bind se për mundimet e tyre është përgjegjëse “tiranja e të gjithë popullit turk”, e bashkëkombasit i paralajmëron në “agjitacion të kundërvuajtur” evental të qeverisjes oficiale në Bullgare, e cila duke luajtur me kartën nacionale, do të synon ta ndan popullin në baza etnike dhe në atë mënyrë do të tentojnë ta dobësojnë betejën e popullit në Perandorinë Osmane.

Qëllimet antinacionalistike jo gjithmonë rezultojnë me sukses. Nuk rezultuan me sukses as qëllimet antinacionalistike të Sandanskit, të Nijazi beut dhe të bashkëmendimtarëve të vet gjatë kohës së revolucionit Xhonturk. Xhonturqit shumë shpejtë kanë filluar që t’i integrojnë dhunshëm popujt joturq, e te popujt joturq, si rezultat i saj, më të zëshëm u bënë ata që insistuan në atë se për liri është e nevojshme pavarësi në shtet të mëvetësishëm. Edhe në këtë rast nacionalizmi u tregua më i fuqishëm

se antinacionalizmi. Shpesh është kështu, por jo për bindshmërinë më të madhe inherente të argumenteve nacionalistike, por për shkak të ekspozimit më të madh të popullit në atë.

3

Kryengritja e Ohrit dhe Dibrës

Një nga kryengritjet më të harruara (me qëllim apo pa qëllim) të këtyre hapsirave është kryengritja e ashtuquajtur e Ohrit dhe Dibrës, e cila në një mënyrë ishte e injoruar prej sistemit të kaluar. Kjo kryengritje poashtu quhet edhe “lufta e tretë ballkanike”, si dhe kryengritja maqedono-shqiptare,⁶⁴ sikur pasqyrim i pakënaqësisë së popullsisë së përzier në regjionin e Maqedonisë së sotshme perëndimore e përbërë nga Shqipëtarë, Maqedonas dhe Turq. Kryengritja ka filluar në shtator të vitit 1913, një muaj pas marrëveshjes së Bukureshtit. Posaçërisht marrëveshja e Bukureshtit në një mënyrë e ka inicuar pakënaqësinë, por edhe organizimin dhe bashkëpunimin në mes Shqiptarëve dhe Maqedonasve, ka ndikuar poashtu edhe represioni nga ana e trupave serbe që e okupuan këtë regjion.

Në këtë kryengritje janë çliruar më shumë qytete se sa që janë çliruar në kryengritjen e Iindenit. Janë çliruar Dibra, Struga, Ohri, Kërçova, rrethina e Prespës, Gostivari dhe Tetova.⁶⁵ Në krye të kryengritjes kanë ardhur Milan Matov, Petar Çaulev, Pavel Hristov,⁶⁶ Mehmed Sefedin Pustina, Mersim Dema, Elez Isufi⁶⁷ etj. Nga ana maqedonase më se shumti janë veçuar Matov-i dhe Çaulev-i, ndërsa nga ana shqipëtare – Elez Isufi.

Bashkëpunimi i cili paraqitet në mes të vepruesve maqedonas dhe shqipëtar në kryengritjen e Ohrit dhe Dibrës në një masë të madhe paraqet „martesë interesi“, pas të cilës qëndron edhe interesi i shteteve

⁶⁴ Виолета Ачковска, Никола Жежев, „Предавствата и атентатите во македонската историја“, „Макавеј“, Скопје, 2004, 182 fq

⁶⁵ Sheradin Berisha, “Kryengritja shqiptare e vjeshtës së vitit 1913”, <http://pashtriku.beepworld.de/kryengritja1913.htm>

⁶⁶ Ачковска, Жежев, op. cit.

⁶⁷ Vebi Xhemaili, “Shqiptarët e maqedonisë sotme” (Nga Kryengritja e Dervish Cares 1843 deri te Kryengritja e Dibrës 1913), http://www.dituria.se/index.php?option=com_content&view=article&id=1197:-vebi-xhemaili-shqiptaret-e-maqedonise-sotme-&catid=163:botime-te-reja&Itemid=68

fqinje Shqipërisë dhe Bullgarisë dhe pretendimet e tyre territoriale në Maqedoninë e pushtuar nga Mbretëria e Serbisë. Gjithësesi, edhe pse kjo kryengritje është e kontaminuar me elemente nacionalistike, është e rëndësishme të përmenden momentet të cilat i tejkalojnë pozicionet monoetnike (me tendenca nacionaliste) të cilat se paku për një moment paraqesin etapë e haptaz-pranueshme të bashkëjetesës. Në këtë mënyrë vërehet se si në gjendje të vështirë, solidariteti nuk i njeh barrierat etnike, ato janë të tejkaluara para se të paraqiten.

3.1 MOTIVET DHE PËRGATITJET E KRYENGRITJES

Në agimin e nënshkrimit të paktit të Bukureshtit, implikacionet negative në krahasim me klimën politike në këtë regjion (konkretisht në Maqedoni) zmadhoheshin. Shteti Sërb i vendoste institucionet e veta, policinë, ushtrinë, gjykatën etj. Opresioni nga okupatori turk ishte tashmë i zëvendësuar me opresion nga sërëbet, mirëpo, më së rëndësishmi u intezivua. Periudha pas kryengritjes së Ilindenit, revolucioni Xhonturk dhe të dy luftat ballkanike deri në fund e rraskapitën energjinë e popullit. Pas një periudhe të kësaj lloji, populli në kryesi mbeti i varfër, statusi ekonomik-social i qytetarit të rëndomtë ishte tronditës, ambienti politik kryesisht i kryqëzuar ndërmjet spastrimeve ideologjike të brendshme dhe atentatet e përfaqësuesve të VMORO-së. Asnjë alternative në pamje përpos rebelimit. Kryengritja vjen si pasojë e reaksionit të mospajttimeve të cilat kanë bazë socio-ekonomike mirëpo edhe politike. Megjithatë si motiv të kësaj kryengritjeje, historianët e sotëm kryesisht marrin momentet e pakënaqësisë nacionale Maqedonasve dhe Shqipëtarëve nga moszgjedhja e plotë e pyetjeve të tyre kombëtare.

Edhe para se të shpërthejë kryengritja, veprimtarët maqedonas dhe shqipëtar kanë pasur kontakt të ndërsjellët dhe kanë pasur marrëveshje për bashkëpunim. Ajo ka qenë pasojë për dështimin e xhontruqve të dalin jashtë kornizave nacionaliste dhe të sigurojnë që revolucioni Xhonturk të jetë në interes të të gjithë popujve në perandorinë Osmane. Në kësaj situatë veprimtarët shqiptar dhe maqedonas janë drejtuar tek njëri-tjetri. Siç ka theksuar Dervish Hima në një mbledhje të komitetit të Ohrit të

VMORO-së, Shqipëtarët dhe Maqedonasit duhet të bashkëpunojnë sepse kanë armiq të perbashkët si në autoritetet xhonturke poashtu edhe në fqinjët ballkanik të cilët kanë tendencë t'i pushtojnë dhe shpërndajnë Shqipërinë dhe Maqedoninë.⁶⁸ Në periudhën prej krijimit të revolucionit Xhonturk e deri më pergatitjet e kryengritjes së Ohrit dhe Dibrës janë vërejtur rastet e mëposhtme të kontakteve të ndërsjellta: në gusht të vitit 1909 ndërmjet sandinistëve dhe përfaqësuesve të klubeve shqiptare, në prill dhe maj të vitit 1910 në Manastir dhe Dibër, pastaj në fillim të korrikut të vitit 1910 në Strumicë, në vitin 1911 Nikoll Ivanaj ka pasur performancë para mjedisit maqedonas dhe shqipëtar në Shkup, e kah fundi i marsit të vitit 1911 e gjithë përbërja e CK VMORO-së (Todor Aleksandrov, Petar Çaulev dhe Hristo Çernopee) ka shkuar në Cetinje për bisedime me udhëheqësit shqiptarë.⁶⁹ Në asi kontekst, kur në vitin 1913 pjesa e Vardarit të Maqedonisë u pushtua nga ana e Mbretërisë së Sërbisë, veprimtarët maqedonas dhe shqiptarë e kanë ripërtrirë bashkëpunimin.

Përgatitjet për kryengritjen kanë filluar në mes të gushtit të vitit 1913, kur në Elbasan është nënshkruar marrëveshja për bashkëpunim të VMORO-së dhe komitetit revolucioner të shqiptarëve në krye së të cilës ka qenë Mehmed Sefedin Pustina. Bashkëpunimi ka nënkuptuar organizim dhe ngritje të kryengritjes sëbashku kundër regjimit të atëhershëm serb.⁷⁰ Në Elbasan janë pajtuar që udhëheqjen ta ndërmerr VMORO-ja ku vojvodat Millan Matov dhe Petar Çaulev⁷¹ janë dashur të jenë në krye të të gjithë çetave në Dibër, Gostivar dhe Kërçovë.⁷² Në Elbasan Millan Matov poashtu është pajtuar me autoritetet të

⁶⁸ Владо Поповски, „Албанското национално-ослободително движење (1830-1912)“, „Меѓународен центар за славјанска просвета“, Свети Николе, 2012, 98-99.

⁶⁹ Ibid., 98-99 dhe 110-111.

⁷⁰ Ванче Стојчев, Александар Стојчев, „Букурешкиот мировен договор и поделбата на Македонија во 1913 година“, ИНИ, Скопје, 2011, 234.

⁷¹ Petar Çaulevi, siç shënon Millan Matovi, nga ana e babait të vet ka qenë Toskë, Shqiptar. Милан Матов „Комитата раскажува...“, „Бигос“, Скопје, 2002, 126 dhe 211.

⁷² Александар Трајановски и др., „Златна книга 100 години ВМРО“, Глас на ВМРО-ДПМНЕ, Скопје, 1993, 119.

Shqipërisë që kryengritja të jetë e përkrahur me para, armë dhe kuaj, Millan Matov dhe Petar Çaulev, duke e thëritur popullin për liri dhe autonomi, kanë arritur të mbledhin 12,000 kryengritës.⁷³

3.2 KRYENGRITJA

Data e saktë kur kryengritja ka filluar është e panjohur. Sipas disa burimeve me 7 shtator, ndërsa sipas burimeve tjera me 13 shtator, e disa tjerë me 20 shtator.⁷⁴ Megjithatë, dihet se fillon papritmas me kurth të çetave shqiptarë mbi një pararojë serbe në fshatin Aras në Peshkopi.⁷⁵ Pas hyrjes së trupave Serbe në teritorin e Shqipërisë së sotme, më saktësisht në qytetin e Peshkopisë duke bërë rrëmujë. Ditën e ardhëshme pas dhunës së ushtrisë serbe në Peshkopi, kryengritësit e aradhës së Dibrës në fshatin Luzune, kanë sulmuar kolonelin e 19-të serb.⁷⁶ Veprimet luftarak janë drejtuar në tre drejtime. Grupi i parë kah Gostivari, i dyti kah Dibra dhe përmes Dibrës kah Kërçova, përderisa e treta u drejtua kah Struga dhe Ohri.

Pas çlirimit të Dibrës, në qytet është formuar qeveri e përkohshme me përmbajtje të përzier shqiptaro-maqedonase. Autorët e ndryshëm japin emra të ndryshëm si anëtar të kësaj qeverie të përkohshme, mirëpo përmbajtja e përzier shqiptaro-maqedonase është e padyshimtë. Matov, i cili ka ardhur në Dibër përderisa është zgjedhur qeveria e përkohshme e qytetit, shkruan se atë e kanë zgjedhur rreth 50 përfaqësues të qytetarëve, Shqiptarë dhe Maqedonas, dhe se në përbërjen e saj kanë hyrë Omer-efendia, Sefedin Pustina dhe Hristo Atanasov. Ai tregon se është vendosur të parashihen dy vende për njerëz nga Ohrit, ku do të duhej edhe të shpërngulej administrata, pas marrjes së Ohrit. Për sekretar është përcaktuar Martin Pop Arsov, përderisa Matov-i ishte caktuar

⁷³ Стојчев, Стојчев, op. cit., 238.

⁷⁴ Shiko Стојчев, Стојчев, cit. vepra. Matov, cit. vepra, 151 fq. dhe Nebi Dervishi “Etnokultura e fushgrotes se Ohrit”, “Cabej”, Tetovë, 2005, p. 224 dhe Uran Butka Kryengritja e Dibrës e Shtatorit 1913 <http://www.pashtriku.org/?kat=60&shkrimi=2075>.

⁷⁵ Sheradin Berisha “Kryengritja shqiptare e vjeshtës së vitit 1913”, <http://bit.ly/1wb2D0R>.

⁷⁶ Стојчев, Стојчев, op. cit., 239.

„bash komandir“, përkatësisht komandant suprem i të gjitha forcave të armatosura dhe shef i qeverisë.⁷⁷ Sipas Kiril Përliçev, në përmbajtjen e qeverisë së përkohshme ka hyrë edhe Sefedin Pustina, Riza-beu, Hristo Atanasov, Bajram Strezimir etj.⁷⁸ Sipas Josif Rasukanov, antarë kanë qenë Sefadin Pustina, Ivan Bojçev, Nestor Georgiev, Riza-beu. Bajram Strezimir etj.,⁷⁹ e sipas Vançe Stojçev antarët e saj kanë qenë Sefedin Pustina, Ali Beu, Omer Efendi, Martin Pop Arsov, Hristo Atanasov, Nestor Popovski.⁸⁰

Edhe në Ohër trupi udhëheqës mbase ka qenë i përzier me përmbajtje maqedonase-shqiptare. Petar Shandanov tregon se në përmbajtjen e komitetit veprimtar, i cili është formuar nën presidencën e Pavell Hristov, kanë hyrë dy-tre maqedonas dhe po aq shqiptarë-mysliman në krye me shqiptarin e njohur Jusuf-beg.⁸¹ Matov-i, shënon se në këshillin luftarak kanë marrë pjesë Dimitar Ivanov, Lev Ognenov, Jusuf-beu dhe Dam Can, e në udhëheqjen politike janë zgjedhur Jusuf-beu, e nga Maqedonasit, Dimitar Ivanov ose Lev Ognenov.⁸² Vetëm Kiril Përliçev jep vetëm emra të Maqedonasve- Lev Ognenov, ndonjë Robert, pastaj Ivan Grupçev, Lev Kackov, Pavell Hristov, Petar Filev etj...⁸³ Mirëpo, lista e tij nuk është përfundimtare. Domethënë, ai shkruan se edhe të tjerë kanë qenë të përfshirë në udhëheqje, kështu që ato mund të kenë qenë shqiptarë dhe turq.

Sa i përket veprimtarive ushtarake, pas çlirimit të Dibrës, çetat e Matov-it dhe Çaulev-it kanë pasur sukses në çlirimin e Strugës dhe Ohrit, duke i detyruar ushtritë serbe të tërhiqen. Mirëpo kryengritja është shuar shumë shpejt. Janë angazhuar 3 kolonelë, xhandermaria dhe formacionet çetnike të „Mbrotjtes së popullit“ e udhëhequr nga Vasili

⁷⁷ Matov, op. cit., 156-157 dhe 159.

⁷⁸ Кирил Пърличев, „Сръбският режим и революционната борба в Македония (1912-1915 година)“, „Ал.Паскалев и С-ие“, София, 1918, <http://www.promacedonia.org/prl/6.html>

⁷⁹ Йосиф Разсуканов „85 години от Охриско-Дебърското въстание: Българите в Македония не искат да живеят под сръбско робство“, „Македония“, nr. 33, 16 shtator 1998 vit. http://www.promacedonia.org/v_mak/1998/ohr_debyr.html.

⁸⁰ Стојчев, Стојчев, op. cit., 238.

⁸¹ Петар Шанданов, „Спомени“, „Матица македонска“, Државен архив на РМ, Скопје, 2002, 38.

⁸² Matov, op. cit., 170-171.

⁸³ Пърличев, op. cit., <http://www.promacedonia.org/prl/7.html>.

Tërbiq. Trupat sërbe poashtu kanë qenë të ndihmuar nga ushtria greke. Ndhimë e cila në një mënyrë është treguar kryesore. Masa të popullit, shqiptarë, maqedonas dhe turq e kanë kaluar kufirin me Shqipërinë dhe janë shpërngulur në Elbasan. Atë e kanë bërë edhe antarët e kryengritjes. Trupat sërbe kanë qenë brutal dhe kanë kryer shumë vrasje dhe masakra. Fshatra të banuara nga shqiptarët dhe maqedonasit janë djegur deri në themele. Më së shumti ka pësuar Dibra ku janë kryer më së shumti vrasje, e vet qyteti gati se i tëri është rrënuar.⁸⁴ Numri i refugjatëve shqiptarë sipas raportit të komisionit të fondacionit të Karnegiut për paqe ndërkomtare ka qenë 25,000,⁸⁵ e numri i personave të cilët kanë kaluar në Bullgari sipas disa burimeve arrin mbi 30,000.⁸⁶

3.3 ELEMENTET ANTINACIONALISTE TË KRYENGRITJES

Edhe kjo kryengritje posedon varg të gjërë të informatave për kohën dhe kulturën e kohës së saj, mirëpo edhe për aspektet socio-politike të asaj kohe. Dokumentet historike nuk dëshmojnë për marrëdhënie kundërshtuese të shqiptarëve dhe maqedonasve, mirëpo, në të kundërtën, në kushte të represionit nga shteti sërb, maqedonasit dhe shqiptarët afrohen deri në atë shkallë që për vetë protagonistët në kryengritje, sikur Milan Matov dhe Petar Çaulev, paraqet kënaqësi, dhe sigurisht ndryshim të rëndësishëm. Në atë kahje, Çaulev në shkrimet dhe intervistat e tij thotë: „Jo vetëm maqedonasit dhe shqiptarët, por edhe turqit së bashku do të jemi si vëllezër të vërtetë dhe së bashku do të shkojmë në betejë.“⁸⁷ Ky citat tregon se në rastin e Çaulev-it, pjesmarrës i drejtpërsëdrejti në shumë kryengritje dhe aktivitete revolucionere, anulohet armiqësia drejt jo vetëm shqiptarëve,

⁸⁴ Пърличев, op. cit., <http://www.promacedonia.org/prl/8.html> Коста Църнушанов, „Македонизмът и съпротивата на Македония срещу него“, Унив. изд. „Св. Климент Охридски“, София, 1992, http://www.promacedonia.org/kc/cyrm13_g.html.

⁸⁵ Carnegie Endowment for International Peace, „Report of the International Commission to Inquire into the Causes and Conduct of the Balkan Wars“, 182, <http://bit.ly/Z8VFYm>.

⁸⁶ Разсуканов, op. cit.

⁸⁷ Петар Чаулев „Записки на Петър Чаулев за Охридското въстание 1913 г.“, http://www.sitebulgarizaedno.com/index.php?option=com_content&view=article&id=346.

por edhe drejt turqve dhe të armiqve të fundit, kushtësisht e thënë, tani krijojnë bashkëpunëtor.

Diçka që tregon se interesat politiko-ekonomike ç' do herë i ndërtojnë edhe ato urat apo plotësojnë zbrazëtirat kulturo-sociale. Çaulev-i i mahnitur tregon: „Ajo që me shekuj të tërë nuk mundej të arrihej, e nuk mundej as të shihej- bullgarët [maqedonasit], shqiptarët dhe turqit të ecin të bashkuar, sot forcat e armëve dhe veprat e liga të sërëve na detyruan të duhemi më shumë se vëllezër gjaku.⁸⁸

Në vazhdim Çaulev flet për rrënimin e armiqësisë në mes të dy popujve të cilët ishin të trashëguar me gjenerata për shkaqe të bindjeve politike. Ai tregon se si, kur së bashku me çetën e përbërë me shqiptarë kishte marshuar në Strugë, e ëma e tij kishte marrë lajmet se i biri i saj ishte vrarë nga ana e shqiptarëve, mirëpo edhe vet ishte befasuar kur në vend të asaj, ajo kishte parë të birin të hipur mbi kalë duke udhëhequr çetë të përbërë me shqiptarë.⁸⁹ Edhe më mirë për rënimin e armiqësisë në mes të dy popujve flet hyrja e çetëve kryengritëse në Ohër: „I tërë populli doli në rrugë që ti mirëpret shqiptarët të cilët në heshtje në rend të plotë po afroheshin drejtë qytetit. Të hypur në kuaj të bukur, Çaulev-i dhe një be... kalëronin përpara e pas tyre edhe 1000 vetë tjerë arnautë, të renditur nga dy, me armë në supe, në qetësi kaluan në mes të publikut i cili i përhëndeste... Ato për të cilët mendimi zyrtar ishte se ishin arnautë të egër, kaluan më të disiplinuar se ushtritë moderne.⁹⁰

Teritori i Shqipërisë, në atë kohë për Çaulev-in dhe Matov-in paraqiste vend ku ata dhe gjithë maqedonasit tjerë mund të lëviznin lirshëm. Në atë vend ata janë ndier të lirë. Matov në kujtimet e tij do: „Saktësisht në atë kohë shqiptarët filluan të ndërtojnë shtetin e tyre. Ende nuk kishin administrate dhe polici, mirëpo përpos saj ne me të vërtetë ndihemi të lirë në teritorin e tyre...“⁹¹ Çaulev-i, për situatën në Elbasan pas shuarjes së

⁸⁸ Ibid.

⁸⁹ Ibid.

⁹⁰ Ibid. Beu që i ka udhëzuar Shqiptarët, sipas Shandanovit, është gavaz i mëparshëm i vlladikës së Ohrit Riza, i lindur në fshatin e Strugës Ladorishti. Шанданов, op. cit., 38.

⁹¹ Matov, op. cit., 147.

kryengritjes do ta thot këtë: „Ku edhe të paraqiten nëpër çarshi çetnikët e Çaulev-it, të cilët janë të shumtë në Elbasan, ende pa u ulur në kafene, rrethohet nga grupa të shqiptarëve të cilët i pyesin për jetën si një komit, e ndëgjojnë me entuziazëm, përgjakshëm rreh gjoksin arnauti dhe fjalët e vetme janë : ‘Do të vdesim së bashku, vëlla’... Pranimi në Shqipëri, si i refugjatëve shqiptarë, poashtu edhe i bullgarëve [Maqedonasve] nuk përshkruhet. *Bullgari [Maqedonasi] si mysafir tek shqiptari ndihet më i lirë se ç’ dokund.*“⁹²

Me qëndrimin e Matov-it në Shqipëri janë të lidhura dy epizode të cilat janë të rëndësishme nga aspekti antinacionalist. E para është që ka dërguar letër deri tek maqedonasit, shqiptarët dhe turqit lirshëm në Maqedoni. Këtë letër ai e kishte shkruar më 21 gusht të vitit 1913, së bashku me Irfan-beun, njeri i lindur në Ohër, dhe nga ai është kërkuar për tu larguar nga skandalet dhe zënkat në mes myslimanëve dhe maqedonasve.⁹³ E dyta, ka ndodhur kur në Elbasan, ku është gjendur Matov-i, është kuptuar se në Maqedoni ka shpërthyer kryengritje.

Atëher para postës së qytetit është mbledhur populli, të cilëve Matov-i iu ka drejtuar, ata duke mos qenë në një numër të vogël, ai u ka folur në gjuhën shqipe, të cilën ai e dinte pasi që kishte prejardhje shqipëtare.⁹⁴ Matov-i të pranishmëve u qe drejtuar me këto fjalë: „Kush është kundër Sërbisë dhe është i shëndoshë, e poashtu edhe trim, të gjejë armë dhe të pregatitet që të niset me mua për të vdekur për atëdheun...“⁹⁵ Matov-i të pranishmëve ju ka drejtuar me këto fjalë: „Kush është kundër Sërbisë dhe është i shëndoshë, e poashtu edhe trim, të gjejë armë dhe të pregatitet që të niset me mua për të vdekur për atdheun...“

Kuptimi i tillë i termit atëdhe haset edhe në autorizimin e përfaqësimit të cilin Matov-i e fiton nga Mexhlisi, kuvendi popullor i Dibrës, e cila thotë:

⁹² Ibid. Nënvizuar nga autorët.

⁹³ Ibid., 149.

⁹⁴ Dervishi, op. cit., 222.

⁹⁵ Маров, op. cit., 153. Nënvizuar nga autorët.

Autorizim i përfaqësimit⁹⁶

Me largimin e ushtrive sërbe nga Dibra erdhi vojvoda nga vilaeti i Manastirit, zotëri Millan Matov dhe sëbashku me kuvendin shqiptarë vendosën të ndërmarrin masa të përbashkëta.

Duke e përmbushur borxhin drejt atëdheut prej sot të gjithë komandantët, si në vend betejë apo në fshatra, pa kushte ti nënshtrohen orarit të tij dhe ti japin të gjithë përkrahjen që ta mbarojë veprën e filluar.

Në emrër të atëdheut ipet ky dokument që ti shërbej gjithandej. (vula) Administrata e përkohshme Dibër.

Përktheu (A. Struzhanev dhe Zhivko Galabanev)

Kjo është edhe një notë e cila ka intonacion antinacionalistik dhe e cila shkon me tezën se termi atëdhe duhet të ketë aspirata univerzale të termeve.

Matovi jep shumë informata të tjera interesante. Kështu, ai shënon se, duke u pergatitur që të niset për në Dibër, ka veshur bluzë të oficerëve turq dhe kapelë Tiranë të bardhë të shqiptarëve. Ai tregon se ka qenë i befasuar kur ka kuptuar se në çetën e tij, në krye të së cilës ai ka dalë, ka qenë maqedonasi i vetëm në mes të shumë shqiptarëve dhe turqve-nejrëz të cilët në të kaluarën kanë gjuajtur mbas tij, mirëpo sot janë bashkëluftëtarë dhe miq të tij. Në fund si premtim për miqësinë e vërtetë, të gjithë ndërmjet veti kanë dhënë besën për lojalitet deri në fund.⁹⁷ Dëshmi për kyçjen e shqiptarëve dhe maqedonasve në çetat kryengritëse dhe bashkëpunimin e çetave të përbëra nga maqedonas dhe shqiptarë japin edhe Shandanov dhe Çaulev. Shandanov shkruan se pas hyrjes së kryengritësve shqiptarë në Ohër, drejt atyre është përbashkuar një grupë e armatosur me rreth 40-50 maqedonas, nën udhëheqjen e arsimtarit

⁹⁵ Matov, op. cit., 153. Nënvizuar nga autorët.

⁹⁶ Ibid., 159-160 стр. Nënvizuar nga autorët.

⁹⁷ Ibid., 153-154.

Dimitar Ivanov dhe se të gjithë ato së bashku janë drejtuar drejt Resnjës.⁹⁸ Ndërsa Çaulev, tregon se më 17 shtator, me ofanzivën e trupave të okupatorit për pushtim të Ohrit, kryengritësit që e kanë mbrojtur qytetin kanë qënë të ndarë në tre çeta. E para ka qënë në udhëheqjen e vojvodës Andon, e dyta ka qënë nën udhëheqjen e Nestor Georgiev, ndërsa e treta ndër udhëheqjen e Mehmet Ali-agës.⁹⁹

Matov në kujtimet e tij përmend edhe një episodë të këtillë të rëndësishme me karakter antinacionalistik. Në momentet kur kryengritja në Maqedoni vetëmse ishte e shtypur, ushtria serbe ka qënë duke u afuar në kufirin me Shqipërinë. Në atë kohë u duk sikur ushtria serbe do të hynte edhe në Shqipëri, Matov shpjegon: “Të gjithë morëm armë dhe dërguam korierë nëpër fshatrat, të gjithë njerëzit e aftë të marrin armë, dhe atë nëpër familje, dhe të nisen e ta mbrojnë shtetin e ri shqiptarë. Të gjithë u drektuam kah Kuksi dhe u përgaditëm për betejë.”¹⁰⁰

Se çfarë ka qënë shpirti i pjesmarrësve të kësaj kryengritje shihet edhe nga episodi në të cilën një nga kryengritësit, Qazim Lika, ka qënë rëndë i plagosur nga ushtarë serb dikund afër Hanit të Llopushnikut. I kanë ndihmuar tre goranë¹⁰¹ të cilët e kanë evakuuar nga linjat ushtarake dhe e kanë dërguar në spitalet e Selanikut. Këto shembuj, nuk janë vetëm epizoda të shkurtra nga ajo kryengritje, por janë të shumta me numër dhe kuptim.

Edhe të ketë qënë kjo kryengritje “martesë interesi”, kur hyhet më thellë në përmbajtjet, si dhe kushtet e relacioneve historike shihet se edhe kjo kryengritje është e plotë me narativa mbinacionale. Asnjë nga protagonistët nuk ka kërkuar teritore të pastërta etnike, por liri nga represioni dhe krijim i një atëdheu, atëdhe që do ti distribuon vlerat dhe drejtësinë për të gjithë njëloj, diçka që në kushtet e qeverisjes serbe ka qënë vetëm pjesë e fantazisë së popullit që ka jetuar në ato anë.

⁹⁸ Шанданов, op. cit., 38.

⁹⁹ Чаулев, op. cit.

¹⁰⁰ Матов, op. cit., 176.

¹⁰¹ Berisha, op. cit.

4

Bashkëpunimi mes dy lufëtrave botërore

Pas mbarimit të luftërave ballkanike dhe luftës së parë botërore nuk ka ndaluar thyerja e të drejtave në baza etnike, të paktën të një pjese të shqiptarëve dhe maqedonasve. Teritori në rajonin Maqedoni ka qenë i ndarë mes tre shteteve (Greqi, Sërbi/Mbretëria SKS dhe Bullgari), ndërsa jashtë shtetit të posaformuar të Shqipërise kanë vazhduar të jetojnë një numër i konsideruar shqiptarësh. Në situatë të tillë veprimtarët maqedonas dhe shqiptarë kanë vazhduar luftën për të drejtat nacionale, ndërsa veprimtarët majtë të orientuar edhe luftën për të drejtat sociale. Në atë kontekst, ka vazhduar edhe bashkëpunimi i tyre. Mes shembujve të bashkëpunimit në periudhën mes dy luftërave botërore janë marrëveshje që veprimtarët shqiptarë dhe maqedonas e kanë nënshkruar në Tiranë më vitin 1921, Protokoli për bashkëpunim mes VMRO-së (e Bashkuar) dhe Komitetit për çlirimin e Kosovës i nënshkruar më vitin 1926 dhe apelet dhe reacionet deri tek forumet ndërkombëtare të cilat bashkarisht i kanë dërguar VMRO (e Bashkuar), Komiteti shqiptarë për bashkim kombëtar dhe Komiteti për çlirim të Kosovës, bashkë dhe me organizata nacional-çlirimtare tjera nga Ballkani.

4.1 MARRËVESHJA E TIRANËS E VITIT 1921

Marrëveshja ose protokoli i Tiranës ka qenë marrëveshje për veprim të përbashkët të cilën më 20 dhjetor të vitit 1921 në emër të veprimtarëve maqedonas e kanë nënshkruar Aleksandar Protogerov dhe Filip Atanasov, ndërsa nga ana shqiptare nënshkrues kanë qenë Rexhep Mitrovica dhe Bedri Pejani. Protogerov e ka përfaqësuar të djathten e VMRO-së (Autonomike), ndërsa Atanasov mbantë të orientuarën Organizatë imigruese federative maqedonase,¹⁰² ndërsa më vonë ka qenë pjesëtar i

¹⁰² Organizata Maqedonase federative e emigrantëve qëndron që Maqedonija si shtet multi-etnik, të jetë

VMRO-së (së Bashkuar). Mitrovica dhe Pejani kanë qenë të lindur në Kosovë dhe më vonë, gjatë Luftës së dytë botërore, janë bërë të njohur si udhëheqës të Lidhjes së dytë të Prizrenit, e cila ka bashkëpunuar me nacistët Gjermanë. Përveç asaj, Mitrovica ka qenë kryeministër i qeverisë kuislinge të Shqipërisë gjatë okupimit Gjerman të vendit (1943-1944). Këto të dhëna biografike për nënshkruesit e Marrëveshjes së Tiranës (si dhe biografitë e plota të tyre) tregojnë se për asnjërin nga nënshkruesit, me përjashtim të Atanasovit, nuk mund të thuhet se ka patur parasysh diçka më tepër se vetëm interesat nacionale të popullit të vet. Rrjedhimisht, ky bashkëpunim mes veprimtarëve shqiptarë dhe maqedonas ka paraqitur “martesë për interes”, dhe jo bashkëpunim i motivuar me parime antinacionalistike.

Poentat kryesore të marrëveshjes së nënshkruar janë këto. Në lidhje me Maqedoninë, duke e patur parasysh johomogjenitetin etnik të saj, parashihet, mbas lirit të saj, ajo të ketë renditjen politike dhe administrative të njëjtë sikur Zvicra (gjegjesisht të jetë e organizuar si republikë federative). Në lidhje me Shqipërinë, nga ana tjetër, parashihet çlirimi i Kosovës (nën pushtet serb) dhe të Çamërisë (nën pushtet grek) dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Është arritur edhe pajtim për kufirin mes Maqedonisë dhe Shqipërisë, me dy shënime, që banorët e Dibrës të mund të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe që dy shtetet e ardhshme do të merren vesh për të gjitha detajet në lidhje me kufitë e domosdoshëm për ekonominë e të dy shteteve. Është arritur edhe pajtueshmëri për mbështetje reciproke në rregullimin e kufireve me Greqinë, zhvillim të bashkëpunimit me mjedise tjera me orientime antisërbe dhe antigreke, ndërsa komitetet maqedonase u angazhuan që t’ju japin mbështetje komiteteve shqiptare në lidhje me hapësirat e fituara nga Mali i Zi në vitin 1878 dhe 1913.

Në vazhdim e japim tekstin e plotë të marrëveshjes.

e organizuar në kantone ku një gjuhë esperante do të jetë gjuhë e përbashkët. Shiko Dimitar Bechev “Historical Dictionary of the Republic of Macedonia”, “The Scarecrow Press, Inc.”, 2009, pp. 75-76.

Marrëveshje e komiteteve shqiptare dhe bullgare¹⁰³

Neni I

Komiteti bullgar dhe shqiptar, të përfaqesuar nga më poshtë të nënshkruarit, definitivisht u pajtuan për çështjet e rradhës:

A. Qëllime

Neni II

Komitetet e marrëveshjes kanë për qëllim:

1. Të lirohet Maqedonia dhe të ndërtohet si shtet i pavarur që do të ketë renditjen politike dhe administrative të njejtë sikur Zvicra (republikë federale), me kufinj ekonomik dhe gjeografik të saj.

2. Të lirohet provinca shqiptare Kosova dhe hapësira shqiptare Çamëria dhe t'ju mundësohet bashkim definitiv me Shqipërinë.

Neni III

Komitet e marrëveshjes marrin përsipër që të luftojnë me të gjitha mjetet dhe të mos ç'armatosen para se të arrihen qëllimet e caktuara.

B. Kufijt shqiptaro-maqedonase

Neni IV

Kufijt shqiptaro-maqedonase paraqesin çështje, zgjidhja e të cilës është nën kompetencë të shteteve të ardhshme fqinje. Megjithatë, komitetet e marrëveshjes parimisht kanë pajtueshmëri për kufinj të ardhshëm. Ajo linjë fillon në Cbevak, vazhdon nëpër malet e Karadakut (Karadaku i Shkupit), kalon ndërmjet Elezhanit dhe Kaçanikut që të arrin deri tek mali i Sharrit dhe kufirin e tanishëm shqiptaro-jugoslloven, me atë kushtëzim që banorët e Dibrës do të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për vetëvendosje dhe dy shtetet e ardhshme do mund të mirren vesh për të gjitha detajet dhe korigjimet të domosdoshme për ekonomikën e të dy shteteve

C. Mbështetje reciproke

Neni V

Për rregullimin e konfliktit shqiptaro-malazez për hapësirat shqiptare të okupuara nga ana e Malazezëve në vitet 1878 dhe 1913 komitetet maqedonase angazhohen që t'ju ndihmojnë komiteteve shqiptare.

¹⁰³ Михајло Миноски, „Договорот на ВМРО – Автономистичка и Албанскиот косовски комитет за политичка соработка и за разграничување помеѓу проектираните независни држави: Обединета Македонија и Голема Албанија, 1921 година“ „Историја“, 1-2, Скопје, 1997, 111-116.

Neni VI

Komitetet e marrëveshjes marrin përsipër që reciprokisht të ndihmohen për rregullimin e kufirit shqiptaro-grek dhe maqedonaso-grek.

Neni VII

Të gjithë emigrantët maqedonas dhe shqiptarë, duke njehsuar nga viti 1878, do të shërbehen me të drejtën e tyre të kthehen në vendet e tyre të lindjes që të jenë pjesëmarrës në përcaktimin e fatit të vendit të tyre.

Ç. Organizim i përbashkët

Neni VIII

Komitetet e marrëveshjes marrin përsipër që të organizojnë pjesën më të madhe të mundshme të popullatës dhe ta përgatisin të merr pjesë në luftë.

Neni IX

Organizatat e komiteteve të marrëveshjes do të jenë në bashkëpunim konstant me ndërmjetësim të përfaqësuesve të tyre, ndërkaq çdo vepër e ligjshme ose e jashtëligjshme do të bëhet me pajtim paraprak të atyre përfaqësuesve.

Neni X

Komitetet e marrëveshjes marrin përsipër që ta lehtësojnë aktivitetin e agjentëve të tyre në Maqedoni nëpërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë.

Neni XI

Komitetet e marrëveshjes marrin përsipër të zhvillojnë bashkëpunim me mjedise tjera anti serbo-greke, në pajtim me dispozitat e caktuara më lartë.

20 dhjetor 1921

Për komitetet shqiptare:

Rexhep Mitrovica

Prof. Bedri Pejani

Për komitetet bullgare:

Aleksandar Protogerov,

anëtar i KQ VMRO

Del. D-r Atanasov

Pasojat praktike të kësaj marrëveshje nuk janë realizuar. Nuk janë të njohura reagimet e palës shqiptare, ndërsa kur ka të bëjë me anën maqedonase, kur kjo marrëveshje në prill të vitit 1922 i është dërguar

për aprovim kryesuesit e VMRO-së, Todor Aleksandrov, ai me mllef e ka refuzuar. Përskej asaj, Aleksandrov i ka dërguar letër Filip Atanasovit dhe haptazi i është kërcënuar me vdekje. Gjegjesisht, në letrën deri tek ai, Aleksandrov i thotë që e ka dërguar shokun e tij Protogerov qëllimisht të hyjë në bisedime me federalistët që ti zbulon “planet dhe qëllimet djallëzore” të tyre, duke vazhduar me fjalët në vijim: “Duhet të dini që ne, dhe askush tjetër, kemi të drejtë të thërasim konferenca, të zhvillojmë bisedime me faktorë të huaj etj., dhe të dërgojmë njerëz ose grupe në Maqedoni. Të dini se për veprimin e kryer nga ana e juaj do të përgjigjeni me kokën tuaj.” Menjëherë pas saj, nën presion të Aleksandrovit, nga marrëveshja është tërhequr edhe Protogerov. Nga ana e tij edhe Filip Atanasov ka qenë ashpër i kritikuar nga udhëheqësia e MEFO-së pasi që pa dijeninë dhe pajtueshmërinë e tyre ka bashkëpunuar me anëtarin e KQ VMRO-së Protogerov dhe pasi që e ka nënshkruar protokolin pa pasur autorizim nga organizata federative.¹⁰⁴

4.2 BASHKËPUNIMI NË KUADËR TË KOMITETIT BALLKANIK TË ORGANIZATAVE NACIONALÇLIRIMTARE

Organizatata majtë të orientuara dhe nacionalçlirimtare ballkanike, të detyruar të punojnë në mërgatë për shkak të rrethanave jodemokratike në shtetet ballkanike gjatë periudhës mes dy luftërave botërore, nën patronatin e Internacionales komuniste kanë lidhur bashkëpunim të ndërsjelltë. Si rezultat i këtij bashkëpunimi ka ardhur edhe deri te formimi i Komitetit ballkanik të organizatave nacionalçlirimtare. Në atë me përfaqësues të vetë kanë deleguar VMRO (e Bashkuar) – Dimitar Vllahov, Komiteti për çlirim të Kosovës – Hasan Prishtina, Komiteti shqiptar për çlirim nacional – Fan Noli, Organizata revolucionare e Dobruxhës – Petar Viçev, Komiteti perëndimoro-thrak - Fuad Beg¹⁰⁵

¹⁰⁴ Зоран Тодоровски, „Автономистичката ВМРО на Тодор Александров (1919-1924)“, „Макавеј“, Скопје, 2013, 71. Тодор Александров, „Сè за Македонија: документи 1919-1924“, „Аналитико – АИ“, Скопје, 2005, 65.

¹⁰⁵ Дечо Добринов, „ВМРО (Обединена)“, Универзитетско издателство „Св. Климент Охридски“, Софија, 1993, 73.

Nga aktiviteti i këtyre organizatave këtu do të ndalemi tek Protokoli për bashkëpunim të cilin e kanë nënshkruar VMRO-ja (e Bashkuar) dhe Komiteti për çlirim të Kosovës në vitin 1926 dhe në memorandumet e përbashkëta dhe apelet e të gjitha organizatave anëtare të Qendrës ballkanike të cilat ata i kanë dërguar në vitin 1929.

Nënshkrimi i Protokolit për bashkëpunim në mes VMRO-së (së Bashkuar) dhe Komitetit për çlirim të Kosovës ka ardhur si rezultat i përcaktimit të VMRO-së (së Bashkuar) që të lidhin kontakte me lëvizje nacionalçlirimtare dhe organizata tjera të afërta të Ballkanit, me qëllim të krijimit të nje fronti të vetëm revolucionar i drejtuar kundër autoriteteve dhe shteteve aktuale të Ballkanit, të cilët e shtypnin popullin në aspektin kombëtar por dhe social. Në atë drejtim, VMRO-ja (e Bashkuar) më 28 janar të vitit 1926 sjell vendim të krijoje lidhje me Komitetin Kosovar, Organizatën revolucionare shqiptare, Organizatën nacionalrevolucionare Malazeze, Organizatën thrake, të Dobrokhës si dhe Organizatën revolucionare perëndimoro-thrake. Si rezultat i këtij vendimi më 10 shkurt të vitit 1926 është nënshkruar protokoli për bashkëpunim me Komitetin për çlirim të Kosovës, më 23 prill të po të njëjtit vit me Komitetin perëndimoro-thrak, ndërsa janë zhvilluar bisedime dhe me Organizatën revolucionare shqiptare dhe atë të Dobrokhës.¹⁰⁶

Protokolin për bashkëpunim ndërmjet VMRO-së (së Bashkuar) dhe Komitetit për çlirim të Kosovës e kanë nënshkruar Hasan Prishtina, në emër të Komitetit Kosovar, dhe Dimitar Vllahov, Georgi Zankov dhe Vlladimir Pop Tomov në emër të VMRO-së (së Bashkuar). Në atë të dy organizatat i harmonizojnë parimet e përgjithshme në bazë të cilave do të ndërtohet bashkëpunimi: vetëvendosje të popujve ballkanik, luftë për formim të republikës shqiptare me Kosovën në të, për Maqedoni të pavarur dhe Federatë Ballkanike, front të vetëm revolucionar ballkanik. Komiteti Kosovar e njëj VMRO-në (e Bashkuar) si fuqi të vetme revolucionare në të tre pjesët e Maqedonisë, a të njëjtën e shpall edhe VMRO-ja (e Bashkuar). Është sjellur vendim që të dyja organizatat ti harmonizojnë veprimet e tyre kundër regjimeve represive dhe reagimit të Ballkanit dhe mos të hyjnë

¹⁰⁶ Ibid., 70-73.

në asnjëfarë lidhje politikë me organizata dhe grupe tjera, qëllimet e të cilave janë në kundërshtim me ato të lëvizjes revolucionare ballkanike. Në qoftë se njëra nga organizatat sjell vendim që të hyjë në lidhje me palë të tretë, në Shqipëri apo Maqedoni, në pajtueshmëri me Protokolin, është e detyruar të njofton paraprakisht partnerin e saj. Sipas Protokolit, edhe Komiteti kosovar edhe VMRO-ja (e Bashkuar) është duhur të delegojnë përfaqësues pranë kryesisë së organizatës tjetër.

Përveç këtyre dispozitave kryesore, në Protokol janë vendosur edhe angazhimet konkrete të secilës prej palëve. Komiteti për çlirim të Kosovës detyrohet të shfytëzojnë ndikimin e saj ndërmjet shqiptarëve të Maqedonisë që ata të anëtarësohen në VMRO-në (e Bashkuar), dhe poashtu të mos formojë organizatë të veten në Maqedoni. Ai detyrohet dhe të ndihmon në formimin e bazës së VMRO-së (së Bashkuar) në Shqipëri, si dhe në kanalet për shpërndarje të literaturës dhe materialeve tjera. VMRO-ja (e Bashkuar), nga ana tjetër, merr përsipër të bëj propagandë gjithandej, ku është e mundur, qëllimet dhe idetë e Komitetit kosovar.

Në rast se Komiteti kosovar arrin ta fitoje pushtetin në Shqipëri ose në rast se fiton ndikim mbi politikën e shtetit, në pajtueshmëri me Protokolin, ai detyrohet të mbështet lëvizjen revolucionare maqedonase dhe ballkanike. Të njëjtin detyrim e merr përsipër edhe VMRO-ja (e Bashkuar).¹⁰⁷

Megjithatë, efektet praktike nga ky dhe protokolet e tjera për bashkëpunim mes organizatave progresive ballkanike kanë mbetur të porealizuara.¹⁰⁸ Në vitin 1926 është tentuar të formohet bazë e VMRO-së (së Bashkuar) në Shqipëri dhe me atë qëllim KQ i VMRO-së (së Bashkuar) në maj të vitit 1926 e ka dërguar Georgi Zankovin në Shqipëri. Detyra e tij ka qenë të krijojë kanal për dërgimin e materialeve propagandistike në Maqedoninë e Vardarit dhe të Egeut dhe të krijojë

¹⁰⁷ Ibid., 71-72. Në vitin 1991 Instituti për histori kombëtare shpalli një libër të dedikuar dokumenteve dhe materijaleve të VMRO (e Bashkuar). Edhe pse libri përmban dokumente prej vitit 1926, midis tyre nuk është Protokoli për bashkëpunim me Komitetin për çlirimin e Kosovës. Mbetet e panjohur vallë redaktori i librit, Ivan Katarxhiev nuk ka qenë i njohtuar me egzistencën e këtij dokumenti ose a i është anashkaluar për shkak të ndonjë arsyeje politike. Иван Катарциев (redaktor) „ВМРО (Обединета): документи и материјали“, libri I, ИНИ, Скопје, 1991.

¹⁰⁸ Добринов, op. cit., 74.

lidhje me komitetin e rajonit në Maqedoninë e Vardarit. Zankov ka organizuar kanal për në rajonin e Kosturit dhe të Lerinit nëpërmjet linjës Korçë-Biglica-Vërbnik, por ndryshimi i rrethanave në Shqipëri për shkak të përmbysjes së pushtetit nga ana e Ahmet Zogut, si dhe për shkak të mungesës së mjeteve materiale dhe njerëzve në besim e kanë detyruar KQ të VMRO-së (së Bashkuar) të heq dorë nga krijimi i kanalit nëpërmjet Shqipërisë.¹⁰⁹

Megjithatë, edhe pse nuk ka patur efekte praktike nga veprimtaria e Komitetit ballkanik të organizatave nacionalçlirimtare dhe nga bashkëpunimi i anëtarëve të tij, apelet, peticionet, memorandumet dhe dokumentet e tjera të dërguara në forume të ndryshme ndërkombëtare, të shpallura në emër të popujve të shtypur të Ballkanit, janë dëshmi për dëshirën dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjelltë të forcave progresive të Ballkanit. Në vitin 1929 anëtarët e Komitetit ballkanik të organizatave nacionalçlirimtare, përfshirë edhe organizatat maqedonase, shqiptare dhe kosovare, kanë shpallur së paku gjashtë dokumente në të cilat i shprehin qëndrimet, kërkesat dhe apelet e përbashkëta.¹¹⁰ Në këto dokumente thirren “të gjithë popujt e Ballkanit të formojnë një front të përbashkët nacional kundër tiranëve ballkanik.”¹¹¹, duke nënvizuar mosbashkëpunimin ndërmjet popujve si shkak i dështimeve deri në atë moment. Ashtu, në Apelin deri tek popujt e Jugosllavisë me rastin e vendosjes së diktaturës në vitin 1929 thuhet: “Historia e lëvizjeve tona revolucionare në Mal të Zi, Maqedoni, Kosovë, luftat nacionale në Kroaci dhe në hapësirat tjera na tregojnë se kemi qenë të mundur vetëm për shkak se forcat tona s’kanë qenë të bashkuara në një front të vetëm... Në qoftë se të gjitha forcat tona bashkohen në një front të përbashkët revolucionar, ata do të jenë në gjendje që në një të ardhme të afërt ti thyejnë tiranët e Beogradit.”¹¹² Qëllimi i këtij bashkëpunimi të ndërsjelltë të popujve dhe të organizatave nacional-revolucionare të tyre do të ishte

¹⁰⁹ Ibid., 57-58.

¹¹⁰ Shiko Катарциев, op. cit., 168-169, 172-173, 175-181, 219-221, 241-242 и 246-247.

¹¹¹ Ibid., 180.

¹¹² Ibid.

formimi i lidhjes së republikave të lira nacionale të Ballkanit, Federatës ball-kanike. Në letrën e tyre deri tek Shoqata e popujve më 5 mars të vitit 1929, organizatat nacional-revolucionare ballkanike potencojnë: “Ne jemi thellësisht të bindur se gjendja e papërballueshme momentale të popujve të shtypur do të ndalon së egzistuari në momentin kur në Ballkan do të vendoset një regjim i cili do tju lejoj këtyre popujve të vetëvendosin, të disponojnë me fatin e tyre dhe, në kushte të lirisë, të kyçen në federatë, duke formuar në atë mënyrë një lidhje vëllazërore.”¹¹³ Në kushte të egzistimit të një regjimi jodemokratik në shtetet ballkanike, organizatat nacional-revolucionare ballkanike nuk besonin se është e mundur të vijë deri te realizimi i kësaj në mënyrë paqësore, por vetëm me luftë revolucionare masovike. Në letrën e tyre deri tek Kongresi i pestë i pakicave nacionale që është mbajtur në gusht të vitit 1929 në Gjenevë ata potencojnë: “Baza e vetme e drejtë, metodat dhe taktikat e vetme që janë në gjendje ti mbrojnë interesat dhe idealet e popujve të shtypur dhe pakicave nacionale përmbahen në metodën e luftës masovike revolucionare dhe ajo luftë zhvillohet dhe do të zhvillohet kundër marrëveshjeve paqësore (të arritura pas fundit të Luftës së parë botërorë), kundër regjimeve të diktaturës dhe shtypjes kombëtare, për të drejtën për vetëvendosje të atyre popujve, për pavarësi kombëtare të tyre.”¹¹⁴ Ngajshëm, në protestin e dërguar në tetor të vitit 1929 deri tek Kongresi ndërkombëtar për paqe, i parë që është mbajtur në Ballkan, konkretisht në Athinë, thuhet: “Popujt e shtypur të Ballkanit dhe pakicat nacionale e marrin veprimtarinë e tyre çlirimtare në dorë të tyre dhe bashkë me masat punëtore të shtypura nga kombet zotëruese luftojnë dhe do vazhdojnë të luftojnë në mënyrë revolucionare, mundësia e vetme për luftim në Ballkan kundër diktaturës fashiste dhe shtypjes nacionale, për çlirim të krejtësishtëm që do të arrihet kur do jenë anuluar marrëveshjet, kur do jenë përmbysur edhe regjimet terroriste aktuale të Ballkanit, kur ata popuj do fitojnë mundësinë të rregullojnë punët e tyre ashtu si ata i kuptojnë dhe kur do të lidhen në

¹¹³ Ibid., 169.

¹¹⁴ Ibid., 220.

Federatë ballkanike të lirë. Në atë mënyrë Ballkani do ndalon të jetë në mënyre konstante djep i luftërave të cilat mund të rrezikojnë paqen në Europë dhe në kontinentet e tjera, në atë mënyrë do vjen deri tek paqja e vërtetë në Ballkan.¹¹⁵

¹¹⁵ Ibid., 242.

5

Lufta Nacionalçlirimtare

Pas sulmit të Gjermanisë nacistë dhe aleatëve të saj mbi Mbretërinë Jugosllave, në prill të vitit 1942 erdhi deri në okupacion të ri dhe ndarje të Maqedonisë së Vardarit. Pjesa lindore dhe qendrore i takuan Bullgarisë, kurse pjesa perëndimore hyri në përbërje të Shqipërisë, e cila atëher ishte protektorat i Italisë fashiste. Mbas kapitulimit të Italisë në shtator të vitit 1943, pjesa perëndimore e Maqedonisë së Vardarit hyri nën qeverisje të Gjermanisë nacistë dhe aleatët e saj Balliste.

Okupacioni i ri i Maqedonisë shkaktoi rezistencë, të armatosur kundër vetë okupacionit, e njohur si Lufta Nacionalçlirimtare (LNÇ). Atë e udhëheqnin komunistët dhe në të u bashkangjitën pjesmarrës të të gjitha grupeve etnike të cilat jetonin në Maqedoni. Nga shumica e ngjarjeve të cilat ndodhën gjatë okupacionit dhe LNÇ (1941-1944), në këtë kapitull do të përmbahemi në disa tema të cilat janë të rëndësishme nga pikpamja e bashkëpunimit të Maqedonasve dhe Shqiptarëve. Gjegjësisht, do të flasim për vrasjet masive të kryera në fshatërat Jabollçistë e Poshtme dhe Beliçica, për pjesëmarrjen e partizanëve shqiptar nga Maqedonia në LNÇ të Maqedonisë, për çlirimin e Kërçovës dhe Dibrës, për bashkëpunimin e lëvizjes nacionalçlirimtare të Maqedonisë dhe Shqipërisë dhe në fund, për protestin e qytetarëve të Tiranës për shkak të varjes së gjashtë vetëve partizan të Maqedonisë në burgun e Tiranës.

5.1 DY VRASJE MASIVE: JABOLLÇISHTA E POSHTME DHE BELIÇICA

Gjatë okupacionit të Maqedonisë së Vardarit, okupatorët kanë kryer disa vrasje masive mbi popullatën civile dhe mbi anëtarët e lëvizjes nacionalçlirimtare (LNÇ). Vrasja më e njohur masive (dhe e vetmja që shumica e dinë) është vrasja e 12 të rinjve nga fshati i Kavadarit Vatasha, në 16 qershor të vitit 1943. Për fat të keq, kjo s'ka qenë vrasja masive e vetme që ka ndodhur. Prej vrasjeve masive që janë kryer, këtu do të

referojmë në dy, në vrasjen masive në Jabollçishtë të Poshtme e kryer në tetor të vitit 1942, në Veles, dhe në vrasjen masive në Beliçicë të Gostivarit, në shtator të vitit 1944.

Të dy rastet kyçin shqiptarë si protagonistë kryesor. Por, në rastin e parë shqiptarët janë viktimë e një brutaliteti, kurse në rastin tjetër shqiptarët janë ato që kanë bërë brutalitetin. Në rastin e parë shqiptarët refuzojnë të tregojnë se ku janë partizanët (maqedonas) duke e vënë në rrezik jetën e të dashurve të tyre dhe vetveten, kurse në rastin tjetër shqiptarët bëjnë luftë me partizanët maqedonas dhe shqiptarë. Del puna se shqiptarët mund të jenë edhe të këtillë por edhe të atillë, të sakrifikohen për të tjerë, pavarësisht përkrahjes së ndryshme etnike të tyre, ose të bëjnë terror mbi të tjerë, kryesisht ose vetëm për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Mandej, jo vetëm tek shqiptarët, por edhe tek popujt tjerë ka edhe të këtillë edhe të atillë. Nuk egzistojnë popuj të cilat janë vetëm të mirë ose vetëm të këqinj. Deklaratat e kundërta janë vetëm propagandë e lirë nacionalistike, gjithmonë në favor të “vërtetës” nacionaliste/kombëtare të vet.

5.1.1 Jabollçishtja e Poshtme

Fshatërat e Velesit Jabollçishtja e Epërme dhe e Poshtme janë fshatëra etnike shqiptarë që nga kohët e lashta. Gjatë luftës të dytë botërore, fshatarët e këtyre fshatrave, si dhe nga fshati Slivnik, fshat i banuar etnikisht me shqiptarë, krejtësisht e kanë ndihmuar lëvizjen nacionalçlirimtare. Kjo u vërtetua posaçërisht gjatë kohës kur në atë regjion vepronte Aradha partizane e Velesit. Këto fshatra rregullisht i furnizojnë partizanët me ushqim, por dhe kryenin punë të korierit për aradhën. Përmes tyre në vitin 1942 ka qenë i transferuar pothuajse i gjithë armatimi i aradhës prej qytetit të Velesit.¹¹⁶

Aksioni ndëshkimi i okupatorit bullgar në fshatin Jabollçishtë e

¹¹⁶ Никола Кирков, Јордан Леов, „Велес во НОВ: велешките партизански одреди“, „Култура“, Скопје, 1952, 39. Autorët e këtij libri përmendin dhe disa persona konkrete të cilat u kanë ndihmuar partizanëve. Ashtu, partizanët e parë të aradhës në bazën i ka udhëhequr korieri nga f. Slivnik, Megdiu. Ushqim u ka dhënë Bexhet Xhaferov Mustavov nga Jabollçishtja e Poshtme, kurse si korier përmendet Asim Izet Latifov, gjithashtu nga Jabollçishtja e Poshtme. Shiko Ibid., 40., 40.

Poshtme ka ndodhur me 24 tetor të vitit 1942, një javë pas masakrës në Bogomilë, ku janë vrarë 16 persona. Që ditë më parë Jabollçishta e Poshtme ka qenë e bllokuar nga drejtimi i fshatit Drenovë dhe nga ana e Shkupit.¹¹⁷ Shumë ushtarë bullgar, të shoqëruar me agjentë dhe police, hyjnë në fshat, i tërheqin me dhunë fshatarët prej shtëpive të tyre dhe i mbledhin në mes të fshatit. Nëpër shtëpitë nuk është lejuar të mbeten as fëmijët e as pleqet që me njëren këmbë bile ishin në varr.¹¹⁸

Ushtarët pikë së pari kan urdhëruar prej fshatarëve t'u sjellin ushqim. Pasi ishin ngopur, i kishin renditur fshatarët dhe u kan urdhëruar të kërcëjnë valle. Kishin filluar ti godasin nëpër këmbë me shkop të thatë, duke i pyetur se ku janë partizanët e Aradhës së Velesit dhe cilët janë simpatizuesit e tyre. Edhe pse fshatarët atë e kishin ditur, asnjëri nuk ka folur se ku janë.¹¹⁹ Atëher, fashistët kishin filluar me dhunë dhe me vrasje. Veçanërisht dy prej vrasjeve kishin qenë shumë brutale, vrasja e plakut 62-vjeçar Izet Latif Feizov dhe e Imione Abazova, ajo ka qenë nënë e një foshnje.¹²⁰

Izeti ka qenë baba i Asim Izet Latifovit, i cili u ka ndihmuar partizanëve. Ai ka qenë i selektuari i parë prej fshatarëve të mbledhur. Afër tij ka qëndruar djali i tij, prej të cilit ushtarët kanë kërkuar që ti dorëzojë partizanët. Asimi, edhe pse i rrahur deri në vdekje, ai ka heshtur. Njëri prej ushtarëve ka filluar t'ia presë këmbën babait të tij. Asimi ka vazhduar të heshtë. Nuk ka folur as i ati i tij, as kur ia kishin prerë këmbën. Më vonë ushtarët kishin ndezur një hangar dhe në të e kishin hedhur këmbën e prerë të Izetit, i cili në ndërkohë ishte alivanosur, më vonë ka qenë i vrarë para syve të djalit të tij.¹²¹

E tmerrshme ka qenë edhe vdekja e Imione Abazovës. Ajo, gjithashtu në mes të fshatit, foshnjën e saj e ka mbajtur në duar, qarja e foshnjës ka

¹¹⁷ Никифор Смилевски, „Крвавата ноќ во Јаболчиште“, „Вардарски глас“, 18 април 1982, 14.

¹¹⁸ Кирков, Леов, op. cit., 103-104.

¹¹⁹ Смилевски, op. cit.

¹²⁰ Në librin e Кирков dhe Леов (104 fq.), si dhe mbishkrimi në „Вардарски глас“ prej 11 tetorit të vitit 1979 nëna është e identifikuar gabimisht si Bitulla Mustafova, derisa në „Вардарски глас“ prej 21 tetorit të vitit 1987 ajo është e identifikuar siç duhet si Imione Abazova.

¹²¹ Н. К., „И мртва, Битула не го испушти детето“, „Вардарски глас“, 11 октомври 1979, 16. Кирков, Леов, op. cit., 40 dhe 104.

patur jehonë në të gjithë fshatin. Gjatë rrahjes dhe torturimit, një ushtar bullgar, për ta detyruar të pranojë, me bajonetë e ka shpuar foshnjën në duart e saj. Edhe pse e kishin rrahur, Imioneja nuk e ka lëshuar foshnjën prej duarve të saja. Ajo nuk e ka lëshuar as atëher kur në trupin e saj kishin filluar ta shpojnë bajonetat e ushtarve. Edhe e vdekur, ajo nuk e ka lëshuar foshnjën e saj. Gjaku i saj e ka përmbytur trupin e vogël të foshnjës. Më vonë, fshatarët me vështirësi të madhe kanë arritur ta shërojnë foshnjën.¹²²

Bilansi i përgjithshëm i brutalitetit të fashistëve ka qenë njëmbëdhjetë fshatarë të vvarë. Më i vogli nga këto, Rasim Jusufov Abazov, ka patur vetëm 12 vjet, ndërsa më i moshuari, plaka Anife Nafija Ibrahimova, ka qenë 72-vjeçare.¹²³ Megjithatë, shumica e fshatarëve kanë qenë të gjymtuar, gjithë fshati ka qenë i rrahur. Por, asnjë nga Jabollçishta e Poshtme nuk i ka dorëzuar partizanët. Asnjëri nuk ka treguar se ku fshihen ato as se kush janë simpatizuesit e tyre.

Për shkak të vrasjeve në Jabollçishtë të Poshtme, muajin e ardhshëm partizanët nga aradha partizane e Velesit kanë hyrë në fshatin Drenovë me qëllim që ta kapin të birin e bakallit të fshatit, i cili i ka treguar lidhjet midis partizaneve dhe simpatizuesve në Jabollçishtë të Poshtme dhe drejtpërdrejt ka qenë fajtor për vrasjen e Bexhet Mustafov, të cilin e kanë konsideruar si korier më të mirë të aradhës, dhe simpatizuesve të tjerë nga Jabollçishta e Poshtme. Partizanët kanë hyrë në Drenovë pa luftë, ku e kishin kapur të birin e bakallit dhe e kishin varur.¹²⁴

Përndryshe, vrasja e kryer nuk do ti frenonte fshatarët e Jabollçishtit të Poshtëm nga përkrahja për LNÇ. Shumica janë kyçur dhe në aradhat partizane, dhe të paktën katër vetë të rinj nga ky fshat kanë vdekur si partizanë në luftërat kundër ballistëve dhe fuqive të tjera armike.¹²⁵

¹²² H. K., op. cit., Кирков, Леов, op. cit., 104. „Живи фрлени во оган“, „Вардарски глас“, 21 октомври 1987, 11. Sipas tregiveme të fshatarëve të Jabollçishtit të Poshtëm, foshnja, Bajazit Abazovski, ka qenë i marrur në mjek, që ta shërojnë, ia kanë prerë këmbën.

¹²³ „Велес и Велешко во Народно ослободителната војна 1941-1945: спомен книга на загинатите борци во НОВ и жртви на фашистичкиот терор од Велес и Велешко“, Титов Велес, 1985, 111-129. Sipas burimeve tjera, kanë qenë të vvarë shtat veta (H. K., op. cit. dhe monumenti i vjetër në Jabollçishtë të Poshtme), tetë veta (Кирков, Леов, op. cit.) dhe nëntë veta (Смилевски, op. cit. dhe monumenti i ri në Jabollçishtë të Poshtme).

¹²⁴ Кирков, Леов, op. cit., 135.

Në qoftë se vendosim syza etnike, ashtu siç nacionalistët deshirojnë, sjellja e fshatarëve të Jabollçishtis së Poshtëm mundet të na duket shumë çuditëse. Bëhet fjalë për fshat i cili etnikisht është i banuar me shqiptarë, kurse shumica e luftëtarëve të aradhës partizane të Velesit kan qenë maqedonas. Duke shikuar nga kjo perspektivë, ajo që në fillim mund të na duket e çuditshme është ajo përse fshatarët e Jabollçishtit të Poshtëm, si dhe ato të Jabollçishtit të Epërm dhe Slivnikut, fshatra shqiptarë gjithashtu, i kanë ndihmuar partizanët. Përse për shembull, nuk kan qenë indiferent, në qoftë se fundja nuk kan mundur të jenë armiq me ta. Edhe më shumë çudit ajo se si fshatarët (shqiptar) refuzojnë t'u tregojnë informacionë ushtarëve bullgar se ku fshihen partizanët (maqedonas). Bullgarët përndjekin maqedonasit. Përse ndonjë shqiptarë të merret me ndonjë mosmarveshtje të tyre, edhe në fund të vuaj nga pasoja e heshtjes? Pse, thjeshtë nuk u kan treguar se ku ndodhen? Do të shpëtonin nga të gjitha torturat, rrahjet, vrasjet që atë ditë ushtarët bullgar i kan bërë mbi ata por edhe mbi të afërmive e tyre. Megjithatë, atë nuk e kan bërë. Babai ka vdekur para syve të djalit të vet, nëna ka shikuar se si me bajonet ia shpojnë foshnjën. Pse shqiptarët me vetëdije i nënshtrohen kesi far torture për konflikt midis maqedonasve dhe bullgarve? Si duket identifikacioni etnik nuk ka qenë për ta më i rëndësishëm dhe disa vazhdimisht refuzojnë ta shikojnë botën përmes syzeve etnike, duke i kundërshtuar dëshirat e gjithë nacionalistëve.

Masakri në Jabollçishtën e Poshtme është një akt i urryer që ka një potencial antinacionalistik. Në eks Jugosllavinë vllëzërimi dhe bashkimi ishte një nga vlerat themelore. Megjithatë, asnjë nuk ka punuar në atë që publiku të informohet për ngjarjen, as që janë shprehur momentet e tij antinacionalistik. Fakt që befason dhe çudit

5.1.2 Beliçica

Fshati i Mavrovës Beliçica gjatë LNÇ ka qenë i njohur si fshat i partizanëve. Ky fshat ka dhënë numër të madh të luftëtarëve në ushtrinë

¹²⁵ Bëhet fjalë për Malik Esadov Ibrahimov, Shaip Alilov Imerov, Vait Latifov Selimov dhe Sakip Murtezanov Imerov. Shiko „Велес и Велешко во Народно ослободителната војна 1941-1945“, op. cit., 60, 61, 89 dhe 101.

Nacionalçlirimtare, ka qenë qendër për lidhje të Partisë Komuniste dhe ushtrisë Nacionalçlirimtare, por dhe shpesh here ka ofruar strehim të sigurtë të ilegalve dhe kalim të funksionerëve të lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në Belëçicë, dhe në rrethin e saj shpesh kishin kaluar çetat partizane, të cilat fshatarët i kanë furnizuar me ushqim. Ndër të tjera, në korrik të vitit 1944 në Bistra, në afërsi të Belëçicës, disa ditë ka qenë e vendosur Brigada e parë shqiptare, e cila është çlodhur pas betejave të rënda që i ka luftuar në Shqipëri dhe fshatarët e Belëçicës u kishin siguruar ushqim të duhur derisa ata kanë qendruar në fshat.¹²⁶

Disa muaj para masakres në 19 shtator të vitit 1944, më saktë në korrik të vitit 1944, ballistët e kanë sulmuar fshatin. Atëher ato kishin rrahur shumë fshatarë, kishin plaçkitur shumë bagëti dhe kishin vrarë një fshatar.¹²⁷ Nuk dihet vallë ky sulm a është i lidhur me qëndrimin e partizanëve shqiptarë në afërsi të fshatit, që ka ndodhur në të njëjtin muaj. Megjithatë, fakti që qëndrimi i partizanëve shqiptarë dhe sulmi i ballistëve në Belëçicë ka ndodhur në të njëjtin muaj e bën supozimin real se ballistët e kanë sulmuar Belëçicën për shkak se fshatarët e Belëçicës u kishin ndihmuar partizanëve shqiptarë ose kjo ka qenë vetëm njëra prej arsyeve të sulmit.¹²⁸

Sulmi tjetër mbi fshatin u bë në orët e mëngjesit, me 19 shtator të vitit 1944 dhe e bënë mbi 300 ballist të armatosur në krye me Aqif Krosin – Reçani.¹²⁹ E pa planifikuar, drejtpërdrejtë para sulmit të ballistëve mbi Belëçicën, në fshat kishin ardhur luftëtarët e aradhës së tretë të partizanëve. Kjo aradhë ka qenë e përbërë prej 35 luftëtarësh, prej të cilave pjesa më e madhe sa që u ishin bashkangjitur partizanëve dhe vetëm 13 prej tyre kanë qenë të armatosur.¹³⁰ Në përbërjen e Aradhës ka patur maqedonas,

¹²⁶ Нешо Маркоски, „Беличица во пламен“, „Полог“, Тетово, 1975, 21-22.

¹²⁷ Ibid., 23.

¹²⁸ Sipas Stojan Karajovov, ballistët e kanë kërkuar Zhivko Brajkovski, i lindur në Belëçicë dhe sekretar i komitetit të rrethit të PKM për rrethin e Mavrovës. Стојан Карајанов, „И Беличица гореше“, СИЗ за култура – Гостивар, 1985, 17.

¹²⁹ Маркоски, op. cit., 24 dhe 32.

¹³⁰ Ibid., 7.

¹³¹ Kur aradha e Tretë partizane e Tetovës ka qenë në Belëçicë, nga partizanët Shqiptarë në përbërje të aradhës ka qenë Murat Baftijari, kurse më pare në përbërje të tijë gjatë formimit kanë qenë Nafi Sulejmani,

sërb si dhe shqiptar të cilat kanë migruar në rrethin e Tetovës¹³¹ Aradha është drejtuar prej malit Shar për në Karaorman dhe Debarcë me qëllim që ta plotësojë armatimin, dhe më vonë të kthehet në regjionin e Tetovës. Në orët e hershme të mëngjesit me 19 shtator Aradha ka hyrë në Beliçicë me qëllim që të rregullojë lidhje dhe të furnizohet me ushqim para se të vazhdojë më tutje.¹³² Kur kanë marrë vesh se janë të rrethuar, pavarësisht armatimit të dobët dhe numrit shumë më të vogël, partizanët kanë vendosur që ta pranojnë betejën dhe ta mbrojnë fshatin. Në betejën që ka zgjatur më shumë se gjashtë orë, disa partizan kishin arritur përmes një sulmi me qëllim që të depërtojnë rrethimin e armikut, por 19 veta kishin qenë të vratë kurse katër kishin qenë të robëruar.¹³³ Pas betejës, siç thekson Nesho Markovski, një nga luftëtarët e Aradhsë se Tretë të parizanëve të Tetovës, që kishin përjetuar, në fushë betejën “kanë qenë të shtrirë njëri ndaj tjetrit puntor, bujk, nxënës; maqedonas, sërb dhe shqiptarë; dy vllëzër dhe një motër e tyre; shokë të shkollës së pandarë; nxënës të shkollëve të tetovës.”¹³⁴

Pas mposhtjes së rezistencës së partizanve, ballistët kishin hyrë në fshat dhe kishin filluar të abuzojnë dhe shkelin trupat e partizanve të vrarë. Trupat u’ a kishin ripërtryer me gurë dhe me thika, ua kishin nxjerrë dhëmbët, i kishin kontrolluar dhe u’ a kishin marrë sendet personale, kishin shtënë me armë në trupat e vdekur dhe u’ a kishin zhveshur teshat që ti marrin me vete si “trofe lufte”. Trupi i partizanit të vrarë, Murat Baftijari, në fillim është shkelur dhe pështyrë, janë hedhur mbi të, e kanë goditur me gurë, më vonë me thika ia kanë prerë trupin pjesë-pjesë, që më

Shain Sadiku, Taip Taipi, Ibrahim Ibrahimi dhe Koço Prenda. *Ibid.*, 13 dhe 16.

¹³² *Ibid.*, 11-12 dhe 15.

¹³³ *Ibid.*, 35-36, 37 dhe 41.

¹³⁴ *Ibid.*, 37.

¹³⁵ *Ibid.*, 38. Каражанов, op. cit., 26-27. Murat Baftijari ka qenë i lindur në vitin 1918 në Vicë të Tetovës. Ka qenë bujk i varfër. Familja e tijë prej vitit 1943 aktivisht e ka ndihmuar luftën nacionalçlirimtare. Në afërsi të fshatit të tijë ka qenë edhe baza e partizanëve të Tetovës. Baftijari, së bashku me një grupë bashkëfshatarësh veçanërisht është dalluar në furnizimin me ushqim e Aradhave të Dytë dhe të Tretë partizane të Tetovës, si dhe në kryerjen e detyrave të korierit midis bazës të partizanëve dhe organizatës të partisë komuniste në Tetovë. Në fillim të shtatorit ka hyrë në Aradhën e Tretë partizane të Tetovës. Beliçica ka qenë beteja e tijë e parë dhe e fundit. Маркоски, op. cit., 57.

në fund në trupin e vdekur kanë shtënë edhe një grumbull plumbash.¹³⁵

Pas kësaj vijon hakmarrja e planifikuar mbi fshatarët, kishin qenë të vrarë 17 gra, fëmijë dhe pleq, të cilët më vonë kishin qenë të hedhur në zjarrin e shtëpive të tyre të ndezura. Plaka më e moshuar të cilën e kishin vrarë ballistët, derisa ka qenë e shtrirë në krevatin e saj nje kohë të gjatë për shkak të sëmundjes së vështirë, Liska Jovanovska, ka patur 88 vjet, dhe banori më i ri, Nada Brajkovska, ka qenë vajzë vetëm 12 vjeçare. Disa nga viktimat kanë qenë të hedhur të gjallë në zjarr, si partizani Savo Taseski dhe plaka 61-vjeçare Solomija Jovanovska.¹³⁶

Të katër partizanët që kanë qenë të robëruar nga ballistët, i kanë marrë me vete. Pas dy ditësh, me 21 shtator, tre vetë kanë qenë të egzekutuar në Tetovë. Megjithatë, njëri prej tyre, Sreten Teofilovski, edhe me 17 plumba në trupin e tij nuk u ka nënshtuar lëndimeve. Atëher Xhem Hasa ia ka falur jetën duke i thënë se vdekja nuk e don atë. Më vonë ai shërohet dhe shpëton.¹³⁷

5.2 PJESMARRJA E SHQIPTARVE DHE NJËSIA PARTIZANE SHQIPTARË NË LNÇ TË MAQEDONISË

Gjatë Luftës së dytë botërore shqiptarët të cilët jetojnë në Maqedoninë e Vardarit në mënyrë aktive ishin të kyçur në rradhët e LNÇ të Maqedonisë që aktivisht të marrin pjesë në çlirimin e kësaj pjese të Maqedonisë. Por partizanët shqiptar nuk marrin pjesë vetëm në çlirimin e regjioneve të banuara me shqiptarë në Maqedoni, por edhe në regjione të tjera. Përveç asaj që luftuan kundër okupatorit fashist italian dhe gjerman, ata luftuan edhe kundër shqiptarëve të cilët ishin aleatë të okupatorit. Ose kundër atyre që ishin me përkatësi të njejtë etnike. Por, ajo që nuk mund të paramendohet nga perspektiva e sotme është ajo që e gjithë kjo ka ndodhur duke bashkëpunuar me maqedonasit, sërbët, malazezët etj. Ky fakt është sulm frontal për të gjitha “përrallat” e nacionalistëve të cilët i kurdisin sot në Maqedoninë e pavarur. Atë që vazhdimisht na e përsërisin

¹³⁶ Ibid., 8, 38-40 и 80-86.

¹³⁷ Ibid., 41-42. Каражанов, op. cit., 28.

është ajo se shqiptarët çdo here kanë qenë armiq të maqedonasve. Sipas kësaj propagande, gjatë Luftës së dytë botërore, shqiptarët kanë qenë aleatë të okupatorit fashistiko-nacistik dhe si të tillë kanë qenë armiq të dretjpendrjetë të popullit maqedonas. Por, mjafton vetëm të lexohen disa artikuj dhe dokumente të cilat janë shkruar nga vetë pjesmarrësit gjatë LNÇ dhe pas saj, që të shikohen ngjarjet e vërteta dhe faktet të kësaj periudhe. Veçanërisht artikulli i Ilija Topallovski “Brigada e jonë dhe vëllazërimi me popullin shqiptar”,¹³⁸ posedon shumë informacione për pjesmarrjen e shqiptarëve në LNÇ së bashku me maqedonasit. Problemi me aparatit e sotëm diskurziv është në atë që e harron pjesën tjetër e të vërtetës, duke krijuar një përrallë e cila i derdh të gjitha themelet e krijimit të këtij shteti. Themelet janë konkretisht “Vëllazërim bashkim”.

Në vijim jepet një pamje të asaj se si është dukur krijimi i aradhave dhe bataljoneve të para, deri në krijimin e brigadës së parë të përbërë nga shqiptarë në Maqedoni, e quajtur Brigada e katërt Shqiptare. Më tutje jepen biografite e tre partizanëve shqiptarë nga Maqedonia, të cilët janë të shpallur si hero të popullit të Jugosllavisë. Ajo që duhet të theksohet, dhe që mund të vështrohet nga të dhënat më poshtë të shkruara, është ajo se pjesmarrja e shqiptarëve dhe njërive partizane shqiptarë në LNÇ të Maqedonisë është shumë më e madhe dhe më e rëndësishme se sa që mund të merren përshtypje për të nga historio-grafia oficiale maqedonase.

5.2.1 Pjesmarrja e shqiptarëve në njësitë e LNÇ të Maqedonisë dhe formimi i Brigadës së Katërt Shqiptarë

Shqiptarët e Maqedonisë, të cilët pas vitit 1941 ndodheshin nën kufijtë e protektoratit të Shqipërisë, proformë, ishin në gjendje më të ndryshme prej të tjerëve. Ata ishin të nënshtruar në propaganda nacionalistike për Shqipëri të madhe, sipas të cilës shqiptarët e Maqedonisë dhe të pjesëve të tjera të Mbretërisë Jugosllave, më në fund fituan liri. Çlirimi nga kjo

¹³⁸ Илија М. Топалоски, „Нашата бригада и братството со албанскиот народ“, <http://www.marxists.org/makedonski/istorija/makedonija/nasata-brigada.htm>.

propaganda e forcave liridashëse dhe progresive midis shqiptarëve, kishin mundur të shqyrtojnë me sukses vetëm partizanët shqiptarë. Për shkak të kësaj, Partia Komuniste e Maqedonisë mori drejtim në formimin e aradhave të ndara me shqiptarë, dhe më vonë të përziera me shqiptarë dhe maqedonas, të cilët hasën në pranim pozitiv të popullata shqiptarë.¹³⁹

Shqiptarët e Maqedonisë janë bashkangjitur në LNÇ në vetë fillimin e luftës së vitit 1941. Një nga partizanët e parë nga Maqedonia të cilët e humbën jetën për liri ishte Bajram Shabani, i cili u vra si luftëtar në aradhën e partizanëve të Karadakut. Numri i partizanëve shqiptarë vazhdimisht është zmadhuar dhe në vitin 1944 formohet brigade e posaçme nga ato. Formimi i një njësije ashtu të madhe luftarake i është paraprirë formimi i njësiive më të vogla dhe më të mëdha të cilët kishin patur përmbajtje vetëm shqiptarë ose të përziera.

Aradha e parë partizane, e përbërë me partizanë shqiptarë, është formuar në 10 maj të vitit 1943 në Kërçovë. Në fillim kjo aradhë ka numëruar 20 luftëtarë. Me aradhën ka komanduar Umer Domi – Ljuma.¹⁴⁰ Të njejtin vit okupatori Italian, me qëllim që të mobilizojë individë (Shqiptarë) nga popullata e vendit i dërgon në trajnim elementar ushtarak. Pjesa më e madhe nga ushtarët e mobilizuar kishin ikur, dhe më vonë janë bashkangjitur në çetat partizane.¹⁴¹ Është i njohur edhe rasti me Hamdi Demën, i cili ka qenë komandant i çetës së milicisë fashistike shqiptarë e cila ka vepruar në Kërçovë. Ai, mbas negociatave të bëra, në korrik të vitit 1943 është kyçur në forcat nacional-çlirimtare.¹⁴² Ose, i bashkangji- tet çetës me të cilën ka komanduar Umer Domi – Ljumi.¹⁴³

Brigadës së katërt Shqiptarë i paraprijnë edhe disa bataljonë të Dibrës, të cilat kanë kontribut të madh në LNÇ, por edhe në krijimin e kushteve

¹³⁹ Миле Тодоровски, „Партизанските одреди и Народноослободителната војска на Македонија во Ослободителната војна и Револуцијата 1941-1944“, ИНИ, Скопје, 1972, 185.

¹⁴⁰ Masar Kodra, „Shqiptarët e Maqedonisë gjatë luftës të dytë botërore (1939-1944)“, „Македонска ризица“, Кумановë, 1996, 161.

¹⁴¹ Ѓорѓи Чакарјаневски, „Хронологија на настаните на народноослободителната војна 1941-1945 во Кичево и Кичевско“, Музеј „Западна Македонија во НОВ“ Кичево, Скопје, 1994, 50.

¹⁴² Ibid., 50.

¹⁴³ Kodra, op. cit., 165.

për formim të brigadës.

Në 26 korrik të vitit 1943 në fshatin Gjericë, Shqipëri, është formuar batalioni partizan i Dibrës me të cilën ka komanduar Haxhi Lleshi i cili ishte në përbërje të LNC dhe AP të Shqipërisë. Deri atëherë kjo njësi ka vepruar me emrin Çeta partizane e Dibrës së Haxhi Lleshit, i cili u rebelua në mal menjëher pas okupimit të Mbretërisë Jugosllave në vitin 1941. Batalioni partizan i Dibrës ka numëruar 180 luftëtarë të cilët kanë qenë të shpërndarë në tre çeta: Gryka e madhe, Gryka e vogël dhe Slloves.¹⁴⁴ Luftëtarët e këtij batalioni ishin me prejardhje nga Dibra. Ose, pjesërisht nga qyteti i Dibrës, pjesërisht nga Peshkopia. Sipas banorëve të Dibrës, Dibra ndahet në Dibër të madhe (qyteti i Dibrës) dhe Dibër të vogël (Peshkopia).

Në regjionin e Dibrës ka vepruar edhe Çeta partizane e Zhupës e udhëhequr nga Azis Cami (komandant) dhe Ilija Topallovski (komisar). Ajo është e formuar në fillim të vitit 1943, kurse në shtator të vitit 1943 ka numëruar 30 veta, prej të cilave 17 ishin shqiptarë, kurse të tjerët maqedonas.¹⁴⁵

Pas çlirimit të Dibrës në shtator të vitit 1943, organizata e partisë së qytetit insiston që të formohet edhe një njësi partizane më e madhe e cila do të jetë e përbërë me shqiptarë dhe maqedonas. Në 6 tetor të vitit 1943 formohet Batalioni Rinor i Dibrës i cili numëronte 150 luftëtarë. Prej 25 tetorit atë vit, ky batalion e mban emrin e Nazmi Rushitit, i cili është partizani i parë i vrarë prej qytetit të Dibrës.¹⁴⁶ Gjatë përgaditjeve të formimit të batalionit ka komanduar Nikolla Maqellarski, derisa Lutfi Rusi ka qenë komisar politik. Më vonë me batalionin ka komanduar Demir Gashi, derisa Qemal Agolli ka qenë komisar politik. Nikolla Maqellarski ka qenë zëvendës komandant, kurse Xhafer Kodra zëvendës komisar politik¹⁴⁷

¹⁴⁴ Михаило Апостолски и др. (ур.), „Слободните територии во Македонија 1943“. Зборник на трудови од научен собир, Дебар, 27-29 март 1974, Скопје, 1975, 138.

¹⁴⁵ Nebi Dervishi, „Etnokultura e fushgropes se Ohrit“, „Çabej“, Tetovë, 2005, 267. „Слободните територии во Македонија 1943“, оп. cit., 139, 476 dhe 600.

¹⁴⁶ „Nazmi Rushiti“, http://sq.wikipedia.org/wiki/Nazmi_Rushiti.

¹⁴⁷ „Слободните територии во Македонија 1943“, оп. cit., 147.

Partizanët shqiptarë ishin pjesë e Brigadës së Parë sulmuese Maqedono-Kosovare, e cila është brigada e parë e ushtrisë Nacional-çlirimtare të Maqedonisë. Brigada është formuar në 11 nëntor të vitit 1943 në fshatin Slivovë. Në përbërje të saj hyn: Batalioni i parë maqedonas “Mirçe Acev”, Batalioni i Dytë Maqedono-Kërçovar, Batalioni i parë i Kosovës “Ramiz Sadiku” dhe Batalioni i dytë i Kosovës “Boris Vukmirovic”, me kapacitet 700 luftëtarë. Kjo brigadë ka patur karakter internacionalistik. Në të kishin marrë pjesë maqedonas, sërb, malazez, slloven, shqiptarë dhe italian.¹⁴⁸

Pjesmarrja e shqiptarëve në LNÇ të Maqedonisë nuk ka qenë e kufizuar në Zonën e parë Operative të LNÇ. Shqiptarët kanë marrë pjesë dhe në Zonën e dytë Operative, ose në regionin e Manastirit dhe Prespës. Disa emra të partizanëve Shqiptarë, të cilët kishin marrë pjesë në aradhat partizane “Dame Gruev” dhe “Goce Dellçev”. Ato janë: Nafi Sulejmani – blegtor nga Tërova, Manastir; Shain Sadiku – këpuctar nga Manastiri; Taip Taipi – blegtorë nga Asamati, Prespë; Tanas Vasili – këpuctar nga Korça; Kosta Prenda – Kafexhi nga Korça dhe Agron Sinani – Student nga Vlora, Shqipëri.¹⁴⁹

Në fund, pas një periudhe më të gjatë betejash kundër fuqive të armikut, prej njërive partizane shqiptare formohet Brigada e Katërt Shqiptare. Kryesisht kjo brigad ka qenë mbledhje e partizanëve nga Dibra, Struga, Kërçova, Ohri dhe Manastiri, por edhe nga Shqipëria. Duhet të theksohet se qëllimi i formimit të brigadës nuk ka qenë homogjenizimi etnik, por krijimi i potencialit për mobilizim më të madh. Është me rëndësi të theksohet se kjo brigad është një ndër shembujt më të mirë për pakt antiokupes, por edhe për pakt ndërretnik.

Në fund të korrikut dhe fillimi i gushtit të vitit 1944 është punuar intenzivisht në formimin e brigades partizane shqiptare në Maqedoni. Para formimit të saj, me 14 gusht në rrezë të malit Stogovë formohet Batalioni shqiptar i Kërçovës-Dibrës nga aradhat e Dibrës dhe Kërçovës.

¹⁴⁸ Вlado А. Ивановски, „Од Дебарца до Рогашка Слатина“, „Култура“, Скопје, 1964, 30.

¹⁴⁹ Kodra, op. cit., 167.

Në fillim ky batalion numëron 450 veta.¹⁵⁰ Pas çlirimit të Dibrës prej ushtrive të armikut, kjo aradhë drejtohet në drejtim të malit Karaorman. Çlirimi i Dibrës ka ndodhur së bashku me Batalionin e pestë partizan nga Shqipëria.

Brigada e katërt Shqiptare është formuar me 26 gusht të vitit 1944 në vendin e quajtur “Rudina”¹⁵¹ afër Arzhanovës në Karaorman. Në bazë, atëher aradha partizane e Kërçovës dhe Dibrës, e formuar disa ditë më parë, është rritur në brigad.¹⁵² Brigada ka vepruar deri në vitin 1945. Komandant i brigadës ka qenë Nafi Sulejmani, me prejardhje nga një fshat i Manastirit i quajtur Tërovë. Para se të bashkangjitet në këtë brigad, Sulejmani ka qenë pjesë e aradhave “Dame Gruev” dhe “Goce Dellçev”.¹⁵³ Prej marsit të vitit 1945, me këtë brigad komandon Çedomir Gjukiq. Shahin Mehmeti ka qenë i zgjedhur si zëvendës komandant. Qemal Agolli, me prejardhje nga Dibra, ka qenë komisar politik, derisa Xhafer Kodra, gjithashtu nga Dibra, ka qenë zëvendës komisar. Murteza (Peza) Kazadej, me prejardhje nga Elbasani, ka qenë i obliguar për rininë. Komisar politik ka qenë edhe Gjorgji Banoviq.

Në tetor të vitit 1944 Brigada e Katërt Shqiptare merr pjesë në sulmin mbi Kërçovë. Në atë moment Kërçovën e mbrojnë forcat okupuese të ushtrisë gjermane të ndihmuar nga gupet e ballit kombëtar të Mefail Shehut – Zajazit. Me sulm mbi fuqitë okupuese është çliruar fshati Tuin dhe prej andej brigada kalon në Bukoviq. Në orët e hershme të mëngjesit Brigada e Parë Maqedonase i sulmon pozicionet e armikut në Kërçovë. Njësitë e Xhem Hasës, të cilat udhëzohen prej Gostivari në Kërçovë që ti ndihmojnë Mefailit, të ndihmuar nga disa oficer dhe trupa gjermane, i sulmojnë pozicionet e Brigadës së Katërt Shqiptare nga të dy anët. Partizanët e Brigadës së Katërt Shqiptare, nuk e njihnin terrenin, me manevra të vogla i’a arriten të shpëtojnë nga situata e vështirë në

¹⁵⁰ Ibid., 229.

¹⁵¹ Vebi Xhemaili, “Shqiptarët e Maqedonisë në mbrojtje të Shqipërisë Etnike 1941-1945”, “Tringa Design”, Tetovë, 2008, 261.

¹⁵² Миле Тодоровски, op. cit., 186.

¹⁵³ Kodra, op. cit., 167.

të cilën u gjetën. Në këtë betejë Brigada e Katërt ka patur 15 të vrarë dhe 24 të plagosur, derisa nga ana tjetër ka patur 20 të vrarë dhe 30 të plagosur.¹⁵⁴ Është me rëndësi që të theksohet se në këtë betejë ka ardhur deri në ndeshje intra-etnike, të Shqiptarëve kundër Shqiptarëve. Gjegjësisht, kundër partizanëve Shqiptar kanë luftuar Shqiptarë ballist dhe bashkëpunorë të gjermanëve. Përsëri do themi, ajo paraqet aspekt të ndryshëm nga ajo se si historianët bashkëkohor nacionalist e paraqesin ngjarjen, ai është momenti se shqiptarët kanë qenë vetëm aleatë të italianëve dhe gjermanëve. Kurse ai është moment i cili i konvenon zmadhimit të ndjenjave nacionaliste dhe ofron “argumente” për urrejtje më të madhe.

Pas kësaj beteje, Shtabi i Divizionit të 48-të i LNÇ jep urdhër për tërheqje. Tërheqja është e urdhëruar për shkak se Brigada e Parë Maqedonase nuk e ka marrë Kërçovën. Brigada e Katërt udhëzohet kah Resnja, por stacionohet në fshatin Bellçishtë (Ohër). Më 18 tetor të vitit 1944, brigada e sulmon Strugën. Në atë moment në Strugë kishte 700 ushtarë Gjerman. Brigada e Katërt e mban qytetin të rrethuar për 20 ditë.¹⁵⁵

Me urdhër të Shtabit të Divizionit të 48-të dhe me bashkëpunim me njësitë partizane nga Shqipëria,¹⁵⁶ Brigada e Katërt Shqiptare dhe Brigada e Parë Maqedonase e sulmojnë Qafë Thanën.¹⁵⁷ Vendi kufitar Qafë Thanë ka qenë vend i rëndësishëm strategjik për trupat gjerman. Ka qenë vend për tranzitim përmes të cilës kanë kaluar trupat gjerman nga Shqipëria në drejtim të Strugës, Ohrit, Resnjës, Manastirit. Pas aksionit të kryer, i cili nuk mbaron sipas pritjeve, Brigada e Katërt tërhiqet në fshatin Ladorishtë, Frengovë dhe Zagraçan. Dy ditë më vonë gjermanët e rrethojnë Ladorishtën, dhe i detyrojnë partizanët e Brigadës së Katërt të tërhiqen në fshatin Vishnjë. Pas tërheqjes së tyre, gjermanët në Ladorishtë kryejnë një ndër masakrat më të mëdha gjatë Luftës së dytë botërore në teritorin e Maqedonisë – pushkatojnë 100 fshatarë Shqiptarë

¹⁵⁴ Ibid., 231.

¹⁵⁵ Ibid., 231-232.

¹⁵⁶ Dervishi, op. cit., 270.

¹⁵⁷ Kodra, op. cit., 232.

(të ri dhe pleq) dhe i djegin deri në themel shtëpitë e fshatarëve.¹⁵⁸

Më 8 nëntor të vitit 1944 partizanët e Brigadës së Katërt Shqiptare, pas një beteje të ashpër, hyjnë në Strugë. Në këtë luftë për çlirimin e Struges janë vrarë 35 partizanë të Brigadës së Katërt, derisa mbi 60 ishin plagosur.¹⁵⁹ Më tutje, Brigada e Katërt së bashku me Brigaden e Gjashtë dhe të Shtatë, më 15 nëntor të vitit 1944 e sulmojnë Kërçovën dhe pas luftimeve disa orëshë e çlirojnë atë.¹⁶⁰ Më 18 nëntor të vitit 1944, Brigada e Katërt e para hyn në Gostivar, duke u takuar me Batalionin e Dibrës “Nazmi Rushiti”. Ky batalion pas çlirimit të Dibrës udhëzohet në drejtim të regjionit të Rekës së poshtme dhe të Mavrovës, e pastron terrenin nga grupet e Ballit Kombëtar dhe ashtu e çliron rrugën për hyrje të Brigadës së Katërt në Gostivar.¹⁶¹ Pas çlirimit të Gostivarit, Brigada e Katërt hyn dhe e çliron edhe Tetovën.¹⁶²

Pas çlirimit të regjionit të Pollogut, bëhet mobilizim i madh dhe shumë të rinj shqiptarë i bashkangjiten kësaj brigade. Në fund të vitit kishte mbi 5.000 partizanë shqiptarë.¹⁶³ Në 7 janar të vitit 1945, gjatë riorganizimit të LNÇ dhe APM, kjo brigade riemërohet në Brigada e Shtatë sulmuese shqiptare.¹⁶⁴ Në Preshevë, në kuadër të saj inkorporohet një aradhe shqiptare e madhe me partizanë të mobilizuar nga regjioni i Shkupit dhe Kumanovës. Kjo aradhë ka numëruar përrreth 450 veta.¹⁶⁵ Brigada, në përbërje të Divizionit të Dyzet e dytë, merr pjesë në betejat në Frontin e Sremit dhe në çlirimin e Sllavonska Pozhegës dhe Zagrebit. Më 1 Shkurt të vitit 1945, kjo brigadë numëron 2.796 luftëtare, dhe gjatë betejave në Frontin e Sremit humbin jetë përrreth 288 luftëtarë.¹⁶⁶

¹⁵⁸ Ibid., 233.

¹⁵⁹ Ibid.

¹⁶⁰ Ibid., 234.

¹⁶¹ Xhemaili, op.cit., 264.

¹⁶² Kodra, op. cit., 234. Mbas çlirimit të Tetovës është mbajtur miting i madh me poenta të fuqishme antinacionalistike. Shiko Plotësimin 1 në këtë studim.

¹⁶³ Ibid., 235.

¹⁶⁴ Ibid.

¹⁶⁵ Ibid., 236.

¹⁶⁶ „Офицер“, весник на резервните офицери на Република Македонија, бр. 6, 2001, 5. Sipas listës të cilën historian Vebi Xhemaili e prezanton në librin e tij lista numëron 110 Shqiptarë, luftëtarë të Brigadës

5.2.2 Partizanët shqiptarë të shpallur si heronj të popullit të Jugosllavisë

Gjatë LNÇ të Maqedonisë disa shqiptarë janë veçuar dhe janë dalluar me trimëri dhe me sakrificë në emër të luftës për liri e cila para së gjithash ishte kontestuar si liri për gjithë popujt. Liria për nacionalistët nënkupton liri në shtet kombëtar në të cilin grupi etnik dominant sundon dhe e organizon shoqërinë, dhe njëkohësisht dominon mbi të tjerët. Këto persona nuk kanë luftuar për liri të këtillë, por kanë luftuar për liri të cilën do ta gëzojnë të gjithë njerzit në shoqëri. Ajo liri nuk nënkupton vetëm liri kombëtare (nacionale), por liri ekonomike dhe sociale. Këto persona luftuan dhe humbën jetë për ide internacionalistike dhe antinacionalistike. Nga kjo arsye, pas Luftës së dytë botërore tre veta nga këto janë shpallur si Heronj të popullit të Jugosllavisë. Të gjithë këto humbën jetë të rinj, për lirinë e tyre dhe lirinë e të gjithë tjerëve. Ibe Palikuqa u vra në moshë 17 vjeçare, Bajram Shabani në moshë 19 vjeçare, kurse Liman Kaba në moshë 21 vjeçare. Shkaku që sot, veçanërisht maqedonasit, por edhe shqiptarët në mënyrë të pamerituar nuk dinë për këto luftëtarë. Në vazhdim i japim biografite e tyre të shkurtëra.

1) Ibe Palikuqi është njëra prej shtatë partizaneve nga Maqedonia e shpallur si heroinë e popullit të Jugosllavisë dhe së bashku me Fana Koçovska – Cvetkoviq, është një prej heroinëve më të reja të gjithë Jugosllavisë. E lindur në Dibër, në vitin 1927, në familje të klasës së mesme. I ati ka qenë hoxhë. Pas përfundimit të shkollës fillore, mbetet në shtëpi, si shumica e femrave shqiptare të moshës së saj. Prindërit e saj e përgadisin të jetë grua shtëpijake.

Gjatë luftës së dytë botërore, familja e saj është e orientuar antifashiste, kurse vëllai i saj Eshtrefi ka qenë në mënyrë aktive i kyçur në lëvizjen nacional-çlirimtare. Ajo si pioner detyrën e saj e merr si korier të bartë letra dhe të tejbartë ilegal. Angazhohet shumë, lexon dhe derdh broshura propagandistike. Në vitin 1942 e pranojnë si anëtare e BRKJ (Bashkimi i rinisë komuniste të Jugosllavisë), kurse në korrik të vitit

të Katërt, të cilat kanë humbur jetë jasht teritorit të Maqedonisë. Shiko Xhemaili, op. cit., 318-323. Shiko Plotësimin 2 në këtë studim.

1943 ajo bëhet edhe anëtare e PKJ (Partisë komuniste të Jugosllavisë). Pas çlirimit të Dibrës në shtator të vitit 1943, Ibeja natë e ditë ishte në akcion. Kur partizanët tërhiqen nga Dibra, Ibeja shkon me ata dhe hyn në njësitë e LNÇ dhe APM. Por, Partia e kthen në Dibër, në ilegalë, në cilësi të anëtarit të Komitetit lokal të PKJ për Dibrën. Puna e saj politike zhvillohet midis rinisë femrore. Që të mos bie në duar e armikut ose të jetë e vrarë, Komiteti lokal e miraton hyrjen e saj në njësitë partizane. Ibeja dallohet si partizane dhe më 6 gusht të vitit 1944 ajo bëhet zëvendës komisar e çetës në Brigadën e katërt shqiptare.

Në një betejë të brigadës kundër ballistëve, në periferi të Kërçovës më 20 shtator të vitit 1944, gjatë depërtimit të partizanëve ajo ishte në grupin e fundit. Në betejën kundër ballistëve midis fshatrave Premka dhe Shutovë, Ibeja ishte plagosur rëndë dhe pas dy ditësh u nënshtrohet plagëve në fshatin Shutovë të Kërçovës.¹⁶⁷

2) Liman Kaba, si edhe Ibe Palikuqi, është lindur në Dibër, në vitin 1924. Vjen nga një familje e varfër e cila është marrë me bujqësi dhe blegtori. Ka kryer shkollën fillore në gjuhën serbo-kroate, kurse pas okupacionit të Italisë në vitin 1941 është regjistruar në gjimnazin e Prishtinës. Atje ai ka vepruar në organizimin e rinisë antifashiste, dhe për shkak të kësaj dy herë në vitin 1942 ka qenë i arrestuar. Ka ikur nga burgu i Prishtinës dhe është kthyer në Dibër, ku ka vepruar si organizator i lëvizjes nacional-çlirimtare. Shtëpia e tij ka qenë qendër për mbledhje ilegale të partizanëve të aktivistëve të PKJ dhe në të Kuzman Josifovski – Pitu e ka formuar komitetin lokal të PKJ-së në Dibër.

Në Shkurt të vitit 1943, për shkak të arsyeve ekonomike ka shkuar në Tiranë.¹⁶⁸ Në Maj, vitin e njëjtë është bashkangjitur në aradhën partizane shqiptare “Dajti”. Një kohë të shkurtë me njësinë partizane ka qendruar në rrethinën e Dibrës dhe në terrenin e Peshkopisë. Pas kapitulimit të Italisë më 8 Shtator të vitit 1943, arriti në Dibrën e lirë dhe ka qenë i caktuar si zëvendës komisar politik i çetës gjatë komandës së qytetit.

¹⁶⁷ „Македонска енциклопедија“, МАНУ, Скопје, 2009, 1111 fq.

¹⁶⁸ Sado Name, “Liman Kaba”, “Flaka”, Shkup, 1978, 24.

Gjatë formimit të Brigadës së Katërt Shqiptare, ai është kyçur në radhët e sajë, kurse më vonë ka qenë i pranuar si antar i PKJ. Ka luftuar në teritoret e Shqiprisë, Maqedonisë, Sërbisë, Bosnjës dhe në fund në Kroaci. Si zëvendës komisar politik i batalionit të korpusit të Pesëmbëdhjetë (të Maqedonisë) i LNÇJ ka humbur jetë me trupat çetnik në Frontin e Sremit në Sllavoninë perëndimore.¹⁶⁹

3) Bajram Shabani, siç përmendëm edhe më parë, është partizani i parë shqiptar i cili ka humbur jetë në LNÇ të Maqedonisë. Është lindur në fshatin Lipkovë të Kumanovës, më 14 tetor të vitit 1922.¹⁷⁰ Vjen nga një familje e varfër fshatare, e cila nuk ka patur tokë të mjaftueshme për përpunim. Jetim prej moshës gjashtë vjeçare, si pesëmbëdhjet vjeçar ka punuar në Kumanovë si bujk dhe si punëtor në ndërtimtari dhe si farkëtar. Në vitin 1939 është bashkangjitur në lëvizjen sindikale, kurse në verën e vitit 1941 është bërë anëtar i LRKJ.¹⁷¹

Në shtator të vitit 1941, Shabani është pjesë e grupit e cila, sipas urdhërit të organizatës partiake të Kumanovës, e studion hapësirën për veprim të aradhës partizane të Karadakut. Gjatë qëndrimit të grupit në fshatrat, Shabani në gjuhën shqipe i bind bashkëbiseduesit e tij se pushteti bullgar është antipopullor dhe se i plaçkit edhe shqiptarët edhe maqedonasit.¹⁷²

Në 12 tetor të vitit 1941, kur është formuar Aradha partizane e Karadakut, Shabani bëhet luftëtar në këtë aradhë. Pas dy ditësh humb jetë, në luftë me ushtrinë bullgare dhe policinë në atharin e fshatit Bellanovcë të Kumanovës, duke mbajtur letër braktisjeje të shokëve të tij. Në momentin kur e hedh bombën e fundit, ka qenë i qëlluar nga zjarri i mitrolezit dhe ka rënë i vdekur.

¹⁶⁹ „Македонска енциклопедија“, op. cit., 655.

¹⁷⁰ Ibid., 1643.

¹⁷¹ Јордан Цеков – Дане, „Загинаа за слободата на Македонија“, „Графотекс“, Куманово, 2001, 43- 45.

¹⁷² Ibid., 45.

5.3 ÇLIRIMI I KËRÇOVËS DHE DIBRËS

Dibra dhe Kërçoka paraqesin një kapitull të posaçëm në LNÇ të Maqedonisë. Pas kapitulimit të Italisë fashiste më 8 shtator të vitit 1943, këta dy qytete ishin të çliruar nga fuqitë partizane, gjë që nuk ka ndodhur me qytetet e tjera në Maqedoni. Veçanërisht është markant çlirimi i Dibrës, dhe në periudhën e Dibrës së lirë si një ndër ngjarjet më madhështore në LNÇ të Maqedonisë, por edhe më gjërë. Ky qytet ishte plot 69 ditë në duart e qeverisjes nacional-çlirimtare, plot 69 ditë ka qenë i lirë. Shpesh herë janë paraqitur dhe probleme më të vogla me udhëheqjen e qytetit, por problemet nuk kanë qenë afatgjate. Edhe çlirimi i Kërçovës paraqet kapitull të rëndësishëm në historinë e LNÇ të Maqedonisë, por edhe të popujve të cilët jetojnë në atë qytet. Është rëndësishme të theksohet se edhe në të dy qytetet fuqitë nacional-çlirimtare sipas bindjes së tyre politike kanë qenë internacionalistë dhe kanë luftuar kundë italianëve, gjermanëve, shqiptarëve, bullgarëve etj. Vijnë çastet më të rëndësishëm të luftës për liri dhe barabartësi të qytetarëve të Dibrës dhe Kërçovës.

5.3.1 Çlirimi i Dibrës

Gjatë Luftës së dytë botërore, fashistët italian dhe bullgar, të përkrahur nga strukturat kuislinge, përmbysin në Dibër dhe rrethinë me ide të shqipërisë së madhe dhe propagandë fashiste, por para se të gjithash propagandë nacionalistike. Bëhen tubime nga ana e fashistëve dhe aleatëve të tyre tradhëtar. Populli vazhdimisht ushqehet me urrejtje. Por, me përforsimin e Partisë Komuniste të Maqedonisë dhe krijimi i organizatave të strukturuar mirë në Dibër, retorikes dhe urrejtjes së maqedonasve dhe shqiptarëve zvogëlohet, derisa zmadhohen aktivitetet të cilat janë në favor të bashkëjetesës midis të gjitha popujve në Dibër dhe rrethinë. Duke ofruar alternativën e vetme në atë kohë, kulturore dhe politike, Partia Komuniste në mënyrë aktive propagon bashkëjetesë, duke i quajtur të gjithë njerëzit si vëllezër.¹⁷³ Edhe pse thirrjet e ballistëve dhe fashistëve italian për një homogjenizim të shqiptarëve në radhët e ballistëve dhe zhandarmerisë, shumica e shqiptarëve

dhe turqve vendin e gjejnë në luftën Nacional-çlirimtare.¹⁷⁴

Me kapitulumin e Italisë hapet mundësia më e madhe për depërtim, strukturim të ri strategjik dhe konsolidim më i gjërë ushtarak i njërive të LNÇ. Në qytetet me të cilat kanë qeverisur fashistët italian, tani fuqitë Nacional-çlirimtare kanë shansë të imponohen dhe ti pushtojnë, por dhe të qeverisin me ata.

Në rethin e Dibrës, në atë periudhë veprojnë fuqitë e batalionit partizan të Dibrës me të cilin udhëhiqte Haxhi Lleshi. Për kapitulumin e Italisë merret vesh në orët e hershme të mëngjesit më 8 shtator të vitit 1943. Ditën kur Italia fashiste kapitulon, komandanti i batalionit partizan të Dibrës, Haxhi Lleshi¹⁷⁵ gjendet në fshatin Labinot (Shqipëri), ku mbahet mbledhja e dytë e konferencës së frontit Antinacionalistik Nacional-çlirimtar të Shqipërisë. Ditën e kapitulumit të Italisë, çeta Gryka e Vogël, prej përbërjes së batalionit partizan të Dibrës, së bashku me komisarin politik Ahmed Jegenin hyjnë në Dibrë.¹⁷⁶ Jegeni kërkon nga Aldo Aci i cili ka qenë komandant i divizionit italian “Firenca” t’i ja dorëzojë efektivet ushtarak batalionit partizan të Dibrës me obligim që ushtarët italian të jenë të siguruar me ushqim dhe transport të sigurtë për të kaluar në Itali. Ne qoftë se ata dëshirojnë, mund t’i bashkangjiten ushtrisë partizane. Aldo Aci i pranon këto kërkesa, me që Dibra bëhet e lirë.

Pasditën e të njëjtës ditë në Dibër vjen Kërste Cërvenkovski. Negocion me përfaqësuesit e batalionit partizan të Dibrës (Nijazi Islami dhe Sotir Vullkani) për të ndarë preun ushtarak të marrur nga fuqitë ushtarake italiane, midis njërive partizane maqedonase dhe shqiptare. Të përfaqësuesit e batalionit partizan të Dibrës ka patur një hamendje të vogël, por në fund pranojnë. Preu ushtarak ka qenë municion dhe një automjet. Preu ndahet në të gjitha njësitë partizane në Maqedoni, me që ata e zmadhojnë kapacitetin për luftë kundër armikut.

¹⁷³ Глигор Тодоровски, „Западна Македонија за време на окупацијата (1941-1944)“, ИНИ, Скопје, 1998, 16-17.

¹⁷⁴ Ibid., 66.

¹⁷⁵ Haxhi Lleshi (Regjioni Dibër, Shqipëri, 1913 - Tiranë, 1998) ka qenë komunist shqiptar, pjesmarës në LNÇ të Shqipërisë, gjeneral-major dhe president i RP të Shqipërisë. Është i shpallur si hero i popullit të Shqipërisë.

¹⁷⁶ „Слободните територии во Македонија 1943“, op. cit., 139.

Më 16 shtator¹⁷⁷ është zgjedhur këshill i ri Nacional-çlirimtar në të cilën hyn: Sheh Latifi – president nga Gjorica, Sul Baholi – sekretar, derisa antarë janë: Edip Tërshana, Muzafer Kallajxhiu, Haki Shehu, Musa Mullai, Shaban Strezimiri, Stefan Maqellarski¹⁷⁸, Shullajkovski, Bllazhe Iliovski, Jashar Alili¹⁷⁹ etj.

Në atë periudhë në Dibër ka patur 2.000 vetë bashibozuk të cilët kanë qenë të sjellur nga ana e bajraktarëve shqiptarë nga rrethi i Dibrës. Kërste Cërvenkovski më 21 shtator i shkruan letër Svetozar Vukmanoviç – Tempo se qeverisja në Dibër ndahet me disa Bajraktarë, që sipas tij nuk është punë e mirë.¹⁸⁰ Por, mosmarrveshtja shpejt tejkalohet. Është konsideruar se, në qoftë se Haxhi Lleshi do të ishte prezent, do ta kishte zgjidhur situatën e ndodhur dhe tensionin në Dibër. Por, sipas disa historianve dhe pjesmarrësve në LNÇ, problemi nuk ka qenë aq i thjeshtë për tu zgjidhur.

Marrveshtja midis LNÇ të Shqipërisë dhe bajraktarëve, nga ana e bajraktarëve është respektuar, por LNÇ e Shqipërisë në konferencën në Labinot e thyen marrveshtjen për çlirim të teritoreve nga okupacioni fashistik, për shkak se ai ballistëve (bajraktarëve) u përshkruan merita për të cilat ata nuk kanë luftuar. Por, jo vetëm LNÇ e Shqipërisë, por dhe LNÇ e Maqedonisë e nënshkruan marrveshtjen për bashkëpunim me ballistët në akcionet kundër okupatorëve fashist. Në fund LNÇ e Maqedonisë nuk është e informuar në kohë të duhur për thyerjen e marrveshtjes të LNÇ të Shqipërisë dhe përfaqësuesve të ballistëve, gjë që sjell deri në konfuzion. Sipas historianit Lutfi Rusi, edhe LNÇ e Maqedonisë dhe shtabi i Dibres sikur të dinin për thyerjen e marrveshtjes, ata nuk do të kishin mundur të intervenonin. Numri i fuqive të ballistëve në atë moment ishte shumë më i madh se ajo e trupave të LNÇ.¹⁸¹

Në ditët e para të tetorit ka qenë i zgjedhur këshill i ri i KNÇ në përbërje: Haki Stërmili – president, Sul Baholi – sekretar, Edip Tërshana, Muzafer Kallajxhiu, Daut Langu, Jusuf Strazimiri, Dilaver Kerlluku, Dalip Turkeshi,

¹⁷⁷ Ibid., 488.

¹⁷⁸ Ibid., 140.

¹⁷⁹ Глигор Тодоровски, op. cit., 57.

¹⁸⁰ „Слободните територии во Македонија 1943“, op. cit., 141.

¹⁸¹ Ibid., 234-235.

Stefan Makellarski, Ago Nasufi, Arif Besatari, Fadil Abdurahman Hoxha, Sali Bellçishta, prifri Veljo, Angele Zafirovski, Marko Aleksovski, Mitre Veleviski, Haki Poumi, Zeki Agolli dhe Musa Mullai – të gjithë antarë.¹⁸² Ky këshill i ri i KNÇ ishte i zgjedhur menjëher pas kthimit të Haxhi Lleshit në Dibër nga konferenca në Labinot dhe me atë përforcohet e drejta e pjesmarrjes në qeverisjen lokale për të gjithë popujt e Dibrës. Këshilli i ri ishte dhe përgjigje për tenzionin që u bë më parë në qytetin ku qeverisja ishte e ndarë midis anëtarëve të LNC dhe bajraktarëve. Me këtë bëhet e ditur se qeverisja në Dibër do të jetë e organizuar sipas principit dhe idesë së internacionalizmit, ku të gjithë qytetarët e këtij vendi barabartësisht do të marrin pjesë në organet e qeverisjes.

Pas çlirimit të Dibrës, njësitë partizane shqiptare e çlirojnë dhe Peshkopinë, qytet i cili është larg Dibrës vetëm 25 kilometra. Bajraktarët e Dibrës, së bashku me fuqitë e tyre, pas dëbimit nga Dibra më 16 shtator të vitit 1943, i sulmuan fuqitë partizane në Peshkopi me qëllim që ta marrin këtë qytet dhe të krijojnë teren të përshtatshëm për sulm të njëjësive partizane të cilat e mbronin Dibrën. Në mbrojtje të Peshkopisë merr pjesë edhe Aradha partizane e Sharrit (Kosovës) e përbërë me Malazez, Sërb dhe Shqiptar, të cilët para se të kapitulonte Italia gjendeshin nëpër burgjet italiane në Shqipëri. Pas katër ditësh luftë, fuqitë reaktionale pësuan sulm të fuqishëm nga ana e njëjësive partizane.¹⁸³

Një muaj pas marrjes së teritorit të lirë në Kërçovë, më 31 tetor të vitit 1943 grupet balliste së bashku me njësitë gjermane e sulmojnë Dibrën.¹⁸⁴ Luftërat zgjasin katër ditë. Më 3 nëntor në qytet arrin edhe çeta partizane “Sllova”, e cila me njësitë e Aqif Lleshit menjëher kyçen në luftën kundë armikut.¹⁸⁵ Kapetani Rideli dhe lejtanti Lis (nga misioni aleat britanik) të cilët kanë qenë katër kilometra afër qytetit (në fshatin Kloboçishtë), së bashku me disa bajraktarë shqiptar, këtë luftë të partizanëve dhe ballistëve e kanë quajtur luftë “vëlla vrasëse”. Kjo është shumë indikative për atë

¹⁸² Ibid., 142.

¹⁸³ Ibid., 147.

¹⁸⁴ Ibid., 149.

¹⁸⁵ Ibid.

që vetë studimi e ka si qëllim për ta shfaqur. Gjegjesisht, gjatë Luftës së dytë botërore, punët nuk kanë qenë bardh e zi. Fakt është se trupat shqiptaro-kuislinge ekzistonin në numër të madh, por gjithashtu fakt është se ekzistonin dhe shqiptarë përparimtar të cilët ishin pjesë e ushtrisë nacional-çlirimtare dhe qëndronin afër shokëve të tyre maqedonas, sërb, malazez, grek dhe zellshëm e mbronin idealin e vëllazërimit dhe bashkimit. Ishin kundër trupave kuislinge-reakcionare, edhe pse ata i takonin kombit të njejtë.

Më 4 nëntor, për shkak të humbjeve të mëdha, aradhat balliste tërhiqen prej Dibre, por së shpejti ushtria gjermane dhe aleatët e saj balliste përsëri e sulmojnë Dibrën e lirë. Sulmi i ri fillon më 16 nëntor në orët e pasditës. Në këtë sulm armiku ka patur numër më të madh trupash. Mbi 4.000 ballistë dhe gjerman marrin pjesë në këtë sulm,¹⁸⁶ derisa partizanët ishin përreth 600 luftëtar. Gjermanët para se të hynë nata filluan të bombardojnë gjithë qytetin, derisa shtabi i batalionit partizan i Dibrës sjell vendim për tërheqje nga qyteti. Përreth orës 22 fuqitë partizane e kalojnë lumin Drin dhe arrijnë në afërsi të fshatit Oktishani. Pas 69 ditësh liri, Dibra përsëri bie në duart e fuqive okupuese.¹⁸⁷

Forcat nacional-çlirimtare në fillim tërhiqen në Shqipëri, dhe një pjesë e çetave bie në kurth në fshatin Mellniçan në afërsi të Dibrës. Tërhiqen nga kurthi, por në betejë me ballistët humbin jetën Veli Koleci dhe Bojo Topatoviq nga Mali i Zi.¹⁸⁸ Kjo edhe njëher dëshmon për karakterin internacional të luftës nacionalçlirimtare. Më vonë, partizanët tërhiqen përmes Karaormanit, Pustecit, Reovës, deri në Maqedoninë e Egjeut, edhe kalojnë në Shqipërinë e Jugut. Kjo tërheqje bëhet nën udhëheqje të Haxhi Lleshit.

Kjo përsëri dëshmon për karakterin internacional të luftës nacionalçlirimtare. Më vonë, partizanët tërhiqen përmes Karaormanit, Pustecit, Reovës, deri në Maqedoninë e Egjeut, edhe kalojnë në Shqipërinë e Jugut. Kjo tërheqje bëhet nën udhëheqje të Haxhi Lleshit.

¹⁸⁶ Ibid., 495.

¹⁸⁷ Ibid., 153-154.

¹⁸⁸ Kodra, op. cit., 202-203.

Në verën e vitit 1944 përsëri ka ardhur deri në veprime të përbashkëta luftarake të njëjësive partizane nga Maqedonia dhe Shqipëria në Dibër dhe rrethinë. Atë verë njësitë partizane dy herë kanë sulmuar Dibër. Sulmi i parë ishte kryer më 9 korrik, Brigada e parë Maqedonase dhe Brigada e parë e Kosovës e sulmuan qytetin, kurse Brigada e parë Shqiptare kishte detyrë që ta sigurojë rrugën Strugë-Dibër. Sulmi i dytë mbi Dibër është kryer më 1 gusht,¹⁸⁹ sulmi ishte kryer së bashku me Brigadën e parë Maqedonase dhe Brigadën e parë Shqiptare, derisa Brigada e parë Kosovare ka qenë e obliguar të sigurojë rrugën Strugë-Dibër.¹⁹⁰ Siç shënon Ilija Topallovski, sulmi i parë i Dibërës ka qenë i kryer që të tërhiqen fuqitë e armikut dhe në atë mënyrë t'u jepet “ndihmë vëllazërore njëjësive të ushtrisë nacional-çlirimtare shqiptare”, të cilët kanë zhvilluar luftë kundër forcave gjermane dhe balliste në frontin e Peshkopisë. Sulmin i dytë mbi Dibër, Topallovski e vlerëson si “një manifestim të vërtetë dhe i madh i vëllazërisë midis dy popujve tonë” ku në betejat “Maqedonasi dhe Shqiptari, duke rënë njëri ndaj tjetrit, me gjak e kanë vulosur vëllazëriminë e tyre”¹⁹¹ Pas këtij sulmi të Dibërës, Brigada e parë Kosovare përmes Shqipërisë u ngrit të shkojë në Kosovë. Kur arriti në Peshkopi, kjo brigadë e përbërë me sërë, malazez, shqiptar, sipas urdhërit të shtabit të korpunit shqiptar, ka qenë e angazhuar në luftimet kundër fuqive gjermane në frontin midis Dibërës dhe Peshkopisë. Përveç kësaj, ajo, së bashku me njësitë shqiptare, arriti ta mbajë armikun, i cili nga Dibra depërtonte kah Peshkopia që ta detyrojë të tërhiqet në Dibër.¹⁹²

EEdhe pse këto dy sulme të Dibërës mbaruan pa sukses, Dibra definitivisht u çlirua nga fuqitë e armikut. Kur dhe si ka ardhur deri në të, nuk ka informacion në dispozicion në historiografinë maqedonase. Por, ajo sigurisht ka ndodhur në periudhën prej gushtit deri në nëntor

¹⁸⁹ Тодор Чепреганов и др. (ур.), „Ослободувањето на федерална Македонија: документи“, ИНИ, Скопје, 2005, vëllim 3, 26, 28 dhe 29.

¹⁹⁰ Крсте Црвенковски и др. (ур.), „Првата македонско-косовска ударна бригада на братството и единството“, „Култура“, Скопје, 1958, 123-125 и 369-373. Ивановски, op. cit., 115-122. Миле Тодоровски, op. cit., 186-187.

¹⁹¹ Топалоски, op. cit.

¹⁹² Црвенковски, op. cit., 125.

të vitit 1944, ose gjatë periudhës së sulmit të Dibrës deri në çlirimin definitiv të gjithë Maqedonisë. Ka gjasa të ketë ndodhur gjatë ditëve të para të shtatorit në vitin 1944.¹⁹³ Me që, Dibra ka gjasa të jetë e çliruar me aksion të përbashkët të njëjse partizane nga Shqipëria dhe Maqedonia.

5.3.2 Çlirimi i Kërçovës

Kërçova disa herë ka qenë e pushtuar nga partizanët para se të ishte definitivisht e çliruar në nëntor të vitit 1944. Kërçova herën e parë ka qenë e çliruar prej 11 shtatorit e deri në 2 tetor të vitit 1943, plot 21 ditë, hera e dytë ka qenë prej 1 deri në 6 nëntor të vitit 1943, dhe hera e tretë dhe e katër, drejtpërdrejtë para çlirimit definitiv, më 1 shtator dhe më 9 tetor të vitit 1944.

Pas kapitulimit të Italisë fashiste, ushtarët e saj janë tërhequr nga Kërçova, më 11 shtator të vitit 1943 partizanët hynë në Kërçovë. Atëherë Kërçova bëhet pjesë e teritorit të lirë i cili ishte zgjatur në regjionin Debarca-Kopaçka-Mavrova-Bistra dhe pranë Kërçovës, i cili e ka përfshirë edhe Dibrën.¹⁹⁴ Hyrja e njëjse partizane në Kërçovë ka qenë mjaft i vlefshëm dhe krejtësisht në shpirtin e internacionalizmit. Ilija Topallovski shkruan se “gjatë hyrjes së forcave tona në qytet, i gjithë populli ishte i dalur në 5 kilometra para Kërçovës dhe duke hedhur lule dhe duke kënduar këngë luftarake maqedonase dhe shqipe, i ka pritur luftëtarët tanë. Ato momente historike do të mbeten gjithmonë thellë të gdhendura në zemrat e maqedonasve dhe shqiptarve të ndershëm”.¹⁹⁵

Pas çlirimit, në këshillin nacional-çlirimtar të Kërçovës kanë qenë të zgjedhur Ahmed Hoxha, Skender Presheva, Rexhep Zajazi etj., derisa me komandën ushtarake në fillim kanë udhëhequr Hamdi Dema – komandant, Rexhep Zajazi – zëvendës, Umer Domi – Ljuma – komisar dhe Boris Aleksovski zëvendës komisar politik.¹⁹⁶

Me rastin e çlirimit të Kërçovës, Shtabi i Zonës së parë operative më

¹⁹³ Чепреганов, op. cit., 46.

¹⁹⁴ Чакарјаневски, op. cit., 96-97.

¹⁹⁵ Топалоски, op. cit.

¹⁹⁶ Kodra, op. cit., 186-187.

11 shtator të vitit 1943 shpall Proklamatë për themelimin e organeve të qeverisjes popullore. Kjo Proklamatë, e shkruar nga komandanti i Shtabit të Zonës së parë operative Hamdi Dema, ka refleksione të cilat sipas kontekstit por dhe kohës kur është shkruar, janë më të thella bile edhe nga Marrëveshtja Kornizë e Ohrit. Në të, ndër të tjera, qendron se (1) Kërçova është e marrur në duar të ushtrive nacional-çlirimtare maqedono-shqiptare. (6) Në ç’do lokal do të vendosen flamuj të maqedonasve dhe të shqiptarve. (10) Qeverisja më e lartë do të jetë komiteti nacional-çlirimtar maqedono-shqiptar, i cili do të jetë i përkohshëm derisa nuk zgjidhet komiteti i ri në mënyrë demokratike dhe zgjedhje të lira. (13) Qeverisja e përkohshme do të jetë e përbërë nga maqedonas dhe shqiptarë.¹⁹⁷ Raporti i shtabit kryesor flet me admirim të madh dhe lavdi për bashkëpunimin midis shqiptarve dhe maqedonasve, por edhe për lirinë që secili të mund të gëzojë në liri të shprehë tiparet dhe karakteristikat kulturore të veta. Ashtu, në raportin qendron: “Përsëri në Kërçovën tonë valviten flamuj të famshëm të Republikës së Krushevës dhe Skenderbeut”¹⁹⁸

